



2007 Raporti
Vjetor

AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

RAPORTI VJETOR

- 2007 -

© E drejta e autorësisë: 2008 Agjencia Kosovare e Pronës (KPA). Materiali nga ky botim mund të riprodhohet me kusht që gjatë referimit të ceket burimi.

Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) u themelua më 4 Mars të vitit 2006 sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/10 (më pas u ndryshua me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50), si një Agjenci e pavarur në pajtim me kapitullin 11.2 të Kornizës Kushtetuese të Kosovës. Zyra qendrore e saj gjendet në:

Rruga Nazim Gafurri nr.31
Prishtinë
Kosovë

Telefoni +381 38 249 918
Telefaksi +381 38 244 919
E-mail: mailbox@kpaonline.org
<http://www.kpaonline.org>

Emrat e vendbanimeve janë të shënuara vetëm në një gjuhë. Në versionin e raportit në gjuhën angleze, vendbanimet janë shënuar në gjuhën angleze. Ndërsa, versionet e përkthyer të raportit vendbanimet janë në gjuhën e tyre përkatëse.

Ky raport është hartuar dhe përpiluar nga z. Margaret Cordial, Sekretare ligjore në KPA dhe u redaktua nga z. Knut Rosandhaug, Drejtor i Sekretarisë Ekzekutive në KPA.

TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtesave

Parathënie

1. Agjencia Kosovare e Pronës

- 1.1 Themelimi dhe mandati
- 1.2 Përbërja
 - 1.2.1 Sekretaria Ekzekutive
 - 1.2.2 Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës
 - 1.2.3 Bordi Mbikqyrës
- 1.3 Korniza e aplikueshme ligjore
 - 1.3.1 Legjislacioni i UNMIK-ut
 - 1.3.2 Udhëzimet plotësuese të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
 - 1.3.3 Ligjet vendore
 - 1.3.4 Korniza e aplikueshme për të drejtat njerëzore

2. Pranimi i kërkesave dhe informimi

- 2.1 Pranimi i kërkesave
- 2.2 Vendndodhja e zyrave për pranimin e kërkesave
- 2.3 Formulari i kërkesës
- 2.4 Afati kohor për paraqitjen e kërkesave
- 2.5 Statistika mbi numrin e kërkesave të regjistruara
- 2.6 Notifikimi dhe publikimi i kërkesave

3. Përpunimi i kërkesave

- 3.1 Hetimi i kërkesave
- 3.2 Qasja në të dhënat pronësore dhe verifikimi i dokumenteve
- 3.3 Hartimi i parashtresave ligjore mbi kërkesat

4. Vendosja mbi kërkesat nga ana e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës

- 4.1 Hyrje
 - 4.1.1 Para-vendimmarrja: udhëzimet e Komisionit për përpunimin e kërkesës
- 4.2 Vendimmarrja
- 4.3 Statistikat mbi kërkesat e zgjidhura
- 4.4 Natyra e vendimeve të Komisionit
- 4.5 Forma e Vendimeve

5. Zbatimi

- 5.1 Hyrje
- 5.2 Zbatimi i vendimeve të HPCC-së
 - 5.2.1 Vendimet e pazbatuara të HPCC-së
 - 5.2.2 Zbatimi i skemës për kompensim

6. Administrimi i pronave dhe skema e qiradhënies

- 6.1 Administrimi i pronave të braktisura
- 6.2 Skema e qiradhënies
 - 6.2.1 Lloji dhe numri i pronave në skemën e qiradhënies
 - 6.2.2 Procedura për vënien e pronës në skemën e qiradhënies
- 6.3 Veprimet e tjera zbatuese të rëndësishme për mandatin e HPD/HPCC-së

7. Struktura institucionale dhe personeli

- 7.1 Struktura institucionale e KPA-së
- 7.2 Menaxhmenti dhe personeli
- 7.3 Shpenzimet e personelit për vitin 2007

8. Financimi dhe buxheti

- 8.1 Financimi
- 8.2 Buxheti 2008-2010

9. Veprimtaritë informative dhe shpërndarja e informatës

- 9.1 Transparenca dhe informimi i publikut
- 9.2 Bashkëpunimi ndërmjet agjencive
- 9.3 Mediat dhe fushatat për informim të publikut

Ngjarjet kyçe në vitin 2007

SHTOJCA

- 1. Organogrami i KPA-së
- 2. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50
- 3. Urdhëresa administrative e UNMIK-ut 2007/5
- 4. Lista e pronave nën administrim të KPA-së sipas regjioneve dhe komunave

LISTA E SHKURTESAVE

CPT	Ekipi për përpunimin e lëndëve, KPA
DAC	Departamenti i Administratës Civile, UNMIK
AER	Agjencia Europiane për Rindërtim
BE	Bashkësia Europiane
EUPT	Njësi i Bashkësisë Europiane për Planifikim
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
HPD	Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore
HPCC	Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore
IDP	Personat e Zhvendosur Brenda Vendit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës, IPVQ
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
KFOR	Forcat e Kosovës, NATO
KPA	Agjencia Kosovare e Pronës
KPCC	Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës, KPA
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës, UNMIK
AKM	Agjencia Kosovare për Mirëbesim, UNMIK
OJQ	Organizatë Jo-Qeveritare
OLA	Zyra e Këshilltarit Juridik, UNMIK
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PDPSSP	Zëvendësi i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm
NPB	Ndërmarrja Publike Banesore
IPVQ	Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse (IPVQ)

BDP	Bartësi i së drejtës pronësore
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbim Projektësh
UN-Habitat	Programi i Kombeve të Bashkuara për Strehimin e Njerëzve
UNHCR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK	Misioni Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara për Administrim në Kosovë
UNOB	Zyra e Kombeve të Bashkuara në Beograd

PARATHËNIE

Nga z. Knut Rosandhaug

Drejtore i Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës

Agjencisë Kosovare të Pronës (“KPA”) i është dhënë mandat kryesor zgjidhja e kërkesave të lidhura me konfliktin dhe në lidhje me pronat e patundshme private, përfshirë pronat bujqësore, komerciale dhe banesore. Agjencia përbëhet nga tri organe kryesore, nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës që është autonom dhe kuazi-gjyqësor (“Komisioni”) dhe Bordi Mbikqyrës. Sekretaria Ekzekutive luan rol aktiv përgjatë gjithë fazave të procesit të zgjidhjes së kërkesave dhe është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm dhe efikasitetin e mekanizmit që përfshinë pranimin dhe përpunimin e kërkesave dhe zbatimin e vendimeve, përmes zbatimit të urdhërave për dëbim në rast nevojë. Komisioni shqyrton kërkesat e referuara nga Sekretaria Ekzekutive dhe rregullat e tij mbi procedurat dhe evidencën pasqyrojnë dhe arsyetojnë natyrën e tij si regjim special (*sui generis*), duke e pajisur me mjete të nevojshme që në mënyrë efektive të arrijë të shqyrtojë numrin e madh të lëndëve. Procesi ka për detyrë të ofrojë

ndihmë efektive për mijëra paraqitës të kërkesave brenda një periudhe të arsyeshme dhe në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase.

Viti i kaluar ishte me fat të ndryshueshëm për KPA-në. Derisa ky institucion raporton rezultate të rëndësishme dhe të arritura të dukshme për një periudhë të shkurtë që nga themelimi i saj, gjithashtu dolën një numër sfidash, të cilat vazhdimisht vështirësuan efikasitetin dhe kufizuan veprimtaritë funksionale.

Shqyrtimi i kërkesave

E themeluar në vitin 2006 nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara ("PSSP"-ja), KPA-ja ka mbledhur rreth 40,000 kërkesa. Pjesa e saj kuazi-gjyqësore, tre anëtarët e të cilit u emëruan në maj të vitit 2007, gjykoi 3,346 kërkesa.¹ Numri mund të ishte më i madh po të bëhej emërimi i anëtarëve të Komisionit më herët, meqenëse kaloi një periudhë prej katërmbëdhjetë muajsh ndërmjet themelimit të Komisionit dhe emërimit të anëtarëve të tij. Më tutje, rregullat e evidentimit dhe procedurës që drejtojnë shqyrtimin e kërkesave dhe procedurave para Komisionit u shpallën tek në qershor të këtij viti duke rezultuar me mundësinë e vetme që seanca e parë e Komisionit të mbahej atëherë.

Financimi

Viti i kaluar dëshmoi një mungesë të vazhdueshme të financimit bilateral të donatorëve për KPA-në që është i nevojshëm të plotësojë përqindjen tepër të ulët të financimit (32%), e cila vjen nga fondet qendrore të UNMIK-ut dhe Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Për shkak të mungesës në mjete, KPA-ja në vjeshtë u ndesh me vështirësi serioze financiare duke vështirësuar efikasitetin e përgjithshëm të procesit. Fonde të kufizuara duheshin dorëzuar për t'i dhënë përparësi veprimtarive për pranim të kërkesave para skadimit të afatit për të bërë një gjë të tillë, më 3 dhjetor të vitit 2007, dhe për të ruajtur vrullin e krijuar në veprimtaritë e përpunimit dhe shqyrtimit të kërkesave. Mungesa e plotë e fondeve për të paguar rrogat në fund të vitit 2007 e detyroi KPA-në që të zvogëlojë numrin e posteve ndërkombëtare.

¹ Deri në datën e publikimit të këtij raporti në shkurt të vitit 2008, Komisioni ka marrë vendimin për gjithsejtë 5,749 kërkesa, shih më tutje në kapitullin 4 të këtij raporti.

Më tutje, nuk mund të ndërmirrej asnjë veprimtari zbatuese dhe si rezultat KPA-ja nuk ishte në gjendje t'u dorëzojë palëve në kërkesë asnjë nga vendimet e lëshuara nga Komisioni. Kjo ngrit çështje serioze duke marrë parasysh se qëllimi i përgjithshëm i themelimit të KPA-së ishte krijimi i një procesi, i cili paraqitësve të kërkesave mund t'u ofronte një ndihmë efektive brenda një periudhe të arsyeshme kohore, derisa në të njëjtën kohë do të siguronte korrektësinë e procedurave dhe zhvillimin e procesit në pajtim me standardet për të drejtat njerëzore.

Mungesa e të hollave u zbut vetëm pjesërisht dhe përkohësisht përmes ndihmës së pranuar nga UNMIK-u, i cili ndau 516,276.00 € hua nga fondi i tij emergjent që të mundësojë pagesën e rrogave për fundin e vitit 2007; megjithatë ky financim nuk lejoi që të ndërmirret ndonjë veprim zbatimi.

Kjo situatë mbizotëron në fund të periudhës së raportimit pavarësisht nga iniciativat e shumta të ndërmarra nga udhëheqësia e KPA-së për të siguruar financimin përmes takimeve direkte me zyrat dhe institucionet e shumta ndërlidhëse në një takim të UNMIK-ut me donatorët, i cili u mbajt më 21 nëntor 2007. Këto iniciativa realizuan zotime financiare të mjaftueshme vetëm për financimin e përpunimit të kërkesave dhe veprimet e shqyrtimit deri në prill të vitit 2008. Në qoftë se nuk do të ketë përkrahje të qëndrueshme financiare, KPA -ja do të ballafaqohet edhe me një krizë fianciare në prill dhe efikasiteti i përgjithshëm i projektit do të vazhdojë të vështirësohet. Planifikimi i duhur dhe zbatimi kosto-efektiv i mandatit, i cili deri më tani ishte i vështirë do të vazhdojë të jetë i vështirë dhe koha e nevojshme për të përfunduar mandatin do të zgjatet, në këtë mënyrë tërë procesi bëhet më i shtrenjtë *pa nevojë*. Më tutje, kjo do të shkaktojë që paraqitësit e kërkesave dhe publiku i gjerë të iritohen *pa nevojë* me ritmin e ngadaltë të ekzekutimit dhe rezultateve të dukshme, sidomos në lidhje me dorëzimin e vendimeve të Komisionit dhe veprimeve zbatuese.

Është për keqardhje që institucioni, të cilit i është dhënë mandati për zgjidhjen e kontesteve të pas konfliktit, si parim kryesor i veprimit ligjor, është i varur nga sigurimi i kontributeve vullnetare donatore për ndryshim nga veprimtaritë tjera të misionit të cilat përfitojnë nga financimet 'qendrore' stabile dhe të parashikueshme. Kjo vlen edhe më tepër duke marrë parasysh se zgjidhja e kontesteve të pas konfliktit është në përgjithësi i njohur si element qendror në zhvillimin ekonomik, kthimin e popullatës së zhvendosur, sundimitë ligjit dhe stabilitetit të përgjithshëm. Në kontekst të Kosovës, kjo në mënyrë të qartë është paraqitur nga raporti i vitit 2005 nga i dërguari i Posaçëm i KB mbi Standardet (përndryshe i njohur si "Raporti i Kai

Eides”), i cili identifikoi uzurpimin e paligjshëm të tokës, apo pronës komerciale, si njërin ndër faktorët kryesor në vështirësimin e zhvillimit ekonomik dhe kthimeve në Kosovë, prandaj kërkohet intervenim urgjent. Ky gjithashtu ishte konkludim i studimit paraprak të Agjencisë Europiane për Rindërtim në dhjetor të vitit 2004 në vlerësimin e vet për nevojën e krijimit të një mekanizmi të zgjidhjes së kontesteve për toka dhe prona komerciale, dhe së fundi kjo është vërtetuar përsëri në të ashtuquajturin Planin e Ahtisarit për të ardhmen e Kosovës.

Për fat të keq, mungesa e mbështjetjes për procesin e KPA-së nuk është kufizuar vetëm në ofrimin e financimit joadekuat. Deri më tani, KPA-së nuk i është dhënë qasja në të dhënat e hartave të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK). Pavarësisht se kjo çështje është shtruar në shumë mbledhje nga zyrtarët e të gjitha niveleve të AKK-së, IPVQ-së dhe UNMIK-ut, kjo qasje ende nuk është mundësuar. Kjo përfaqëson një pengesë serioze në identifikimin e shpejtë të pronave të kërkuara dhe vonon përpunimin e kërkesave, duke e zgjatur kështu jetën e KPA-së si dhe duke e bërë procesin të shtrenjtë *pa nevojë*.

Administrimi i Pronave dhe Skema e Qiradhënies

KPA-ja mori përgjegjësinë për administrimin e pronave të braktisura banesore nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore. Rreth 4,493 prona janë nën administrimin e KPA-së dhe skema e qiradhënies është duke u zbatuar në tërë Kosovë me 3,848 prona të përfshira në këtë skemë. Deri në dhjetor të vitit 2007, nga të ardhurat e Skemës së Qiradhënies janë mbledhur gjithsej 431,000. € ²

Zbatimi i vendimeve në pritje të HPCC-së

Në fillim të periudhës së raportimit kishte rreth 721 vendime të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC), (2.5% e kërkesave të përgjithshme të parashtruara HPD-së), që prisnin zbatimin në bazë të kërkesave të paraqitësve të suksesshëm të kërkesave për riposëdimin e pronave të tyre. Të gjitha kërkesat, përpos dymbëdhjetë (12) prej tyre, janë zbatuar deri në fund

² Deri në datën e publikimit në shkurt të vitit 2008 janë mbledhur gjithsej €515,000 nga të cilat 313,000 u janë transferuar qiradhënësve, €141,000 është ndarë si sigurim për kaparë dhe €15,000 për shpenzime administrative.

të periudhës së raportimit pavarësisht nga sfidat e shumta që u shfaqën gjatë vitit. Në gusht, aktivitetet e ekzekutimit të vendimeve nga KPA-së u suspenduan nga vendimi ekzekutiv i PSSP-së për shkak të mungesës së unitetit dhe mbështetjes nga pushteti i Kosovës për procesin e ekzekutimit. Suspendimi u anulua pas një mbledhjeje të jazhtëzakonshme të Bordit Mbikqyrës të KPA-së, e cila mblodhi të gjitha grupet e interesuara kyçe dhe ri-mobilizoi mbështetjen e pushtetit të Kosovës për veprimet zbatuese. Njëmbëdhjetë nga vendimet e HPCC-së në pritje kanë të bëjnë me pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, ku autoritetet përgjegjëse ndërkombëtare atje, përgjatë gjithë periudhës së raportimit, nuk kanë mbështetur veprimet zbatuese të KPA-së.³ Për shkak të mungesës së mbështetjes dhe ndihmës nga subjektet regjionale të UNMIK-ut, në mesin e tyre edhe policia ndërkombëtare, KPA-ja u detyrua që të anulojë dëbimet e saj të planifikuara dhe për këtë arsye nuk ishte në gjendje që të përfundojë numrin e madh të lëndëve ashtu siç planifikoi në fillim.

Viti në vijim

Për vitin 2008 janë caktuar caqe të reja dhe ambicioze për zbatimin e mandatit të KPA-së. Besoj se me një përkrahje të qëndrueshme financiare, Agjencia me efikasitet do t'i përballojë sfidat, me të cilat patjetër do të ballafaqohet në vitin vijues. Komisioni është në rrugë të mbarë për shqyrtimin e një numri kërkesash të përcaktuara si qëllim i saj për vitin e parë të seancave të saj, dhe Sekretaria Ekzekutive do të vazhdojë të punojë sipas nivelit mbresëlënës të produktivitetit gjatë periudhës së raportimit.⁴ Kjo do të sigurojë një zgjidhje të shpejtë të kontestve të pazgjidhura pronësore – një çështje kjo me rëndësi shumë të madhe për Kosovën.

Dëshiroj të falënderoj personelin e KPA-së, për përkushtimin e tyre, të cilët, që të gjithë, punuan me zell gjatë gjithë periudhës së raportimit. Ata punuan me përkushtim dhe ia dolën mbanë pavarësisht nga pasiguria rreth punësimit të tyre që u krijua për shkak të mungesës së fondeve. Unë u jam shumë mirënjohës dhe u falënderohem për iniciativën dhe kontributin e tyre në punën e KPA-së dhe mirëpres angazhime të ngjashme edhe gjatë vitit në vijim.

³ Vini re, se deri në datën e publikimit të këtij raporti, vetëm 11 vendime të HPCC-së në lidhje me pronat në pjesën veriore të Mitrovicës nuk janë zbatuar për shkaqe që u përmendën më lart.

⁴ Caku i Komisionit është që të shqyrtojë rreth 11,000 kërkesa në vitin e saj të parë, dhe qëllimi i Sekretarisë Ekzekutive është që të përfundojë notifikimin e të gjitha 40,000 pronave për të cilat është bërë kërkesë, deri në gusht të vitit 2008.

Gjithashtu, mirëpres përfshirjen dhe mbështetjen e vazhduar të PSSP-së dhe autoriteteve në Beograd për procesin e KPA-së.

Dhe përfundimisht dëshiroj të falënderoj të gjithë donatorët për përkrahjen e tyre shumë të vlefshme për KPA-në - përmes kontributeve donatore si edhe përmes Bordit Mbikqyrës dhe grupeve tjera. Dëshiroj të shfrytëzoj rastin që t'i lus për ofrimin e më shumë mjeteve, shumë të nevojshme në përkrahje të procesit të KPA-së gjatë viteve në vijim, dhe në këtë mënyrë të sigurohet efikasiteti i tij në përgjithësi.

Knut Rosandhaug

Drejtor

dhjetor 2007

KAPITULLI 1

AGJENCIA KOSOVARE E PRONËS

1.1 Themelimi dhe mandati

Agjencia Kosovare e Pronës (KPA) u themelua në mars të vitit 2006 kur UNMIK-u shpalli Rregulloren 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e patundshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe ato komerciale.⁵ Kjo Rregullore, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50, përshkroi natyrën dhe mundësitë e mandatit të KPA-së për zgjidhjen e kërkesave që rezultuan nga konflikti, dhe themeloi institucionet, përgjegjësitë dhe funksionet e saj përkatëse.

KPA-së iu dha jurisdiksioni për të zgjidhur kërkesat që kishin të bëjnë me pronat e patundshme private, pa pasur nevojë që këto kërkesa t'i referohen gjykatave me jurisdikson territorial dhe lëndor mbi to.⁶ Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përcaktoi që KPA-ja kishte jurisdikson për të zgjidhur këto kategori të kërkesave:-

“kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to, ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

- (a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, si dhe*
- (b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.*

KPA-ja, gjithashtu ka mandat që të mirret me zbatimin e vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC) që ishin në pritje të ekzekutimit në mars të vitit 2006, dhe të marrë menaxhimin e dosjeve të pronave nën administrim të Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (HPD). Në ushtrimin e këtij aspekti të mandatit të saj, KPA-së iu shtuan *“të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe fuqitë e HPD-së”*⁷ Më tutje

⁵ Raporti i vitit 2005 i të dërguarit të posaçëm të KB mbi standardet (përndryshe të njohur si ‘raporti i Kai Eide-s’) identifikoi uzurpimin e paligjshëm si njerën ndër faktorët kryesor në pengimin e kthimit në Kosovë, dhe në këtë mënyrë kërkon intervenim urgjent. UNMIK-u u përgjigj në konstatimet e raportit në mars të vitit 2006 duke themeluar Agjencinë Kosovare të Pronës (KPA) sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, të ndryshuar sipas Rregullores së UNMIK 2006/50.

⁶ Megjithatë, të vihet re se ekzistonte e drejta e ankesës ndaj vendimit të Komisionit, në Gjykatën Supreme të Kosovës, shih nenin 12 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁷ Neni 17 i rregullores së UNMIK-ut 2006/50 parasheh si në vijim: *“Agjencia Kosovare e Pronës i ushtron kompetencat e ekzekutimit lidhur me çdo vendim apo urdhër për dëbim të Komisionit të Kërkesave për Çështje Banesore e Pronësore që mund të ekzekutohen në ditën e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10, por që nuk janë ekzekutuar nga Drejtoria për Çështje Banesore e Pronësore. Në ushtrimin e kompetencave të tilla ekzekutive, Agjencia Kosovare e Pronës ka të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe*

pasuritë fizike të HPD-së iu dhanë KPA-së dhe personeli i tij u riorganizua për kryerjen e detyrave të njëjta brenda KPA-së.

1.2 Përbërja

KPA-ja vepron në mënyrë të pavarur nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), si institucion autonom vendor në pajtim me kapitullin 11.2 të Kornizës Kushtetuese.⁸ Përbëhet nga tri organe, përkatësisht Sekretaria Ekzekutive, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës, që është autonom dhe kuazi-gjyqësor (“Komisioni”) dhe Bordi Mbikëqyrës.⁹ Mandatet dhe veprimet përkatëse të këtyre institucioneve u përcaktuan në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 dhe në Urdhëresën Administrative 2007/5, e cila u shpall në qershor të vitit 2007.¹⁰

Zyra qendrore e KPA-së gjendet në Prishtinë.¹¹

1.2.1 Sekretaria Ekzekutive

Përgjegjësitë kryesore të Sekretarisë Ekzekutive përfshijnë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave si dhe përgjigjet ndaj kërkesave dhe përpunimit të kërkesave para prezentimit të tyre për shqyrtim para Komisionit. Përpunimi i kërkesave përfshinë këto veprimtari:

- (i) Njoftimi i shfrytëzuesve të pronave, për të cilat është bërë kërkesë, si dhe palëve të interesuara për kërkesat;
- (ii) Verifikimi i dokumenteve;
- (iii) Mbledhja e dëshmimeve dhe mbajtja e intervistave me palët në kërkesë;
- (iv) Përgatitja e parashtresave me shkrim mbi kërkesat ; si dhe
- (v) Grupimi i kërkesave për referim Komisionit për shqyrtim.¹²

Sekretaria Ekzekutive gjithashtu ka mandat që të sigurojë zbatimin efikas të vendimeve përfundimtare të kërkesës.¹³ Kjo do të arrihet përmes ndihmës juridike, siç është vënia e pronës nën administrimin e KPA-së, riposidimi, konfiskimi i objekteve të paligjshme, ankandi, kompensimi dhe marrëveshjet mbi qiranë, të cilat do të ndihmojnë dhe sigurojnë kthimin e pronave bartësve të ligjshëm të tyre.¹⁴

kompetencat që i ka pasur Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10.

⁸ Shih rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë.

⁹ Shih nenin 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹⁰ Urdhëresa administrative e UNMIK-ut 2007/5 që zbaton rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronat e patundshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale (tash e tutje “Urdhëresa Administrative 2007/5”).

¹¹ Rruga “Nazim Gafurri”, (ish-Miladin Popovic), nr. 31, Prishtinë, Kosovë.

¹² Shih nenin 6.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹³ Shih kapitullin V të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe kapitullin VII të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

¹⁴ Shih nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Çdo aspekt i veprimeve të Sekretarisë Ekzekutive është shqyrtuar në hollësi në kapitullin vijues të këtij raporti.

1.2.2 Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës

Komisionit i është dhënë jurisdiksioni që të shqyrtojë kërkesat e referuara nga Sekretaria Ekzekutive. Komisioni përbëhet nga kolegji prej dy anëtarëve ndërkombëtarë dhe një vendor, të emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në maj të këtij viti.¹⁵ Anëtari vendor u emërua nga PSSP-ja pas caktimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës¹⁶ dhe PSSP-ja gjithashtu caktoi njërin nga anëtarët e kolegjit si kryetar të Komisionit.¹⁷

Selia e Komisionit është në Prishtinë¹⁸ ku Komisionit i lejohet të kryej funksionet e veta gjyquese përmes thirrjes së seancave të drejtpërdrejta, të cilat mbahen në dhomën e mbledhjeve që është në dispozicion në zyrën qendrore të KPA-së.¹⁹ Komisioni gjithashtu mund të mbajë seancë diku tjetër, apo të mbajë shqyrtime përmes mjeteve elektronike në rastet kur kjo është e nevojshme. Në praktikë, seancat zakonisht janë mbajtur çdo dy muaj.²⁰

Gjuhët zyrtare të Komisionit janë shqipja, anglishtja dhe serbishtja, por gjuha punuese është anglishtja, ndërsa përkthimi ofrohet sipas nevojës.²¹

Në konsultim me Komisionin, PSSP-ja mund të themelojë kolegje shtesë nëse këte e kërkon vëllimi i punës²²

Sekretaria Ekzekutive i ofron Komisionit mbështetje administrative, teknike dhe ligjore. Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive cakton një ekip të personelit që t'i ndihmojë Komisionit në ekzekutimin e veprimeve të saj juridike, që përfshinë sekretarin ligjor dhe personelin mbështetës administrativ.²³

Rregullat e evidentimit dhe procedurës, sipas së cilave zhvillohet shqyrtimi i kërkesave, janë përcaktuar në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5.²⁴

¹⁵ Shih nenin 7.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Shih nenin 7.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹⁸ Shih nenin 1.7 të shtojcës III të Urdhëresës Administrative 2007/5.

¹⁹ Në konsultim me anëtarët tjerë, kryetari i Komisionit përcakton numrin dhe datën e seancave, shih nenin 4.1 të shtojcës III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

²⁰ Deri më sot janë mbajtur seanca në qershor, gusht, tetor dhe dhjetor të vitit 2007 dhe shkurt të vitit 2008, shih kapitullin tjetër 4 të këtij raporti.

²¹ Shih nenin 3 të rregullores së UNMIK-ut të Urdhëresës Administrative 2007/5.

²² Shih nenin 7.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

²³ Shih nenin 1.8 të shtojcës III të Urdhëresës Administrative 2007/5.

²⁴ Shih kapitullin 4 të këtij raporti në vijim.

Anëtarët e KPCC-së janë:

Z. Veijo Heiskanen (Finlandë) është kryetar i Komisionit. Më parë ai ishte anëtar i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore në Kosovë. Ka diplomuar në Universitetin e Helsinkit dhe në Shkollën Ligjore të Harvardit; ka marr titullin Magjistër i Drejtësisë në vitin 1998 dhe Doktor i Shkencave Juridike në vitin 1992. Specializoi në të Drejtën Ndërkombëtare; të Drejtën Arbitrare Komerciale; të Drejtën e tregut dhe internetit. Para pozitës së tij në LALIVE si avokat në Gjenevë, ai shërbeu si Sekretar i Përgjithshëm dhe Gjyqtar i Lartë i Kërkesave të Gjykatës për zgjidhjen e kërkesave për xhirrologaritë e papërdorura në Zvicër (2001-2002); Drejtor i Institutit të Ligjit Ekonomik Ndërkombëtar të Helsinkit (1998-2000); Zëvendës Kryetar i Shërbimit Ligjor të Komisionit për Kompensim të KB (1994-1998); dhe Këshilltar Ligjor në Tribunalin e Kërkesave Iran-SHBA në Hagë (1990-1994). Ligjëroi në Institute të ndryshme, përfshirë edhe në Universitetin e Helsinkit dhe Akademinë e Ligjit Ndërkombëtar; Ishte vizitor Akademik me Universitetin e KB në Tokio (1999); Punoi për Komisionin Arbitrar të Konferencës Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë (1993); Gjithashtu ishte anëtar i Komitetit Drejtues mbi Proceset Ndërkombëtare të Kërkesave në numër të madh në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit. Eshtë autor i publikimeve të shumta mbi Ligjin Ndërkombëtar; Arbitrimin Ndërkombëtar dhe zgjidhje të kontesteve.

Z. Norbert Wühler (Gjermani) është anëtar ndërkombëtar i Komisionit. Ka diplomuar dhe mbrojtur doktoranturën në lëmin e drejtësisë në Universitetin e Heidelbergut. Aktualisht është Drejtor i Programeve për Rindërtim në Organizatën Ndërkombëtare për Migrim. Pozitat e mëparshme të tij përfshijnë: Udhëheqës i Filialës së Shërbimeve Ligjore të Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Kompensim (1992-2000), Këshilltar Ligjor i Kryetarit dhe Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të Tribunalit për Kërkesa Iran-SHBA (1983-1991), Partner Hetimi në Institutin Max Planck për Ligjin Krahësues Publik dhe Ligjin Ndërkombëtar në Heidelberg (1978-1983) dhe Përfaqësues Ligjor i pranuar tek Avokatët e Heidelberg-ut dhe Mannheim-it (1979-1983). Ishte Kryetar, anëtar dhe Sekretar i disa gjykatave ndërkombëtare arbitrare, Këshilltar i Komisionit për Kërkesat e Pronës së Patundshme në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Komisionit për Kërkesa Eritre-Etiopi, dhe është anëtar i Komisionit Drejtues mbi Proceset Ndërkombëtare të Kërkesave në numër të madh në Gjykatën e Përhershme të Arbitrimit. Po ashtu, është edhe anëtar i Grupit të Këshilltarëve-Ekspertë mbi Pjesëmarjen e Viktimave dhe Riparimeve në Gjykatën Penale Ndërkombëtare. Ligjëroi dhe publikoi punime mbi kërkesat pronësore dhe kompensimin ndërkombëtar.

Z. Aqif Tuhina është anëtar vendor i Komisionit. Më parë ka shërbyer si anëtar vendor i Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore. Diplomoi në drejtësi në vitin 1964 në Universitetin e Beogradit. Para profesionit të tij aktual si avokat ligjor, shërbeu si Gjyqtar në Kosovë si në Gjykatën e Punës së Bashkuar ashtu edhe në Gjykatën Supreme para humbjes së autonomisë së Kosovës në vitin 1989. Së fundi ai punoi për Sekretariatën për Jurisprudencë dhe Administratë të Krahinës së Kosovës dhe në

Departamentin e UNMIK-ut për Çështje Juridike. Është ekspert në Ligjin e Pronës së patundshme dhe në Ligjin Penal.

1.2.3 Bordi Mbikëqyrës

Bordi Mbikëqyrës ka mandat për të mbikëqyrur punën e KPA-së dhe për t'i siguruar asaj mbikëqyrje administrative, orientim të përgjithshëm dhe udhëzim politik. Megjithatë, në mënyrë të qartë është parandaluar pjesëmarrja në procesin në të cilin KPCC-ja shqyrton dhe i merr vendimet mbi kërkesat.²⁵

Sipas nenit 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, Bordi përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të emëruar nga PSSP-ja dhe dy nga këta anëtarë caktohen pas emërimit nga Kryeministri i Kosovës. Njërin prej tre anëtarëve, e që nuk është emëruar nga Kryeministri, PSSP-ja e cakton si Kryetar.²⁶

Pesë anëtarët e Bordit Mbikëqyrës janë emëruar më 29 qershor të vitit 2006 si në vijim:

- Z. Steven Schook, Zëvendësi Kryesor i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PDPSSP), u emërua si anëtar dhe Kryetar i Bordit;

Personat në vijim u emëruan në këtë bord për të përfaqësuar interesin publik:-

- Z. David Blunt, (nga Zyra Ndërlidhëse Britanike);
- Z. Kirk McBride, i cili pas shkuarjes u zëvendësua nga z. Thomas K. Yazdgerdi në shtator të vitit 2006, (nga zyra e SHBA-së);
- Z. Ardian Gjini, (i Emëruar nga Kryeministri);
- Z. Milorad Todoroviq, (i emëruar nga Kryeministri).

Për shkak të ngjarjeve të fundit të vitit 2007, anëtarësia e Bordit Mbikëqyrës do të ndryshojë dhe do të emërohen anëtarë të rinj në fillim të vitit 2008. Zgjedhjet vendore rezultuan me ndryshimin e udhëheqësisë politike; rrjedhimisht të emëruarit e Kryeministrit do të rishikohen. Më tutje, Kryetari i Bordit është larguar nga misioni.

Në pajtim me kompetencat e Kryetarit, duke vepruar në konsultim me anëtarët e Bordit, për caktimin e një apo më shumë personave që të marrin pjesë në punën e Bordit mbi baza *ad hoc*, Këshilltari Ligjor dhe përfaqësuesi i UNMIK-ut Departamenti i Administratës Civile, janë ftuar që të marrin pjesë në të gjitha mbledhjet e Bordit. Së fundi, përfaqësuesit e bashkësisë së gjerë të donatorëve dhe BE-së janë ftuar që të marrin pjesë në mbledhje, duke siguruar në këtë mënyrë platformën për të kërkuar mbështetje për procesin nga subjektet tjera, bashkëpunimi dhe mbështetja e të cilëve është vendimtare për zbatimin e suksesshëm të mandatit të KPA-së. Në mbledhjet e fundit morën pjesë Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, përfaqësuesit e Zyrave Ndërlidhëse

²⁵ Shih nenin 5.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

²⁶ Shih nenin 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Mbledhja inauguruese e Bordit u mbajt më 12 korrik të vitit 2006.

të Danimarkës, Belgjikës, Zvicrës dhe Gjermanisë, Agjencia Europiane për Rindërtim (AER) dhe Ekipi i UE për Planifikim ('EUPT').

Vendimet e marra në Bord kërkohet të merren me konsensus, por kur nuk mund të arrihet konsensusi, vendimet mund të merren me shumicën e thjeshtë.²⁷

Sekretaria Ekzekutive, Bordit i ofron shërbime të sekretarisë. Kjo përfshinë organizimin e mbledhjeve, përgatitjen e agjendës së mbledhjes, mbajtja e procesverbalit në mbledhje, shpërndarjen e dokumenteve dhe informacioneve të rëndësishme dhe monitorimin e veprimeve të mëtutjeshme në lidhje me këshillat e pranuar nga Bordi.²⁸

Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive i raporton Bordit Mbikëqyrës dhe i dorëzon raportin mbi zbatimin e mandatit të KPA-së, dhe mbi çështjet administrative, funksionale dhe të financimit.²⁹ Raporti qarkullon tek anëtarët e Bordit para mbledhjeve dhe shoqërohet me diagramet dhe statistikat për të demonstruar strukturën administrative dhe funksionale të institucionit, zbatimin e mandatit të saj dhe çështjet buxhetore.

Mbledhjet mbahen çdo tre muaj. Gjatë vitit 2007, mbledhjet e rregullta u mbajtën në shkurt, maj dhe shtator. Mbledhja e dhjetorit u anulua për shkak të shkuarjes së kryetarit të Bordit nga Kosova.

Mbledhjet në përgjithësi merreshin me shqyrtimin e veprimeve të nevojshme që duheshin marrë për zbatimin e mandatit të KPA-së. Mbledhja e majit u përqëndrua në shqyrtimin e dispozitave të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 dhe emërimin e anëtarëve të Komisionit³⁰, derisa mbledhjet gjatë fundit të vitit 2007 u përqëndruan në adresimin e krizave të financimit të KPA-së, takim ky që rezultoi me kërkesën e Bordit PSSP-së për mbajtjen e një mbledhje të donatërovë në nëntor.³¹

Kryetari, gjithashtu ka fuqinë për të thirrur mbledhje të jashtëzakonshme.³² Një mbledhje e jashtëzakonshme e Bordit u mbajt në muajin gusht për të shqyrtuar Vendimin Ekzekutiv të lëshuar nga PSSP-ja, më 2 gusht, e cila përkohësisht suspendoi zbatimin e veprimeve të KPA-së. Ky Vendim Ekzekutiv erdhi si rezultat i mungesës së unitetit dhe përkrahjes në mesin e grupeve të interesuara kyçe për zbatimin e vendimeve të pazbatuara të HPCC-së, që përfshinte dëbimin e banorëve të paligjshëm nga pronat, për të cilat është paraqitur kërkesë. Në këtë mbledhje Bordi Mbikëqyrës shërbeu si platformë për të marrë parasysh rolin e KPA-së në ekzekutimin e urdhërave për dëbim nga perspektiva e sigurimit të rikthimit të pronave bartësve ligjor të së drejtës pronësore dhe

²⁷ Antarët e Bordit Mbikëqyrës kanë nga një votë. Në rastet kur ka ndarje të barabartë të votave, kryetari do ta ketë votën vendimtare, shih nenin 4.3 të shtojcës i të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5. Të gjitha vendimet e që u morën nga Bordi gjatë priudhës së raportimit ishin unanime.

²⁸ Shin nenin 2 të shtojcës 1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

²⁹ Shin nenin 1.1 të shtojcës 1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 dhe vini re gjithashtu nenin 10.3 të Urdhërësës Administrative.

³⁰ Anëtarët e Komisionit u emëruan më 14 Maj 2007 dhe Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2007/5 u shpall më 1 qershor të vitit 2007.

³¹ Shih kapitullin 8 të këtij raporti në vijim.

³² Shin nenin 3.1 të shtojcës 1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

përkrahjen e sundimit të ligjit. Mbledhja arriti që të ri-vërtetonte përkrahjen e të gjitha grupeve të rëndësishme si palë të interesuara.³³

Më tutje, në këtë mbledhje, u shqyrtua një kërkesë nga Ndërmarrja Publike Banesore e Prishtinës (NPB) për shfrytëzimin e ‘shërbimeve të mira’ të KPA-së për të ndihmuar riposedimin e 235 pronave të uzurpuara, që ishin në pronësi të saj, së bashku me një kërkesë të ngjashme nga Universiteti i Prishtinës për ndihmë në sigurimin e riposedimit të rreth 40 pronave banesore. Gjithashtu, u shqyrtua një kërkesë shtesë e përshpejtuar nga Agjencia Kosovare për Mirëbesim (AKM) për ndihmë në riposedimin e rreth 180 pronave banesore. Para mbledhjes, Kryeministri i kishte shkruar KPA-së duke kërkuar që veprimtaritë e ekzekutimit në lidhje me kërkesën e NPB-së të suspendohen, derisa të adresoheshin nevojat e strehimit të banorëve. Kërkohej udhëzimi i Bordit nëse duhej të aprovohej kërkesa e NPB-së apo jo. Në mbledhjen e jashtëzakonshme, Bordi votoi kundër aprovimit të kësaj kërkesë me arsyetimin se autoritetet komunale nuk ishin të gatshme që të ndihmonin të dëmtuarit dhe se nuk kishte përkrahje të mjaftueshme nga grupet e interesit. U vendos që ky qëndrim të mbetet deri sa të krijohet uniteti i nevojshëm për këtë qëllim dhe të sigurohet angazhimi, i cili publikisht do të vërtetohet nga subjektet e rëndësishme të IPVQ-ve. Deri më tani kjo nuk është arritur, dhe si rezultat KPA-ja nuk i ofroi këto shërbime për asnjërën nga palët e përfaqësuara në kërkesë.

1.3 Korniza e aplikueshme ligjore

Sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244³⁴ (‘SC1244’) e gjithë kompetenca legislative dhe ekzekutive iu dha UNMIK-ut dhe ajo do të ushtrohet nga PSSP-ja.³⁵ Në korrik të vitit 1999, PSSP-ja shpalli Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1, e cila përpos tjerash parashihte që UNMIK-u të kryente detyrat e saj nën rezolutën 1244 të KS menjëherë e akteve ligjore në formë të Rregulloreve.³⁶

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 mbi kompetencën e Administrimit të Përkohshëm në Kosovë, e ndryshuar me Rregullores 1999/24, rregullon sistemin ligjor në Kosovë, që përbëhet nga një përzierje e ligjeve të Krahinës Autonome të Kosovës të para vitit 1989, të ligjeve të ish-Jugosllavisë pas vitit 1989, Rregulloreve të UNMIK-ut, mjeteve ndihmëse si dhe standardave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.³⁷

³³ Shih Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut nr. 2007/41, i cili përkohësisht suspendon nenin 17 të Rregullores 2006/50 të UNMIK-ut të datës 16 tetor 2006 mbi zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronën e patundshme private, përfshirë pronat bujqësore dhe komerciale. Vendimi u shfuqizua pas një jave me Vendimin Ekzekutiv të UNMIK-ut. 2007/43 që shqyrtohet më tutje në paragrafin 5.2.1 në kapitullin 5 të këtij raporti.

³⁴ Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit (1999) Kosovë, Dok. i UN S/RES/1244 (1999), e miratuar nga Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e saj të 4011^{te} më 10 qershor të vitit 1999.

³⁵ Shih raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi UNMIK-ut, UN SCOR, Seanca e 54-të, Dok. i UN S/1999/779 (1999) në parag. 35 dhe 39.

³⁶ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/1 mbi Autoritetin e Përkohshëm Administrativ në Kosovë.

³⁷ Shih nenin 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Aplikueshëm në Kosovë, të ndryshuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/59.

Rregulloret e UNMIK-ut dhe mjetet ndihmëse i zëvendësojnë të gjitha ligjet e mëparshme që rregullonin çështjet e njëjta. Ligjet vendore që ishin në fuqi deri në mars të vitit 1989, kur Kosova humbi autonominë e saj, janë të aplikueshme për atë që sa rregullojnë çështjet që bien jashtë fushës dhe zbatimit të rregulloreve të UNMIK-ut. Sa i përket legjislacionit të pas vitit 1989, ai mund të aplikohet vetëm në rrethana të kufizuara, si për shembull kur gjykata, organi apo personi, që duhet të zbatojë dispozitën e ligjit përcakton se një çështje apo situatë nuk është përfshirë në ligjet e para vitit 1989, por është përfshirë nga një ligj tjetër në fuqi në Kosovë pas 22 marsit të vitit 1989, e që nuk është diskriminues apo në shpërputhje me standardet për të drejtat e njeriut.³⁸

Korniza ligjore dhe procedurat që drejtojnë zgjidhjen e kërkesave pronësore bazohet në kombinimin e legjislacionit të UNMIK-ut, jurisdiksionit të Komisionit dhe udhëzimeve të tij që rregullojnë përpunimin e kërkesave. Ligjet e së drejtës materiale që drejtojnë zgjidhjen e kërkesave pronësore përfshihen në ligjet juridike vendore.

1.3.1 Legjislacioni i UNMIK-ut

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/10, e ndryshuar sipas Rregulloreve 2006/50, themeloi KPA-në, institucionet e saj dhe mandatet e funksionet e saj përkatëse. Gjithashtu, përshkroi fushëveprimin e kërkesave që hyjnë nën jurisdiksionin e procesit të KPA-së.³⁹ Në qershor të vitit 2007 u shpall Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2007/5, e cila përcakton rregullat e procedurës dhe evidentimit, sipas së cilave zgjidhen dhe zbatohen kërkesat.

Shtojca I e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 përcakton rregullat e procedurës dhe parimet e përgjithshme që rregullojnë punën e Bordit Mbikëqyrës. Shtojca II përcakton detyrat, përgjegjësitë dhe rregullat e punës së Sekretarisë Ekzekutive në lidhje me pranimin dhe regjistrimin e kërkesave, njoftimin dhe pjesëmarrjen e palëve dhe ekzekutimin e vendimeve të Komisionit. Shtojca III përmbanë rregullat e procedurës dhe evidencës që vlejné për veprimet para Komisionit.

1.3.2 Udhëzimet plotësuese të Komisionit

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 i lejon Komisionit të miratojë rregulla shtesë për të ushtruar funksionet e tij, me kusht që të jenë në pajtim me Rregulloren.⁴⁰ Në pajtim me këtë autoritet, Komisioni lëshon udhëzime të njohura si 'Udhëzime të Procedimit' që rregullojnë procesin e shqyrtimit të kërkesave dhe përpunimit të tyre nga Sekretaria Ekzekutive para referimit të tyre në Komision.⁴¹

³⁸ Shih nenin 1.2 të Rregulloreve të UNMIK-ut 1999/24.

³⁹ Shih paragraf. 1.1 në këtë raport.

⁴⁰ Shih nenin 1.10 të shtojcës III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁴¹ Këto rregulla shtesë janë lëshuar nga Komisioni pas çdo séance në dokumentin e quajtur 'Udhëzimet e Përpunimit', të cilat qarkulluan nëpër të gjithë personelin të përfshirë në veprimtaritë e përpunimit të kërkesave. Një publikim që përmbante udhëzimet e Komisionit që udhëhiqte përpunimin e kërkesave

1.3.3 Ligjet vendore

Ligjet, në të cilat Komisioni bazohet me rastin e vendosjes për përcaktimin e të drejtave pronësore të palëve janë ligjet e aplikueshme pronësore vendore, e sidomos:

- Ligjin mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore, (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 6/80);
- Ligjin mbi Ekspropriimin, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 21/78);
- Ligjin mbi Bashkëpronësinë në Banesa, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 43/80, 22/87);
- Ligjin mbi Mbindërtimet e Ndërtesave dhe Shëndrrimin e Lokaleve të Përbashkëta në Banesa, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 14/88);
- Ligji mbi Qarkullimin e Pasurisë së paluajtshme, (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 45/81, 29/86, 26/88);
- Ligji mbi Regjistrimin e Pasurive të Patundshme në Pronësinë Shoqërore, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 37/71);
- Ligji mbi Ndërtimin e Objekteve Investive – Qëllime Komerciale, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 5/86);
- Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (Gazeta Zyrtare e ish Jugosllavisë, nr. 31/93);
- Ligji mbi Pyjet, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 46/86 dhe 10/87);
- Ligji mbi Marrëdhëniet Banësore, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 11/83, 29/86 and 42/86);
- Ligji mbi Tokën Ndërtimore, (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 14/80 dhe 42/86); si dhe
- Ligji mbi Matjen dhe Kadastrën e Tokës (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, nr. 12/80).

1.3.4 Korniza e aplikueshme për të drejtat e njeriut

Rregullorja e UNMIK-ut 1999/1 përcakton se si duhet të ushtrohet kompetenca legislative nga UNMIK-u dhe i obligon të gjithë personat, që janë në detyra publike dhe mbajnë poste zyrtare që të zbatojnë standardet për të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht.⁴² Për më shumë, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë pjesë e ligjit të aplikueshëm, përmes, *inter alia*, Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 (të ndryshuar sipas 2000/59). Neni 1.3 i Rregullores kërkon pajtueshmëri me standardet e përcaktuara me aktet në vijim:

aktualisht po hartohet dhe do të botohet në vitin 2008. Ky publikim do të përditësohet pas çdo séance të Komisionit dhe do të jetë në dispozicion në letër dhe në web faqen e KPA-së www.kpaonline.org

⁴² Shih nenin 2 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1, e cila dënon ligjërisht diskriminimin ndaj çdo personi mbi çfarëdo baze si p. sh. gjinisë, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, mendimeve politike apo të tjera, origjinës kombëtare, etnike apo shoqërore, që ka të bëjë me bashkësinë kombëtare, pronën, lindjen apo statusin tjetër.

- Deklarata Univerzale mbi të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe liritë themelore si dhe protokolleve të saj;
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike si dhe Protokolleve të saj;
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore;
- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminit Racor;
- Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminit ndaj Femrave;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Denimeve tjera Mizore, Jonjerëzore apo Degraduese; si dhe
- Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Fëmijëve.

KAPITULLI 2

PRANIMI I KËRKESAVE DHE NJOFTIMI I PALËVE

2.1 Pranimi i kërkesave

Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, të ndryshuar me Rregulloren 2006/50, KPA-së i është dhënë mandat ekskluziv për të pranuar kërkesat që bien nën jurisdiksionin e saj. Më tutje, lëndët që bien nën jurisdiksionin e KPA-së, dhe të cilat u janë parashtruar gjykatave kombëtare, por shqyrtimi i të cilave nuk kishte filluar deri në datën e shpalljes së Rregullores, duhet dorëzuar KPA-së për shqyrtim.⁴³

Kërkesat mund t'i parashtroheshin Sekretarisë Ekzekutive nga personat fizik dhe juridik. Procedura e KPA-së nga paraqitësit e kërkesës kryesisht kërkonte që kërkesat t'i parashtronin personalisht.⁴⁴ Në rastet, kur personi fizik nuk mund të parashtronte kërkesën, kërkesa mund të bëhej nga njëri prej anëtarëve të ngushtë të familjes së tij/saj.⁴⁵ Duke shpjeguar dispozitat e Rregullores, Komisioni përcaktoi se anëtar të ngushtë të familjes konsiderohen këta anëtarë të familjes:: bashkëshorti/ja, fëmijët, prindi, vëllau, motra, gjyshi, gjyshja, dhe nipi/mbesa (të lindur brenda apo jashtë martesës apo të adoptuar).⁴⁶ Gjithashtu, personi fizik mund të parashtronte kërkesë përmes një përfaqësuesi të autorizuar, i cili posedonte autorizimin e vlefshëm dhe të plotfuqishëm.⁴⁷

Sipas Rregullores personat juridik duhej të parashtronin kërkesën përmes juristit, i cili ishte anëtar i Shoqatës së Avokatëve në Kosovë, në Republikën e Serbisë apo në Republikën e Malit të Zi.⁴⁸

⁴³ Shih nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 që përcakton se “Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje, që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.”

⁴⁴ Shih nenin 9.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Deri në fund të periudhës së raportimit, rreth 17,863 paraqitës të kërkesës kishin parashtruar kërkesat personalisht.

⁴⁵ Shih nenin 5.2 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 dhe nenin 1.2 të shtojcës II të po asaj Urdhërese Administrative.

⁴⁶ Shih jurisprudencën e Komisionit në KPCC/D/5/2007 që gjindet në www.kpaonline.org. Deri në fund të periudhës së raportimit, rreth 20,687 anëtarë të bashkësisë familjare kanë parashtruar kërkesa në emër të bartësve të së drejtës pronësore.

⁴⁷ Shih nenin 5.2 dhe 5.3 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5. Deri në fund të periudhës së raportimit, rreth 281 përfaqësues të autorizuar kanë parashtruar kërkesa në emër të paraqitësve të kërkesës.

⁴⁸ Shih nenin 5.1 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5. Deri në fund të periudhës së raportimit, rreth 151 kërkesa të regjistruara janë paraqitur nga personat ligjorë.

2.2 Vendndodhja e zyreve për pranimin e kërkesave

Kërkesat duhej parashtruar në cilëndo prej zyrave të KPA-së apo njërive lëvizëse duke plotësuar formularin e kërkesës me ndihmën e zyrtarit të KPA-së. Neni 9 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 lejon themelimin e zyrave për të ndihmuar në regjistrimin e kërkesave nëpër tërë Kosovën. Zyrat ishin të hapura në secilën prej pesë zyrave regjionale dhe njësitë lëvizëse ndihmonin enklavat e minoriteteve dhe zonat rurale.⁴⁹ Pranimi i kërkesave në Kosovë filloi më 5 prill 2006.

Në pajtim me kompetencat e saj për krijimin e procedurës për të ndihmuar pranimin e kërkesave nga refugjatët dhe të zhvendosurit që banojnë jashtë Kosovës,⁵⁰ Sekretaria Ekzekutive hapi zyra në Serbi, Mal të Zi dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.⁵¹

2.3 Formulari i kërkesës

Formulari elektronik është hartuar nga Sekretaria Ekzekutive dhe paraqitësit e kërkesës ftoheshin që të vinin në njerën nga zyrat e KPA-së për të plotësuar formularin. Për të ndihmuar paraqitësit e kërkesës në parashtrimin e kërkesës, atyre u bëhej një sërë pyetjesh nga zyrtarët e pranimit të kërkesës dhe përgjigjja e tyre regjistrohej në mënyrë elektronike.⁵² Informacioni mund t'i ofrohej zyrtarit për pranimin e kërkesës në shqip apo serbisht.

Pasi plotësoheshin të gjitha fushat relevante të formularit, zyrtari për pranimin e kërkesës shtypte një kopje të kërkesës, e cila i jepej paraqitësit të kërkesës që t'a lexojë dhe të vërtetojë saktësinë. Pas leximit të formularit dhe të pohuarit se ajo pasqyronte saktësinë dhe vërtetësinë e kërkesës, paraqitësi i kërkesës, apo personi i autorizuar i tij/saj, duhej ta nënshkruante formularin në prani të zyrtarit për pranimin e kërkesës, i cili pastaj edhe vetë e nënshkruan atë.

Paraqitësit e kërkesës kur parashtronin kërkesën u kërkohej të kishin letërnjoftimin e tyre me vete, apo ndonjë dokument tjetër identifikues për vërtetim të identitetit. Një kopje e dokumenteve të identitetit të paraqitësit të kërkesës i bashkangjitej formularit të kërkesës

⁴⁹

Pesë zyrat regjionale të KPA-së gjindeshin në Gjilan, Mitrovicë (me nënzyrat në pjesën veriore dhe asaj jugore të qytetit), Pejë, Prishtinë (me nën zyrë në Graçanicën e banuar nga serbët) dhe Prizren.

⁵⁰ Shih nenin 9.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁵¹ Pranimi i kërkesave në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (zyra e Shkupit) dhe Mali i Zi (zyra në Podgoricë) filloi në shtator të vitit 2006. Sa i përket strukturës institucionale dhe zyrave, shih më tutje në parag. 7.1 të kapitullit 7 në këtë raport.

⁵² Shih nenin 2.1 të shtojcës II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e cila përcaktoi që formulari i kërkesës të përmbante këto detaje:

- (a) Emrin e paraqitësit të kërkesës;
- (b) Një adresë për dorëzimin e dokumenteve;
- (c) Faktet, mbi të cilat paraqitësi i kërkesës u mbështet, dhe lloji, masa dhe baza për kërkesën.; si dhe
- (d) Lloji i ndihmës që kërkohet

për t'u futur në dosjen e kërkesës. Paraqitësit e kërkesës, gjithashtu duhej të parashtrojnë origjinalet apo çfarëdo kopje të vërtetuar, në të cilat kërkesa mbështetej dhe të cilat ata i posedonin apo kishin mundësi për t'i siguruar. Një kopje e këtyre dokumenteve vendosej në dosjen e kërkesës dhe origjinalet i ktheheshin paraqitësit të kërkesës meqenëse Sekretaria Ekzekutive nuk i mbante dokumentet origjinale në dosje.⁵³

2.4 Afati kohor për parashtimin e kërkesës

Afati kohor brenda, të cilit mund të parashtrohen kërkesat në KPA ishte përcaktuar në nenin 8 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e cila përshkruante se kërkesa mund të parashtrohej në ose para skadimit të afatit prej gjashtë muajsh nga data e shpalljes së Urdhërësës Administrative, që ishte 3 dhjetori 2007.⁵⁴ Derisa në Urdhërësën Administrative ekziston dispozita që lejon zgjatjen e afatit përfundimtar për parashtimin e kërkesave sipas shpalljes së PSSP-së, afati përfundimtar nuk u zgjat.

2.5 Statistika mbi llojin dhe numrat e kërkesave të regjistruara

Në datën përfundimtare për pranimin e kërkesave më 3 dhjetor, në KPA ishin regjistruar rreth 38,335 kërkesa. Disa ditë para përfundimit të pranimin të kërkesave, edhe 687 paraqitës tjerë të kërkesës iu drejtuan zyrave të KPA-së që të parashtrojnë kërkesa dhe në mënyrë që të shqyrtohet ky numër i madh kërkesash, këtyre paraqitësve të kërkesës iu caktuan takimet në mënyrë që t'u mundësohen intervista shpesh për të plotësuar regjistrimin e kërkesave të tyre. Përpos kësaj, KPA-ja ka pranuar raste që i ishin parashtuar gjykatave komunale, e të cilat hynin nën jurisdiksionin e saj, por të cilat nuk kishin filluar të shqyrtohen deri në datën e shpalljes së Rregullores.⁵⁵ Numri përfundimtar i kërkesave pritet të jetë afër 40,000.

Nga 38,335 kërkesa të regjistruara, rreth 34,509 (90%) kërkesa kanë të bëjnë me toka bujqësore, derisa 1,014 (2.6%) ishin parashtuar për pronë komerciale dhe 2,812 (7.4%) kanë të bëjnë me pronë banesore. Në 99% të kërkesave, paraqitësit e kërkesës pohojnë të drejtën pronësore mbi pronën e kërkuar. Numri më i madh i kërkesave kanë të bëjnë me pronat në regjionin e Pejës.⁵⁶

Në rreth 2,394 (6.2%) kërkesa, paraqitësit e tyre kanë kërkuar kompensim monetar për shfrytëzim të paligjshëm, dëme apo shkatërrim të pronës.⁵⁷

⁵³ Shih nenin 2.2 e shtojcës së Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁵⁴ Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2007/5 u shpall më 3 qershor të vitit 2007.

⁵⁵ Shih nenin 18 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e shqyrtuar në paragraf 2.1 në kapitullin 2 të këtij raporti. KPA-ja ka pranuar rreth 700 të këtyre rasteve nga gjykatat komunale. Meqenëse, disa nga palët janë kanë bërë ankese ndaj vendimit të gjykatës komunale për t'i referuar lëndët e tyre KPA-së për shqyrtim, numri i përgjithshëm i lëndëve aktuale për përpunim nuk është konstatuar ende.

⁵⁶ Ndaj e përditësuar e kërkesave sipas komunave është në dispozicion në www.kpaonline.org.

⁵⁷ Komisioni nuk ka jurisdiksion në shqyrtimin e kërkesave për kompensim monetar, shih më tutje, paragraf 4.6 i në kapitullin 4 të këtij raporti.

Tabelat e mëposhtme paraqesin llojin, ndarjen gjeografike dhe numrin e kërkesave të parashtruara.

LLOJI I TË DREJTËS SË KËRKUAR PRONËSORE

Regjioni/Kategoria	Gjilan	Mitrovicë	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% të kërkesave
Pronësi	8,307	3,971	13,480	6,628	5,570	37,956	99
Të drejtat për shfrytëzim	31	57	81	149	61	379	1
Gjithsej	8,338	4,028	13,561	6,777	5,631	38,335	100
% të kërkesave	21.8	10.5	35.4	17.7	14.7	100	100

KLASIFIKIMI I KËRKESAVE PRONËSORE

Regjioni/ Lloji i pronës	Gjilan	Mitrovica	Pejë	Prishtinë	Prizren	Gjithsej	% të kërkesave
Banesore	483	252	944	709	424	2,812	7.3
Ndërtesa komerciale	119	161	275	351	108	1,014	2.6
Tokë bujqësore	7,736	3,615	12,342	5,717	5,099	34,509	90
Gjithsej	8,338	4,028	13,561	6,777	5,631	38,335	100
% Të kërkesave	21.8	10.5	35.4	17.7	14.7	100	100

2.6 Notifikimi dhe publikimi i kërkesave

Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative 2007/5 adresojnë dhe rregullojnë pjesëmarrjen e palës përgjegjëse apo palëve të interesuara në procedurë. Ky proces u planifikua për të siguruar që procedurat e rëndësishme për përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave t'i plotësonin standardet e nevojshme për zhvillimin e procedurave të drejta. Edhe Rregullorja edhe Urdhëresa Administrative përcaktuan hapat proceduralë që duhej marrë për të siguruar që palët me interes ligjor në pronën e kërkuar të njoftoheshin mbi kërkesën dhe të kishin mundësi të marrin pjesë në procedurë.⁵⁸ Kjo qasje është vendimtare në sigurimin e përpunimit të duhur duke pasur parasysh se kërkesat vendosen në bazë të parashtresave me shkrim dhe palët zakonisht

⁵⁸ Shih nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenit 3 të shtojcës II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

nuk kanë mundësi që dëshmitë apo argumentet e tyre t'i prezantonin para Komisionit gojarisht.⁵⁹

Pas pranimit të formularit të kërkesës kërkohet qartësisht nga Sekretaria Ekzekutive që të njoftojë dhe t'ju dërgojë një kopje të kërkesës të gjithë personave, përpos paraqitësit të kërkesës, i cili ushtron apo pohon se ka të drejtën mbi pronën e kërkuar, dhe duhet të ndërmarrë angazhimet e duhura që të njoftojë palën tjetër, e cila mund të ketë interesim ligjor në pronë. Zyrtarët e Sekretarisë Ekzekutive janë të obliguar që të bëjnë të gjitha hetimet e nevojshme për identifikimin dhe dhënien e shërbimeve këtyre personave.⁶⁰ Palët e njoftuara kanë të drejtë të përgjigjen në kërkesë dhe të bëjnë parashtresa me shkrim apo të prezantojnë dëshmi në lidhje me kërkesën.⁶¹

Palët janë të njoftuara mbi kërkesat përmes dorëzimit të formularit të njohur si 'njoftimi mbi kërkesën' që paraqet hollësitë e kërkesës dhe llojin e së drejtës pronësore që kërkohet. Njoftimi mbi kërkesën shoqërohet me 'njoftimin mbi pjesëmarrjen', i cili njofton palën mbi të drejtën e tij/saj për pjesëmarrje në procedurë duke plotësuar njoftimin dhe duke e kthyer atë në KPA brenda tridhjetë (30) ditësh⁶² (duke dhënë hollësitë e tyre kontaktuese dhe llojin e të drejtës ligjore që kërkohet mbi pronën), ose duke shkuar personalisht në zyrat e KPA-së për të ofruar këtë informacion.⁶³

Në rastet kur personi me interes ligjor në kërkesë nuk ka mundur të njoftohet, rregullat e procedurës përcaktojnë që ai/ajo të pranohet si palë në çfarëdo faze të procedurës, me kusht që kërkesa nuk është vendosë me vendim të formes së prerë.⁶⁴

Procesi i njoftimit përfshinë publikimin e listës së të gjitha kërkesave të parashtruara në KPA, në buletin e njohur si "Gazeta e KPA-së", e cila regjistron adresën e pronës për të cilën është parashtruar kërkesa, së bashku me numrin e kërkesës. Gazeta shpërndahet si shtojcë në një gazetë në gjuhën shqipe dhe një në atë serbe⁶⁵ dhe në këtë mënyrë siguron që hollësitë e të gjitha pronave të kërkuara të arrijnë tek palët e interesuara dhe palët e mundshme përgjegjëse, brenda edhe jashtë Kosovës. Edhe 5,000 kopje të tjera janë shpërndarë në mënyrë rutinore në të gjitha komunat, gjykatat, enklavat, organizatat e IDP (personat e zhvendosur brenda vendit) dhe OJQ-të.⁶⁶ Kjo gazetë, gjithashtu publikohet online edhe në web faqen e KPA-së.⁶⁷

⁵⁹ Derisa Komisioni mund të mbajë dëgjime gojore, ky është juriisdiksion që do të përdoret në masë të kufizuar, shih paragrafin 4.4 në vijim në kapitullin 4 të këtij raporti.

⁶⁰ Gjatë periudhës së raportimit, Sekretaria Ekzekutive gjithashtu hartoi një fushatë informimi, i cili kërkon palët e mundshëm përgjegjës dhe e bën publikun më të vetëdijshëm mbi procesin e KPA-së dhe të drejtat ligjore të palëve kur kërkesa është parashtruar në lidhje me pronën e tyre, shih paragrafin 9.1 në vijim, në kapitullin 9 të këtij raporti.

⁶¹ Shih nenin 3.1 të shtojcës II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁶² Shih nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁶³ Shih nenin 3.2 dhe 3.3 të shtojcës II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁶⁴ Shih nenin 3.9 të shtojcës II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁶⁵ 'Kosova Sot' publikon 15,000 kopje, në 'Jedinstvo' publikon 20,000 kopje.

⁶⁶ Gjykatave dhe komunave rregullisht u siguroheshin verzionet e përditësuara të bashkuara të gazetës që përfshinte të gjitha kërkesat e parashtruara në KPA.

⁶⁷ Shih www.kpaonline.org.

Deri në dhjetor të vitit 2007, janë publikuar tetë (8) botime të gazetes, të cilat gjithsej kanë përfshirë 17,508 kërkesa, për të cilat është kryer notifikimi fizik në përputhje me procedurën ligjore të përshkruar më lart.

Me këtë ritëm, dhe me kusht të pranimi të mjeteve mbështetëse, Sekretaria Ekzekutive do të përfundojë notifikimin e të gjitha pronave të kërkuara deri në gusht të vitit 2008.

KAPITULLI 3

PËRPUNIMI I KËRKESAVE

3.1 Shqyrtimi i kërkesave

Procesimi i kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive përfshinë hetimin e plotë të kërkesave, verifikimin e dëshmive dhe hartimin e parashtrësve që përmbajnë vlerësimin ligjor dhe rekomandimin mbi secilën kërkesë.

Hetimi i kërkesës nënkupton hulumtimin e dokumentave të prezantuar meqenëse dëshmitë gojore zakonisht nuk mund të jepen para Komisionit.⁶⁸ Më tutje, zyrtarët e Sekretarisë të përfshirë në përpunimin e kërkesës nuk janë të kufizuar në informacionin dhe dokumentet që i ofrohen nga palët në kërkesë. Ata mund të kontaktojnë palët në rastet kur kërkohet informacioni shtesë dhe mund të bëjnë hetime tjera, *ex officio*, kur kjo është e domosdoshme, në mënyrë që të mirren të gjitha faktet në lidhje me kërkesën.

3.2 Qasja në të dhënat pronësore dhe verifikimi i dokumenteve

Hulumtimi i plotë i të gjitha burimeve efektive të dëshmive dokumentuese është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e saktë të statusit të pronës. Prandaj, njëri nga hapat e parë që përfshihet në përpunimin e kërkesës përfshinë zyrtarët e Sekretarisë Ekzekutive, që përpiqen të verifikojnë dokumentet e parashtruar në mbështetje të kërkesës, apo bëjnë hulumtime *ex officio* në të dhënat pronësore publike në rastet kur palët në kërkesë nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme dokumentuese.

Sa i përket qasjes së dokumenteve brenda teritorit të Kosovës, dispozitat e Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 parashohin që Sekretaria Ekzekutive të ketë qasje të lirë dhe të hapur në të gjitha të dhënat. Neni 4.2 i shtojcës II të Urdhëresës Administrative 2007/5 parasheh që “4.2 Sekretariati ekzekutiv mund të hetojë ndonjë kërkesë dhe të marrë dëshmi të tjera të rëndësishme për kërkesën nga çdo shënim që mbahet nga ndonjë organ publik, korporatë ose person fizik” dhe do të ketë të drejtën të ketë “qasje të pakufizuar dhe të lirë pa pagesë në të gjitha shënimet në Kosovë, të cilat janë të rëndësishme për zgjidhjen e kërkesës ose për ndonjë qëllim tjetër të verifikimit.”

Sa i përket Komisionit, neni 5.8 i shtojcës III të Urdhëresës Administrative 2007/5 parasheh që Komisioni “ka të drejtë në qasje të pakufizuar dhe të lirë pa pagesë në të gjitha shënimet në Kosovë, të cilat janë relevante për zgjidhjen e një kërkesë që është dorëzuar në këtë Komision ose për qëllime të tjera të verifikimit.”

⁶⁸ E shqyrtuar në hollësi në paragrafin 4.4 të kapitullit 4 në këtë raport.

Megjithatë KPA-së deri më tani nuk iu dha qasja në të dhënat hartografike kadastrale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK). Pavarësisht se kjo çështje është adresuar në shumë mbledhje me zyrtarë të shumë niveleve të AKK-së, IPVQ-ja dhe UNMIK-u, qasja ende nuk është bërë e mundur deri më sot. Kjo paraqet pengesë serioze në identifikimin e shpejtë të pronave për të cilat është bërë kërkesë, dhe ngadalëson përpunimin e kërkesave, në këtë mënyrë e zgjatë jetën e KPA-së duke e bërë procesin të shtrenjtë *pa nevojë*.

Qasja në të dhënat pronësore në Serbi është gjithashtu shumë e rëndësishme për verifikimin e kërkesave, meqenëse një sasi e konsiderueshme e të dhënave pronësore nga Kosova janë zhvendosur atje. Gjatë gjithë periudhës së raportimit KPA-së i është ofruar qasje e papenguar në të gjitha këto të dhëna. Vendndodhja kryesore e të dhënave në Serbi gjendet në ministritë e saj, gjykatat e zhvendosura dhe arkivat e kadastrale, Komesariatit republikan për Refugjatë dhe në Drejtoratin Republikan për Asete.

3.3 Hartimi i parashtresave ligjore mbi kërkesat

Në thelb, palët i parashtrojnë Komisionit dëshmi në lidhje me kërkesat përmes Sekretarisë Ekzekutive. Në rastet kur kërkesat kontestohen, procedura e përpunimit u ofron palëve të drejtën për tu njoftuar me dëshmitë dhe parashtresat e palës tjetër dhe për të paraqitur dëshmi dhe parashtresa si përgjigje ndaj tyre. Detajet rreth kërkesës së palëve janë të paraqitura në parashtresat ligjore që përgatiten nga Sekretaria Ekzekutive për çdo kërkesë dhe i prezantohen Komisionit.

Sekretaria Ekzekutive përgatit parashtresat ligjore mbi kërkesat pasi të jenë pranuar dëshmitë dhe parashtresat, dhe pasi të bëhet hetimi i plotë i dokumenteve mbështetëse. Parashtresat ligjore përgatiten nga zyrtarët ligjor në Njësitin për Përpunimin e Kërkesave (CPT) dhe procedura, sipas së cilës hartohen parashtresat ligjore mbi kërkesat, udhëhiqet nga Komisioni. Parashtresat ligjore duhet të përgatiten për çdo kërkesë në formë standarde në një dokumnet elektronik të njohur si ‘raport i përpunimit të kërkesës’ që përmbanë faktet dhe hollësitë kryesore të së drejtës pronësore të pohuar dhe çdo dëshmi dokumentuese në mbështetje të kërkesës.⁶⁹ Raporti përfundon me analizën ligjore dhe rekomandimet për Komisionin në lidhje me bazën ligjore të kërkesës.

Kjo është në pajtim me kriteret e nenit 4.5 të shtojcës II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 që parasheh rolin e Sekretarisë Ekzekutive në përgatitjen e *“parashtresave dhe dëshmive, përkthimit të dëshmive, dhe rekomandimeve në lidhje me të gjitha kërkesat”* për Komisionin.

⁶⁹ Radhitja dhe përmbajtja e raportit të përpunimit të kërkesës përcaktohet në konsultim me Komisionin, shih në vijim parag. 4.4 në kapitullin 4.

Gjatë periudhës së raportimit Sekretaria Ekzekutive përpunoi rreth 4,541 kërkesa për vërtetimin e të drejtave të pronësisë në lidhje me pronat bujqësore, komerciale dhe banesore.⁷⁰

Kryeatri i Komisionit përcakton rendin, sipas të cilit kërkesat referohen për shqyrtim, në konsultim me anëtarët e tjerë të Komisionit dhe duke marrë parasysh informacionet e ofruar nga Sekretaria Ekzekutive mbi lëndët e përpunuara.⁷¹ Kërkesat i prezantohen Komisionit në raportin e përpunimit të kërkesës së bashku me dosjen e kërkesës.

⁷⁰ Deri në datën e publikimit në shkurt të vitit 2008, numri i kërkesave të referuara për Komisionin kishte arritur në 6,956 kërkesa. Sekretaria ekzekutive do të mbërrijë cakun epërpunimit të kërkesave prej 3,000 kërkesash për një seancë të Komisionit deri në seancën e prillit të vitit 2008. Kjo do të shpie numrin e kërkesave të përpunuara dhe të referuara Komisionit mbi cakun prej 11,000 kërkesave deri në seancën e qershorit të vitit 2008 (brenda një viti nga séance e pare e Komisionit)

⁷¹ Shih me tutje nenin 1.9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

KAPITULLI 4

KOMISIONI PËR KËRKESA PRONËSORE I KOSOVES DHE VENDOSJA E KËRKESAVE

4.1 Hyrje

Së bashku me mandatin e saj për të zgjidhur kërkesat pronësore dhe t'u ofrojë drejtësi viktimave, të cilat kanë pësuar shkelje të të drejtave pronësore, procesi i KPA-së ka për detyrë të ofrojë ndihmë juridike efektive të shpejtë mijëra paraqitësve të kërkesave brenda një periudhe të arsyeshme kohore dhe në një mënyrë, e cila është ekonomike dhe e qëndrueshme. Kriteri për ofrimin e ndihmës brenda një periudhe të arsyeshme është me rëndësi, jo vetëm për shkak se është e garantuar sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, por gjithashtu për shkak të rëndësisë së madhe të krizës pronësore në Kosovë, rëndësinë e saj për rritje ekonomike dhe adresim të kushteve sociale dhe ekonomike të refugjatëve dhe personave të zhvendosur, të cilët, që të gjithë, kërkojnë zgjidhje të shpejtë dhe të menjëhershme të kontesteve pronësore.

Këto shqyrtime, padyshim i kanë dhënë formë procesit të KPA/KPCC-së, dhe në veçanti teknikave procedurale dhe dëshmuere që duhet përdorur në zgjidhjen e kërkesave nga ana e Komisionit. Ky proces përbën një sistem ligjor *ad hoc*, apo një regjim të pavarur, ku Komisioni është plotësisht i pajisur me rregullat e veta procedurale për shqyrtimin e kërkesave⁷² dhe pavarësia e vet funksionale është shtuar me faktin se ka autoritetin për të miratuar rregulla shtesë për kryerjen e funksioneve të veta. Rregullat e veta, ato të procedurës dhe evidencës, pasqyrojnë dhe njohin natyrën e saj si një regjim i veçantë (*sui generis*) nga sistemi gjyqësor vendor. Një numër i faktorëve tjerë gjithashtu dallojnë Komisionin nga gjykatat e rregullta. Në sistemin gjyqësor, procedurat ligjore paraqiten në gjykata në baza të vazhdueshme dhe në shumicën e situatave nuk ka lidhje ndërmjet rasteve. Komisionit, nga ana tjetër, i është dhënë kompetenca për të shqyrtuar me mijëra konteste pronësore të pas konfliktit, të cilat janë paraqitur brenda një periudhe shumë të shkurtër kohore dhe të gjitha kërkesat rrjedhin nga e njëjta ngjarje.

Në mënyrë që procesi t'i lejojë KPA/KPCC-së shqyrtimin e lëndëve të shumta, ai ishte hartuar që të jetë një përzierje e një "sistemi përpunues të numrit të madh të kërkesave", përmes të cilit Komisioni ishte i autorizuar sipas ligjit që të miratonte masa të caktuara procedurale për shpejtimin e vendimmarrjes, procedurë kjo e cila në përgjithësi është e njohur si mënyra më efikase për ofrimin e ndihmave individuale juridike për viktimat e konfliktit të armatosur.⁷³ Ata që ndikuan në hartimin e procesit (UNMIK-u, komuniteti

⁷² Sipas të drejtës në ankesë kundër Vendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës, shih nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁷³ Përpunimi i kërkesave të shumta janë paraqitur si një zhvillim duke shkaktuar kthesë rrënjësore në zgjidhjen e kërkesave ndërkombëtarisht në fund të shekullit 20 me themelimin e vet në vitin 1981 në Iran-Gjykata për Kërkesa e Shteteve të Bashkuara – Iran, dhe arriti një ngritje në vitin 1990 me formimin e një numri të madh të mekanizmave të përpunimit të kërkesave ad hoc, shih Përpunimi i numrit të madh të

donator dhe OJQ-të) vlerësuan se, miratimi i procedurave tradicionale gjyqësore që kishin ruajtur dëgjimet gojore mbi baza individuale nuk mund të siguronte vendimmarrje të shpejtë të afro mijëra kërkesave, dhe ai duhej të vlerësohej kundrejt të drejtave të paraqitësve të kërkesave që kërkesa e tyre të dëgjohej brenda një periudhe të arsyeshme kohore.⁷⁴ Më tutje, ishte vlerësuar me vend që përpunimi i duhur nuk mund të aplikohet nëse do të rrezikonte të drejtat e palëve për dëgjim të kërkesave të tyre brenda një periudhe të arsyeshme kohore, pasi që po të bëhej një gjë e tillë atëherë kjo do të thoshte mohim i drejtësisë – ‘drejtësia e vonuar është drejtësia e mohuar’.⁷⁵ Efikasiteti dhe vendimmarrja e shpejtë, ishte gjithashtu prioritet duke ditur që i tërë procesi i KPA-së është 70% i financuar nga kontributet vullnetare të donatorëve.

Prandaj, theksi ishte vënë në hartimin e rregullave të procedurës, që vendosin ekuilibrin ndërmjet sigurimit të përpunimit të duhur, dhe në të njëjtën kohë duke garantuar shpejtësinë dhe efikasitetin. Një numër i dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhërësës Administrative 2007/5 shprehimisht kanë përshkruar aplikimin e teknikave të përpunimit në numrit të madh të kërkesave për të shpejtuar vendimmarrjen, në fazat e para-vendimmarrjes dhe të vendimmarrjes në procedurë; këto janë shqyrtuar më poshtë.⁷⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50, gjithashtu lejon Komisionin të marrë çfarëdolloj masash tjera procedurale, që i konsideron si të duhura për të shpejtuar vendimmarrjen.⁷⁷ Kjo dispozitë është shfrytëzuar nga Komisioni për të dhënë udhëzime të qarta për Sekretarinë Ekzekutive lidhur me përpunimin e kërkesave, dhe kjo kishte rëndësi vendimtare që të sigurohet se do të bëhet një përpunim i tillë i kërkesave, i cili pastaj do të mundësonte që vendimmarrja të shpejtohet.

4.1.1 Udhëzimet e Komisionit mbi përpunimin e kërkesës

Megjithëse Komisioni u themelua në mars të vitit 2006 me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/10, anëtarët e tij u emëruan në maj 2007 dhe rregullat e saja për procedurë dhe evidencë janë shpallur në qershor 2007. Menjëherë pas kësaj, Komisioni mbajti seancën e vet të hapjes nga 4-8 qershor 2007 dhe filloi me shqyrtimin e kërkesave.

kërkesave ndërkombëtare – Perspektivat Praktike dhe Ligjore, të botuara nga Holtzmann, H.M. dhe Kristjansdottir, E., Oxford, University Press, mars 2007.

⁷⁴ Ky është shqyrtimi parësor në rregullimin e përpunimit të numrit të madh të kërkesave dhe sa i përket përgjithësisht përpunimit të numrit të kërkesave shih Heiskanen, V., Komisioni mbi Kompensim i Shteteve të Bashkuara: Rregullat e vjetra, Procedurat e Reja mbi Riparimet e Luftës, 13 gazeta evropiane të Ligjit Ndërkombëtar (2002), faqe 161; Rivendosja e Drejtësisë përmes Përpunimeve të numrit të madh të Kërkesave, Përgjigjet Inovative në Sfidata unike” në Holtzmann, H.M. dhe Kristjansdottir, E., op.cit. shënim 74; Das, H., “Qasjet e reja për të dëshmuar Zgjidhjen e Kërkesave në Përpunimet e Numrit të Kërkesave të shumta Ndërkombëtarisht” letra e paraqitur në Thessalonica, 7 tetor 2005 në faqe.1-2 dhe 5-6 që është në dispozicion në <http://www.law.kuleuven.be/ipr/eng/institute/hdnl.html>; shih HPCC/RES/7/2003 e datës 11 prill 2003 në faqe 1, që është në dispozicion në www.hpdkosovo.org dhe Wühler, N., ‘Gjykatat e Përziera Arbitrare’ në I.R. Bernhardt (ed.) Encyclopedia e Ligjit Publik Ndërkombëtar, f. 143.

⁷⁵ Heiskanen, V., ibid.

⁷⁶ Shih nenin 11.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 8.8 të aneksit III në Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁷⁷ Shih nenin 11.3(d) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Seancat tjera janë mbajtur gjatë tërë periudhës së raportimit në baza dy mujore - në gusht, tetor dhe dhjetor.

Në fillim, Komisioni filloi me vendosjen mbi një numër më të vogël të kërkesave mostër, me qëllim të vlerësimit të llojit të kërkesave, të përcaktimit të udhëzimeve që duheshin zbatuar nga Sekretaria Ekzekutive në përpunimin dhe përgatitjen e parashtrësve ligjore mbi kërkesat, shqyrtimit të verifikimit të nevojshëm dhe procedurave të vendosjes si dhe zhvillimit të kriterëve për grupim të kërkesave dhe për vendimmarrje. Kjo qasje ishte e nevojshme me qëllim të sigurimit që kur kërkesat të përpunoheshin dhe t'i referoheshin Komisionit, ky i fundit do të ishte në gjendje të vendoste një numër të madh të kërkesave në seancat e veta.

Në veçanti, Komisioni i ka kushtuar vëmendje hartimit të raportit përpunues të kërkesës, në bazë të të cilit kërkohej që Sekretaria Ekzekutive të përpunoj dhe paraqes kërkesat. Komisioni kërkonte që raporti i përpunimit të kërkesës të përmbajë të gjitha informacionet kryesore që i duheshin për të marrë vendim mbi kërkesën. Në këtë aspekt, Komisioni udhëzoi Sekretarinë Ekzekutive në hartimin elektronik të raporteve përpunuese të kërkesës për çdo kategori kërkesash si në vijim:

- (i) Pronë Bujqësore;
- (ii) Pronë Komerciale;
- (iii) Pronë Komerciale e shkatërruar;
- (iv) Pronë Banesore; dhe
- (v) Pronë Banesore e shkatërruar.

Kah fundi i periudhës së hartimit të raportit, u formuluan gjithashtu draft-raportet e përpunimit të kërkesës për kërkesa të refuzuara dhe të kontestuar.

Raporti i përpunimit të kërkesës përfshin detajet mbi palët në kërkesë, vendin dhe përshkrimin e pronës së kërkuar, detajet lidhur me notifikimin e pronës dhe përgjigjen në notifikim. Ai përshkruan dokumentet e paraqitura ligjore nga palët, natyrën e verifikimit të kryer dhe nëse është paraqitur më shumë se një kërkesë lidhur me pronën. Raporti përfundon më një analizë ligjore mbi kërkesën dhe rekomandimin për Komisionin nëse kërkesa duhej aprovuar apo refuzuar. Në rastet ku ndërtesat apo strukturat mbi pronën janë të shkatërruara, raportet duhet të përmendin këtë fakt dhe të përmbajnë një përshkrim të shkurtër të gjendjes aktuale të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës posedon të dyja, ndërtesën/ndërtesat e shkatërruara dhe tokën nën të, dhe nëse aktualisht është e uzurpuar apo shfrytëzohet për ndonjë qëllim. Në rastet ku kërkohet kompensimi, përpos konfirmimit të të drejtave pronësore, kjo gjithashtu duhet të ceket në raportin e përpunimit të kërkesës së bashku me rekomandimin për refuzim të këtij aspekti të kërkesës.⁷⁸

Kjo qasje e shpejton vendimmarrjen meqenëse të gjitha informacionet në dosjen e kërkesës, të rëndësishme për vendosje mbi kërkesë, prezantohen në raport duke mundësuar në këtë mënyrë marrjen e vendimit pa pasur nevojë për shqyrtim të dosjes së

⁷⁸ Shih më tutje, paragrafin 4.3 të këtij kapitulli.

kërkesës, përpos në rastet kontestuese dhe në rastet e tjera që paraqesin skenar të pazakonshëm, si dhe për qëllim të kontrollimit të përpunimit të kërkesave sipas mostrave.

Megjithatë, duhet vënë re që Komisioni në asnjë mënyrë nuk është i detyruar nga rekomandimet në raport të përpunimit të kërkesës. Komisioni bën rishikimin e pavarur të fakteve të rastit, dëshmive të prezantuara dhe të bazës ligjore për kërkesën përmes një, apo më shumë anëtarëve të vet. Ai merr vendim përfundimtar për çdo kërkesë pas shqyrtimit të rekomandimeve në raport dhe në bazë të vlerësimit të vet të pavarur të të gjitha çështjeve. Në rastet ku raporti i përpunimit të kërkesës nuk i regjistron në mënyrë të plotë të gjitha faktet esenciale të nevojshme për të marrë vendim në kërkesë, Komisioni e shikon dosjen e kërkesës dhe atëherë kur, pas analizës së dosjes së kërkesës, është konstatue se kërkesa nuk është përpunuar në pajtueshmëri me procedurën ligjore, apo Komisionit i nevojiten informacione shtesë për të vendosur mbi çështjet e ngritura, kërkesa i kthehet prapa Sekretarisë Ekzekutive për hetime shtesë dhe veprime pasuese. Kjo zakonisht përfshinë verifikime shtesë apo kërkime të dokumenteve apo intervistimin e palëve në kërkesë. Kështu, një pjesë e rëndësishme e qasjes për vendosje mbi kërkesat përfshinë kontrollin e kualitetit dhe shqyrtimin e kujdesshëm të kërkesave.

Një aspekt tjetër i procesit të para-vendimmarrjes, i cili ishte shumë i rëndësishëm në vendimmarrje të shpejtë, është mënyra në të cilën kërkesat i janë referuar Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive. Me qëllim të sigurimit që kërkesat, të cilat bien në kategoritë e njëjta apo të cilat ngrisin çështje të përbashkëta ligjore apo çështje dëshmuese, t'i referohen Komisionit së bashku, Komisioni udhëzoi Sekretarinë Ekzekutive të bëjë grupimin e kërkesave për referim për çdo seancë. Pas fitimit të përshtypjes së përgjithshme të skenarëve të ndryshëm të paraqitura në kërkesa në seancat e mëhershme, Komisioni kërkoi që kërkesat të grupohen së bashku në grupet si në vijim:⁷⁹

- Kërkesat, në të cilat paraqitësi i kërkesës ishte bartës i të drejtës pronësore në datën e humbjes dhe ende është bartës i të drejtës pronësore;
- Kërkesat e paraqitura nga Anëtari i Bashkësisë Familjare apo Bartësi i Autorizuar;
- Kërkesat, në të cilat bartësi i të drejtës pronësore në datën e humbjes është tjetër nga paraqitësi i kërkesës dhe ku paraqitësi i kërkesës është pronar aktual;
- Kërkesat ku bartësi i të drejtës pronësore është i ndjerë dhe paraqitësi i kërkesës nuk është pronar aktual i pronës;
- Kërkesat pronësore komerciale – të vëna në pako varësisht nëse prona e kërkuar është e shkatërruar dhe nëse paraqitësi i kërkesës posedon lokalin dhe tokën nën të;
- Kërkesat pronësore banesore – të vëna në pako varësisht nëse prona e kërkuar është e shkatërruar dhe nëse paraqitësi i kërkesës posedon pronën dhe gjithashtu tokën nën të.

⁷⁹ Shih nenin 11.3(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe shih nenin 5.5 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

Komisioni gjithashtu përshkruan udhëzimet në shfrytëzimin e procedurave të tjera gjatë shkallëve të para-vendimmarrjes me qëllim të shpejtimit të marrjes së vendimit si në vijim:

- Kërkesat e paraqitura nga një dhe paraqitësi i njëjtë i kërkesës për pronën e njëjtë apo një pronë përkatëse u kërkuar të bashkoheshin apo të konsolidohen dhe të përpunohen së bashku nga Sekretaria Ekzekutive;⁸⁰ dhe
- Rishikimi i kërkesave të caktuara dhe funksionet e rishikimit dëshmuar i janë dërguar sekretareshës ligjore që i shërben Komisionit, nën mbikëqyrjen dhe aprovimin përfundimtar të Komisionit.⁸¹

4.2 Vendimmarrja

Procedurat që zbatohen në vendosjen e kërkesave para Komisionit gjithashtu lehtësojnë vendimmarrjen e shpejtë përmes së cilës procedura me shkrim kërkohet në nivelin e vendimmarrjes në rastet ku është e mundshme.⁸² Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresa Administrative 2007/5 parashohin që procedura para Komisionit zakonisht të jetë e bazuar në parashtresat me shkrim dhe vendimet të merren në bazë të parashtresave dhe dëshmimeve dokumentuese.⁸³ Palët mund të japin dëshmi gojore nëse Komisioni kërkon nga ata të bëjnë këtë⁸⁴, dhe poashtu në rastet ku Komisioni përcakton që një gjë të tillë është në interes të drejtësisë.⁸⁵ Gjithashtu, dëgjimet gojore mund të mbahen me të gjitha palët, përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët.⁸⁶

Gjatë periudhës raportuese, të gjitha kërkesat janë vendosur në bazë të parashtresave me shkrim dhe dëshmime të dokumentuara, të cilat kanë qenë juridikisht të pakontestuar dhe janë verifikuar pozitivisht nga zyrtaret e Sekretarisë Ekzekutive. Asnjë dëgjim gojor nuk është parë i nevojshëm dhe duke pasur parasysh natyrën e dëshmimeve të dokumentuara që nevojiteshin të dëshmojnë të drejtën pronësore,⁸⁷ është parashikuar që shumica e kërkesave mund të vendosen në bazë të dëshmimeve të dokumentuara dhe parashtresave me shkrim. Në rastet e kontestuar apo në rastet ku dokumentet janë humbur apo në rastet ku

⁸⁰ Shih 11.3(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁸¹ Shih 11.3(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁸² Duhet të kihet parasysh që procedura kërkon një qasje njohëse në nivelin e përpunimit të kërkesës si mbledhja e dëshmisë dhe roli i konstatimit të fakteve përkrahet nga Sekretaria Ekzekutive, në të cilën në këtë mënyrë merr barrën që zakonisht binte mbi palët për të përcaktuar faktet dhe të dëshmojnë rastin e tyre, shih kapitujt 2 dhe 3 të këtij Raporti i cili shqyrton regjistrimin e kërkesave dhe verifikimin e dëshmisë.

⁸³ Shih nenin 11.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 5.1 të aneksit III në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁸⁴ Shih nenin 5.2 të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁸⁵ Shih nenin 11.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 5.2 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁸⁶ Shih 11.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

⁸⁷ Të tilla sikurse fletët e posedimit, kontratat e shitblerjes, kontratat mbi dhurimin, kontratat mbi ndarjen e pronës, vendimet mbi trashëgiminë, vendimet gjyqësore që njohin pronësinë dhe certifikatat e të drejtave pronësore të paluajtshme.

ka pretendime të falsifikimit, dëgjimet gojore do të jenë shumë të nevojshme për të qartësuar faktet e caktuara apo çështjet dëshmuuese që nuk mund të shqyrtohen ndryshe. Komisioni, gjithashtu mund të shfrytëzojë kompetencat dhe të sigurojë mendime të ekspertëve në të gjitha rastet në të cilat është e nevojshme për të vërtetuar vërtetësinë e nënshkrimit në dokument, ose *suo motu*, ose ku pretendimet e falsifikimit të kërkesës që mbështesin dokumentacionin janë ngritur nga pala në procedurë.⁸⁸

4.3 Shënimet Statistike për kërkesat e vendosura

Pasi që udhëzimet e Komisionit për hetimin dhe përpunimin e kërkesave në fillim ishte një detyrë, në të cilën punohej vazhdimisht, seancat e mbajtura në qershor dhe gusht kanë hasur në një numër të madh të kërkesave të cilat janë kthyer për hetim shtesë dhe ripërpunim në pajtueshmëri me udhëzimet e përpunimit, derisa seancat e mëvonshme kanë dëshmuar një efikasitet të shtuar.⁸⁹ Kërkesat, të cilat janë kthyer është dashtë të ripërpunohen në pajtueshmëri me udhëzimet relevante të përpunimit të lëshuara nga Komisioni dhe të paraqiten përsëri të kompletuara në raportet e përpunimit të kërkesës, raporte këto që në këtë fazë, tashmë ishin përfunduar nga Komisioni. Tabela më poshtë ilustron këtë qasje, ku gjatë seancës së qershorit dhe gushtit, për shkak të nevojës për të lëshuar udhëzimet për hetim dhe përpunim të kërkesave, dhe për të finalizuar modelet për raportet e përpunimit të kërkesës, një numër i madh i kërkesave i është kthyer Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni. Në momentin që kjo punë themelore është përfunduar, numri i kërkesave të kthyera është zvogëluar në masë të konsiderueshme, me vetëm 2.9% në seancën e tetorit dhe 1.6% në seancën e dhjetorit, në krahasim me 47% dhe 58% në dy seancat e para.⁹⁰ Tabela më poshtë ilustron shifrat e kërkesave të referuara në çdo seancë të Komisionit dhe numrin e vendosur apo të kthyer gjatë asaj seance.

2007	Seanca e KPCC	Nr.i kërkesave të referuara Komisionit	Kërkesat e vendosura	Kërkesat e kthyer në Sekretari	
				Numrat	% e referuar
Qershor	Seanca e 1	955	498	457	48
Gusht	Seanca e 2	1,179	487	692	59
Tetor	Seanca e 3	544	528	16	2.9
Dhjetor	Seanca e 4	1,863	1,833	30	1.6
Totali			3,346		

Me përfundimin e raportit të përpunimit të kërkesës dhe lëshimin e udhëzimeve të hollësishme përpunuese të detajuara gjatë dy seancave të para të Komisionit, numri i kërkesave të përpunuara nga Sekretaria Ekzekutive është rritur dukshëm. Kjo në anën tjetër i lejon Komisionit të përshpejtojë marrjen e vendimit dhe numri i kërkesave të vendosura gjithashtu ishte rritur dukshëm siç tregon qartazi tabela më lart. Deri në fund të periudhës së raportimit Sekretaria Ekzekutive ishte në gjendje të përpunojë pothuajse

⁸⁸ Shih nenin 5.3 të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁸⁹ Disa prej çështjeve për të adresuar përfshijnë, datën e vdekjes së bartësit të së drejtës së pronës me qëllim të sigurimit nëse ai/a jo ka vdekur më herët apo pas konfliktit, data e humbjes së posedimit të pronës dhe sigurimi i certifikatës së vdekjes apo vendimit mbi trashëgiminë.

⁹⁰ Në seancën e shkurtit 2008, vetëm 0.4% e kërkesave janë kthyer në Sekretarinë Ekzekutive.

1,000 kërkesa më tepër sesa në seancën e qershorit. Më tutje, Komisioni ka vendosur 1,335 kërkesa më shumë në seancën e dhjetorit sesa në atë të qershorit.⁹¹ Me këtë produktivitet të shtuar, procesi është në rrugë të mirë në përpunimin dhe vendosjen e cakut fillestar prej 11,000 kërkesave deri në qershor të vitit 2008 (brenda një viti të inaugurimit të Komisionit).⁹²

Gjatë periudhës së raportimit Komisioni ka vendosur rreth 3,346 kërkesa për konfirmim të së drejtës së pronësisë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë tokën bujqësore, komerciale dhe pronën banesore. Të gjitha kërkesat ishin të pakontestuar në kuptimin që, pas notifikimit të pronës dhe publikimit, asnjë uzurpues/palë përgjegjëse nuk i ishte drejtuar zyrës së KPA-së dhe, edhe në rastet kur uzurpuesi i është drejtuar zyrtarëve të KPA-së, nuk është paraqitur asnjë kontest ligjor lidhur me kërkesën.

Tabela më poshtë paraqet numrin e përgjithshëm të kërkesave të vendosura sipas kategorive:

Kategoria e Kërkesave	Numri i vendosur
Tokë Bujqësore	3,326
Pronë Komerciale	3
Pronë Banesore	17 ⁹³
Totali	3,346⁹⁴

Statistikat mbi vendosjen deri në fund të periudhës së raportimit, pas më pak se dy vjet funksionimi (rreth 21 muaj), janë të vlefshme nëse krahasohen me procesin e mëhershëm të HPD/HPCC-së që ka marrë gati katër vjet, nga vjeshta e vitit 1999 deri në gusht 2003 (44 muaj), për të vendosur për numër të njëjtë të kërkesave. Në krahasim me mekanizmat e kërkesave të tjera relevante, procesi i KPA-së është i suksesshëm lidhur me efikasitetin organizativ dhe shpejtësinë e implementimit të mandatit të saj.⁹⁵

⁹¹ Në seancën e shkurtit të vitit 2008, Komisioni ka vendosur rreth 2,403 kërkesa, ku janë 570 kërkesa më shumë se në seancën e dhjetorit, duke sjellë numrin e përgjithshëm të kërkesave të vendosura deri në 5,749 kërkesa.

⁹² Sekretaria Ekzekutive do të arrijë synimin e saj të paraqitjes së 3,000 kërkesave për seancë para Komisionit në seancë të prillit të vitit 2008.

⁹³ Rreth njëmbëdhjetë (11) prej këtyre pronave janë të shkatërruara.

⁹⁴ Ju lutem, jini në dijeni që sipas datës së publikimit të këtij raporti në shkurt Komisioni ka vendosur një numër të përgjithshëm të kërkesave prej 5,749; tokë bujqësore 5,677; pronë komerciale 9 dhe pronë banesore 63.

⁹⁵ Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore ("HPCC") në Kosovë ka zgjidhur 29,160 kërkesa për 7 vjet. Shënim gjithashtu i Komisionit për Kompensim i Kombeve të Bashkuara ("UNCC") dhe shënim i Komisionit për Kërkesa të Pasurisë së Paluajtshme ("CRPC") në Bosnje, që kishte përgjegjësi të njëjta lidhur me mbledhjen e kërkesave, verifikimin e dokumenteve, hetimin e kërkesave dhe mbledhjen e dëshmisë shtesë.

4.4 Natyra e vendimeve të Komisionit

Komisioni mund të aprovojë, apo të refuzojë kërkesën apo të marrë ndonjë vendim apo urdhër të nevojshëm sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, përfshirë urdhrat për rikthim të të drejtave pronësore dhe riposelimin e pronës.⁹⁶ Ai është i detyruar sipas parimeve të përcaktuara në vendimet e veta, përpos nëse ekzistojnë arsye imponuese për devijim nga këto parime⁹⁷ dhe ai mund të japë vetëm ndihmat ligjore të parapara në Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50.⁹⁸ Komisioni nuk mund të heq shpenzimet që rrjedhin nga procedurat në favor të apo kundër ndonjë pale në procedurë.⁹⁹

Komisioni, gjatë konfirmimit të të drejtave pronësore, mbështetet në dokumentet të cilat janë verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive, në të dhënat pronësore publike, sikurse ato që gjenden në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) apo në gjykata. Në raste të tilla vendimi i Komisionit është në pajtueshmëri me të dhënat mbi titullarin në të dhënat pronësore publike, në veçanti kur bëhet fjalë për fletat e posedimit që mbahen në AKK. Në një numër të rasteve gjeri tani, Komisioni ka konfirmuar të drejtat pronësore, të cilat nuk janë regjistruar në të dhënat e AKK-së për shkak të faktit që të dhënat nuk janë përditësuar. Kjo ka ndodhur në rastet kur ka pasur shitblerje të pronës, kur vendimi i gjykatës ka ndikuar në të drejtën pronësore, apo në vendimin mbi trashëgiminë që nuk është regjistruar. Në raste të tilla, vendimi i Komisionit ka konfirmuar të drejtën mbi pronë dhe bartësi i të drejtës pronësore më pas mund t'i drejtohet AKK-së me qëllim të përditësimit të të dhënave pronësore që do të reflektonte vendimin.

Duke njohur faktin se vetëm vendimi, i cili konfirmon të drejtat pronësore, nuk do të ishte i mjaftueshëm të rikthejë posedimin e pronës paraqitësve të kërkesave ku prona është e uzurpuar ilegalisht, Komisioni gjatë konfirmimit së të drejtave pronësore, ka të drejtë gjithashtu të lëshojë urdhra për riposelimin të pronës. Më pas, mundet gjithashtu të japë urdhra nëse shihet e nevojshme për t'i mundësuar bartësit të së drejtës pronësore të ushtrojë të drejtën e tij/saj pronësore, siç është urdhër-dëbimi kundër uzurpuesve aktual. Sekretaria Ekzekutive është e autorizuar të zbatojë urdhrat e tillë dhe në këtë mënyrë procesi në mënyrë eksplicite është i pajisur me kompetencën për të siguruar pajtueshmëri me vendimet detyruese ligjore të Komisionit të lëshuar në favor të bartësve së të drejtave pronësore.

Rëndësia e vendimit që konfirmon të drejtën pronësore dhe urdhëron riposelimin (me dëbim) ka rol vendimtar në lejimin e bartësve të shpronësuar të të drejtave pronësore për të rimarrë posedimin e pronave të tyre, bile edhe në rastet e pakontestuar. Aty ku kërkesa është e pakontestuar, kjo nuk do të thotë medoemos që prona nuk është ilegalisht e shfrytëzuar apo e uzurpuar; mbase edhe mund të jetë, por uzurpuesi nuk dëshiron që, për çfarëdo arsye, të marrë pjesë në procedurë. Në mungesë të një urdhëri të tillë, së

⁹⁶ Shih nenin 8.6(e) të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁹⁷ Shih nenin 8.2 të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁹⁸ Shih nenin 8.3 të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

⁹⁹ Shih nenin 8.4 të aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

bashku me autorizimin e KPA-së për zbatimin e urdhërit të tillë, bartësi i të drejtës së pronës nuk do të mund të marrë përsëri posedimin.¹⁰⁰

Poashtu, si rezultat i mosbesimit që momentalisht mbizotëron në Kosovë, shumë pjesëtarë të komuniteteve pakicë nuk kanë besim në institucionet publike. Në këto rrethana, një vendim nga Komisioni, bile edhe në rastet ku prona s'është ilegalisht e uzurpuar, konsiderohet nga bartësit e të drejtave pronësore si sigurim i interesit të tyre në pronë, prandaj në këtë mënyrë trajtohen pasiguritë që ata kanë në lidhje me ndërhyrjet në të dhënat pronësore publike. Më pastaj, duke pasur parasysh pamundësinë e shumë paraqitësve të kërkesave për të pasur qasje në pronat e tyre rreth nëntë vjetëve të kaluara, një vendim që konfirmon të drejtën pronësore ka një funksion të rëndësishëm pasi që sqaron dhe konfirmon gjendjen ligjore ekzistuese, në veçanti në rastet kur paraqitësit e kërkesave mund të kenë humbur dokumentet e tyre pronësore, apo ku ato janë shkatërruar në rrethanat të ndërlidhura me konfliktin.

Në rastet ku ka bashkëpronarë, vendimi i Komisionit konfirmon të drejtën pronësore në favor të bartësit të së drejtës pronësore lidhur me pjesën specifike mbi të cilën ai/ajo gëzojnë të drejtën pronësore (p.sh. ½, ¼, etj.) siç është përcaktuar në dokumentet pronësore relevante (p.sh. Fleta e Posedimit, Vendimi mbi Trashëgiminë, Vendimet e Gjykatës etj.). Në të gjitha rastet, vendimi i Komisionit shprehimisht konfirmon që në rastet, në të cilat ka më shumë se një pronar, urdhëri nuk i dëmton të drejtat e bashkëpronarëve.

Gjatë vendosjes mbi kërkesat të paraqitura nga anëtarët e familjes të bartësve të së drejtës pronësore, Komisioni vendos kërkesën në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe urdhëri për riposedim jepet në favor të paraqitësit të kërkesës.¹⁰¹

Komisioni, ka ardhë në përfundim se ai gjatë marrjes së vendimit, nuk ka jurisdiksion për të dhënë kompensim monetar.¹⁰² Në rastet, ku paraqitësit e kërkesave, përpos kërimit të konfirmimit të së drejtës pronësore, gjithashtu kërkojnë kompensim për dëme fizike, apo për shfrytëzim të paautorizuar të pronës së kërkuar, Komisioni e refuzon kërkesën sa i përket kompensimit me qëndrimin se ai nuk ka jurisdiksion të aprovojë një ndihmë të tillë juridike.¹⁰³

4.5 Forma e vendimeve

Lidhur me nxjerrjen e vendimeve, rregullat e procedurës të Komisionit gjithashtu autorizojnë shfrytëzimin e teknikave për përpunim të numrit të madh kërkesave, me anë

¹⁰⁰ Ai/ajo do të duhet të themelonin procedura ligjore në gjykata komunale që janë veçse serioze sipas burimeve me pritje të gjata në vendosjen e procedurave për shkak të punës së pabërë të rasteve.

¹⁰¹ Shih nenin 8.5 i aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2006/50.

¹⁰² Shih KPCC/D/1/2007 të lëshuar në qershor 2007, që është në dispozicion në www.kpaonline.org.

¹⁰³ Deri më tani, prej 3,346 kërkesave të vendosura, rreth 960 paraqitës të kërkesave kanë kërkuar kompensim për dëmin fizik në, apo për shfrytëzim të paautorizuar të pronës së kërkuar, apo dëm apo shkatërrim të pronës së tyre.

të të cilave lejohet nxjerrja e vendimit lidhur me pakot e kërkesave që ngritin çështje të ngjashme ligjore dhe dëshmuere, të njohura si “Vendim grupor”.¹⁰⁴

Kryetari duke nënshkruar vendimin grupor i aprovon të gjitha vendimet individuale të identifikuar dhe të cekura në vendimin grupor sipas numrit të kërkesës. Gjatë periudhës së raportimit, janë lëshuar shtatë (7) vendime grupore nga Komisioni, duke përfshirë 3, 346 kërkesa.¹⁰⁵

Deri më tani, sa i përket marrjes së vendimit, Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2007/5 parasheh që vendimet të merren njëzëri por nëse nuk mund të arrihet konsensusi, kërkesa mund të vendoset me shumicë votash.¹⁰⁶

Të gjitha vendimet grupore janë të arsyetuara me shkrim duke i cekur faktet materiale dhe të drejtat pronësore të konstatuara nga Komisioni. Ato janë të nënshkruara nga Kryetari i Komisionit dhe përmbajnë hollësitë themelore si në vijim:

- (i) data e aprovimit;
- (ii) emrat e palëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- (iii) arsyet për vendim (përfshirë faktet materiale dhe të drejtat pronësore që konstatohet se ekzistojnë); dhe
- (iv) citojnë Urdhrat e Komisionit.¹⁰⁷

Në rastet ku kërkesa vendoset me vendim grupor, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për palët, një vendim individual përgatitet nga Sekretaria Ekzekutive lidhur me çdo kërkesë ku paraqiten detajet pronësore individuale të paraqitësit të kërkesës dhe ndihma e aprovuar nga Komisioni. Ai i referohet vendimit grupor të Komisionit dhe paragrafit të veçantë që i paraqet arsyet për vendim lidhur me kërkesën.

Asnjë nga vendimet nuk i është dorëzuar paraqitësve të kërkesave gjatë periudhës së raportimit për shkak të mungesës së fondeve.¹⁰⁸

¹⁰⁴ Shih nenin 8.8 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

¹⁰⁵ Vendimi Grupor nr. 1 në qershor 2007 ka vendosur 498 kërkesa pronësore bujqësore. Vendimi grupor i gushtit nr. 2 ka përfshirë 487 kërkesa të pronës bujqësore. Në tetor, dy vendime grupore janë lëshuar, nr. 3 vendimet grupore 525 kërkesa të pronës bujqësore dhe nr. 4 kanë përfshirë tri prona komerciale. Në dhjetor, tri vendime grupore janë lëshuar; nr. 5 kanë përfshirë 1,816 kërkesa të pronës bujqësore, nr. 6 kanë përfshirë 6 kërkesa të pronave banesore dhe nr. 7 ka përfshirë njëmbëdhjetë kërkesa pronësore banesore të shkatërruara. Sa i përket statistikave në kërkesat e vendosura, shih më tutje paragrafin 4.1 të këtij kapitulli dhe tabelat në paragrafin 4.4. E ke parasysh që në datën e publikimit, Komisioni ka lëshuar 12 Vendime Grupore me numër të përgjithshëm prej 5,749 pronave të kërkuara.

¹⁰⁶ Shih nenin 7.3 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5. Në katër (4) vendimet, një anëtar i Komisionit nuk është pajtuar duke pas parasysh që Komisioni duhet të kufizoj vendimet e tija për të marr urdhra të dëbimeve dhe jo të konfirmoj pronësinë, shih KPCC/D/1/2007; KPCC/D/3/2007 dhe KPCC/D/4/2007; KPCC/D/5/2007. Në KPCC/D/5/2007 një Anëtar nuk është pajtuar, ka mbajtur qëndrimin që gjykata e cila ka lëshuar vendimin mbi trashëgiminë në të cilën paraqitësi i kërkesës është mbështetur në përkrahje të kërkesës, nuk ishte gjykata kompetente për të lëshuar vendimin, derisa dy anëtarët e tjerë kanë marrë një pikëpamje tjetër alternative. Të gjitha vendimet e Komisionit janë në dispozicion në www.kpaonline.org

¹⁰⁷ Shih nenin 8.7 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

Derisa vendimet e Komisionit janë të detyrueshme me ligj, ekziston e drejta në ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.¹⁰⁹ Megjithatë, UNMIK-u deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për t'u përgatitur për regjistrimin dhe vendosjen mbi ankesat. Nuk është bërë asnjë regjistër dhe nuk janë ndarë mjete.¹¹⁰ Duhet të kihet parasysh që një procedurë e shpejtë e zgjidhjes së kërkesave në nivelin e shkallës së parë duhet të ndiqet në nivelin e ankesës në mënyrë që të mundësohet që procesi i KPA-së të zbatojë vendimet përfundimtare dhe të përfundojë implementimin e mandatit të saj me kohë.

¹⁰⁸ Shih më tutje, kapitullin 8 të Këtij Raporti..

¹⁰⁹ Shih nenet 11.8 dhe 12 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹¹⁰ Shih nenet 14 dhe 15 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

KAPITULLI 5

ZBATIMI

5.1 Hyrje

Sekretaria Ekzekutive ka mandat që në tërësi të zbatojë vendimet e Komisionit, përfshirë zbatimin e urdhrave të dëbimit kundër uzurpuesve të kundërligjshëm. Zbatimi efikas i vendimeve përfundimtare mbi kërkesat gjithashtu mund të arrihet përmes mjeteve ligjore siç është vënia e pronës nën administrimin e KPA-së, konfiskimi i strukturave të paligjshme, ankandet, kompensimi dhe marrëveshjet mbi qiranë.¹¹¹

Për shkak të mungesës kronike të fondeve gjatë tërë periudhës së raportimit, aktivitetet zbatuese gjatë vitit 2007 janë kufizuar vetëm me zbatimin e përgjegjësive të pazbatuara të procesit të HPD/HPCC-së, menaxhimin e portofolit të pronave nën administrim të HPD-së dhe me skemën e qirasë.¹¹² Fatkeqësisht, nuk ka mundur të zbatojë asnjë nga 3,346 vendimet e lëshuara nga Komisioni lidhur me kërkesat pronësore bujqësore, komerciale dhe banesore meqenëse fondet e zvogëluara duhej të drejtoheshin gjetiu (në aktivitetet e përpunimit të lëndëve dhe në aktivitetet e pranimi të kërkesave para datës së mbylljes më 3 dhjetor 2007).¹¹³

5.2 Zbatimi i vendimeve të HPCC-së

5.2.1 Ekzekutimi i vendimeve të pazbatuara të HPCC-së

Në fillim të periudhës së raportimit ka pasur rreth 721 vendime të HPCC-së në pritje të zbatimit në bazë të kërkesave sipas paraqitësve të kërkesave për riposëdime të pronës së tyre, prej të cilave vetëm dymbëdhjetë (12) kanë qenë ende në pritje në fund të periudhës së raportimit.¹¹⁴ Asnjë pengesë e pakapërcyeshme nuk është paraqitur lidhur me zbatimin e këtyre vendimeve dhe puna ka vazhduar në mënyrë normale deri në gusht kur KPA-ja hasi në një sfidë, e cila ishte e pa precedent në gjashtë vjetët e kaluara të operacioneve të HPD/HPCC-së.

Me 2 gusht, aktivitetet zbatuese të KPA-së janë suspenduar përkohësisht me një Vendim Ekzekutiv, i cili ishte lëshuar nga PSSP-ja, për shkak të mungesës së unitetit dhe

¹¹¹ Shih Kapitullin V, nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹¹² Lidhur me procesin e HPD/HPCC-së, KPA kur është themeluar në mars 2006 kishte mandat të zbatojë kërkesat pronësore banesore në pritje dhe të menaxhojë dosjet pronësore administrative të HPD-së përveç zgjidhjes së kontesteve pronësore të paluajtshme, e shqyrtuar në paragrafin 1.1 të kapitullit 1 të këtij Raporti.

¹¹³ Shih më tutje, kapitullin 8 të këtij Raporti..

¹¹⁴ Në datën e publikimit të këtij raporti në shkurt 2008, vetëm njëmbëdhjetë vendime mbeshin në pritje.

përkrahjes së Qeverisë së Kosovës për procesin të KPA-së. Vendimi Ekzekutiv nr. 2007/41 parashihte si në vijim:

“Aplikimi i Nenit 17 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale përkohësisht pezullohet dhe, në përputhje me këtë, të gjitha veprimet për implementim të vendimeve të Komisionit të Kërkesave Pronësore dhe Banesore (HPCC) pezullohen derisa qëllimi i përbashkët i domosdoshëm dhe angazhimi i të gjitha grupeve të interesuara të përfshira në proces të ri-vendoset”.

Ky suspendim u anulua vetëm pas një takimi të jashtëzakonshëm të Bordit Mbikëqyrës, që ishte mbledhur më 8 gusht duke i sjellë të gjitha palët e interesuara së bashku në një takim. Në këtë takim u bënë përpjekje të përbashkëta për të ri-fituar mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e urdhrave të dëbimit kundër banuesve ilegalë. Ishte cekur se si kusht i domosdoshëm për zbatimin e sundimit të ligjit dhe respektim të drejtave pronësore është ofrimi i mbështetjes publike për procesin nga liderët dhe autoritetet vendore. Rëndësia e procesit ishte shqyrtuar gjithashtu nga perspektiva e kontributit të tij në ndërtimin e paqes, rilindjes ekonomike, kthimit të qëndrueshëm të popullatës së zhvendosur dhe prosperitetin për të gjithë njerëzit e Kosovës. Takimi ishte i suksesshëm në kuptimin se u tregua mbështetja e Qeverisë Kosovare për procesin dhe si rezultat i kësaj brenda një jave nga PSSP-ja u nxorr vendimi ekzekutiv, i cili anuloi suspendimin e përkohshëm të aktiviteteve të zbatimit.¹¹⁵

Përderisa gjatë viteve të funksionimit të HPD-së zbatimi i urdhër-dëbimeve të HPCC-së ishte shtyrë shumë rrallë, në momentin që parashihej dëbimi, ligji i aplikueshëm lejonte shtyerjen në raste të kufizuara, ku urgjenca e situatës dhe rrethanat e veçanta të rastit kërkonin një gjë të tillë.¹¹⁶ Megjithatë, kjo kompetencë për shtyerjen e ekzekutimit të urdhrave për dëbim ishte, dhe edhe sot, përdoret shumë rrallë meqenëse është në konflikt më të drejtat e bartësve të ligjshëm të së drejtës pronësore për riposedim dhe ushtrim të së drejtave pronësore. Në praktikë, vonesa lejohet në mënyrë shumë të kufizuar në rastet ku kërkesa e vet uzurpuesit është ende në pritje të zbatimit. Në raste të tilla dëbimi mund të ndalohet varësisht nga mundësia e sigurimit të strehimit alternativ dhe zgjidhjes së nevojave për strehim të uzurpuesit, pa paragjykuar rezultatin e kërkesës.¹¹⁷

Në shumicën e rasteve të tilla KPA-ja ishte në gjendje të sigurojë strehim alternativ për banuesit, përpos në qytetin e Mitrovicës ku një numër i madh i personave të zhvendosur kanë uzurpuar pronat në pjesën veriore të qytetit të ndarë etnikisht dhe kishte pak alternativë të mundshme për të strehuar ata.

¹¹⁵ Vendimi Ekzekutiv 2007/43 I lëshuar më 8 gusht 2007.

¹¹⁶ Shih nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

¹¹⁷ Në bazë të nenin 13.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, kishte një obligim për të informuar uzurpuesin aktual dhe paraqitësin e kërkesës për arsyen e vonesës.

Në fund të periudhës së raportimit kishte njëmbëdhjetë (11) raste në pritje të implementimit në Mitrovicë dhe këto raste paraqesin shqetësime meqenëse autoritetet përgjegjëse me personel ndërkombëtarë në pjesën veriore të qytetit kanë refuzuar të përfshihen në kërkimin për të siguruar strehim alternativ dhe për të lejuar riposedimin e pronave të uzurpuara në mënyrë jo ligjore në favor të bartësve të së drejtave pronësore. Më pastaj, KPA-ja nuk ka marrë ndihmën e nevojshme nga Policia e UNMIK-ut për të vazhduar me dëbimin e uzurpuesve ilegalë në këtë zonë. Si rrjedhojë e kësaj, KPA-ja nuk kishte mundësi të përfundojë zbatimin e mandatit të HPD-së sikurse ishte planifikuar fillimisht.

5.2.2 Zbatimi i Skemës për Kompensim

Procesi i HPD/HPCC-së është dashtë të sigurojë kthimin e pronave për paraqitësit e kërkesave të cilëve u janë shkel të drejtat pronësore si pasojë e diskriminimi dhe konfliktit i armatosur në Kosovë gjatë periudhës 1989-1999. Paraqitësit e kërkesave të kategorisë A, të drejtat e banimit të të cilëve janë anuluar ndërmjet 23 marsit 1989 dhe 24 marsit 1999 si rezultat i diskriminimit, kanë pasur të drejtë në kthimin në lloj, përpos nëse pronësia e pronës është fituar nga personi fizik përmes shitblerjes vullnetare të vlefshme për vlerën para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores, në të cilin rast mjet i duhur ishte kompensimi. Paraqitësit e kërkesave të kategorisë C, të cilët kanë humbur posedimin e pronave të tyre për shkak të rrethanave të fushatës ajrore të NATO-s, kanë pasur të drejtë në urdhër për riposedim, pa marrë parasysh natyrën e të drejtave të tyre pronësore, me kusht që posedimi i tyre pronësor nuk ka qenë qartësisht i paligjshëm.

Në rastet ku kishte kërkesa valide konkurruese të parashtruara për pronën e njëjtë, përfshirë kërkesën e kategorisë A për humbje të së drejtës banesore para vitit 1989 dhe kërkesa e kategorisë C për humbje të posedimit pas marsit 1999, Rregullorja, duke u munduar të përlligj të drejtat pronësore të të dy palëve, ka përshkruar që paraqitësit të kërkesës së kategorisë A t'i jepej kthimi në lloj dhe paraqitësit të kërkesës së kategorisë C t'i jepet kompensim.

Sipas nenit 4.4 dhe 4.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60, HPD kishte mandat të gjejë formulën për përcaktimin e shumave për kompensim për t'u paguar paraqitësve të kërkesave të kategorisë C, si dhe të formulojë metodën për pagesën e një kompensimi të tillë.¹¹⁸ Kërkohej gjithashtu të themelojë dhe administrojë një Fond Mirëbesimi për të bërë implementimin e skemës për kthim.

HPD-ja, dhe së fundi KPA-ja, vëmendje të posaçme i ka dhënë vendosjes së ligjit dhe procedurave për implementimin e skemës mbi kompensim. Fillimisht, HPD ka hartuar ligjin e nevojshëm për të zbatuar skemën dhe aprovimi për implementimin e tij erdhi me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, proces i cili ishte kërkuar të kryhej nën patronatin e KPA-së. Neni 19 i Rregullores parashihte që skema të zbatohet “*në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për llogaritjen e*

¹¹⁸ HPD ka hartuar ligjin relevant në gusht 2005 me qëllim të zbatimit të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

shumave nga neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60.” Rreth 258 kërkesa janë në pritje për zbatim sipas nenit 4, nga të cilat 142 janë kërkesa të kategorisë C, të cilat kërkojnë që kompensimi t’u paguhet paraqitësve të kërkesave për humbje të së drejtës pronësore.

Sekretaria Ekzekutive gjatë tërë periudhës së raportimit ka punuar në zbatimin e skemës së kompensimit, por për shkak të vështirësisë në gjetjen e burimit të të hollave për të financuar kompensimin, është bërë pak progres në zbatimin e skemës. Propozimi se si duhet të trajtohet çështja e buxhetit ishte paraparë për aprovim të Bordit Mbikëqyrës në fund të vitit 2007, por pasi që ai takim është anuluar¹¹⁹ plani do të paraqitet në fillim të vitit 2008.¹²⁰

¹¹⁹ Shih më pas paragrafin 1.2.3 të kapitullit 1 të këtij Raporti.

¹²⁰ Formula matematikore për kalkulimin e shumës së kompensimit të pagueshme ishte përgatitur nga konsulenti i pavarur ndërkombëtar, Bearing Point.

KAPITULLI 6

ADMINISTRIMI I PRONAVE DHE SKEMA E QIRADHËNIES

6.1 Administrimi i pronave të braktisura

Rregulloret e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60 autorizuan HPD-në që të vendosë pronat nën administrimin e saj të përkohshëm dhe të përkujdeset në mënyrë efektive për bartësit e shpronësuar të së drejtës pronësore në situata të caktuara. Në mars të vitit 2006, KPA-ja duke marrë përgjegjësinë për veprimet e HPD-së morri përgjegjësinë për të udhëhequr pronat që tashmë janë nën administrimin e HPD-së, si dhe për zbatimin e vazhdueshëm të skemës.¹²¹

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 autorizoi administrimin e pronave të braktisura banesore me qëllim të sigurimit të nevojave për strehim të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Më tutje, neni 12 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 autorizoi administrimin e pronës banesore në rrethana si në vijim:

- (i) Me marrëveshje midis palëve për zgjidhjen e kërkesës;
- (ii) Me kërkesë të paraqitësit të kërkesës, pas vendimit të HPCC-së, i cili konfirmon të drejtën pronësore të paraqitësit;
- (iii) Pas dëbimit të banorit aktual, nëse paraqitësit e kërkesave kanë dështuar në riposelimin e pronës brenda 14 ditësh nga dita e njoftimit mbi zbatimin e dëbimit;
- (iv) Në rastet kur asnjë kërkesë nuk është parashtruar për pronën dhe prona është ose e lirë ose banori aktual nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën; ose
- (v) Në rastet kur asnjë kërkesë nuk është parashtruar për pronën, me kërkesë të pronarit apo bartësit të së drejtës banesore të pronës.

Kur prona gjendet nën administrim, KPA-ja është e autorizuar ta shfrytëzojë për qëllime të ofrimit për nevoja të strehimit të personave të zhvendosur dhe refugjatëve. Ajo u lëshon leje të përkohshme për strehim humanitar në pajtim me kriteret e brendshme të ndarjes duke kryer vlerësimin e nevojave të aplikuesve.¹²²

Deri në fund të dhjetorit 2007, 4,493 prona ishin nën administrimin e KPA-së, prej të cilave 3,340 ishin vënë nën administrim bazuar në kërkesat e paraqitësve të suksesshëm

¹²¹ Pasi që KPA merr përgjegjësitë e HPD-së, shih paragrafin 1.4.2 të Kapitullit 1 të këtij Raporti.

¹²² Mandati për të shfrytëzuar pronën nën administrimin mbi baza të përkohshme për qëllime humanitare ka qenë e ngatërruar për vite me apo e interpretuar si mandat për të ofruar dhe zgjidhur banimin humanitar afatgjatë për të pa avancuarit në Kosovë. Kjo nuk është pozita, pasi që lejet e lëshuara personave duke i autorizuar ata të uzurpojnë pronën nën administrim janë aprovuar vetëm në baza të përkohshme. Më pastaj, obligimi statusor për t'u kujdesur dhe për të u adresuar çështjet banesore sociale qëndrojnë tek IPVQ-të, dhe në veçanti në Komuna. Përgjegjësia ishte bartur tek ata nga UNMIK-u në gusht 2000 sipas nenit 1.3 (k) të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45.

të kërkesave, derisa 1,153 ishin si rezultat i intervenimit *ex officio* të KPA-së dhe paraardhësit të saj HPD-së.

6.2 Skema e Qiradhënies

Neni 1.1(b) i Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 parasheh që skema e qirasë të vendoset për pronat që janë nën administrim, ku të hollat e qirasë për pronën nën administrim kërkohej të vireshin në një llogari të posaçme mirëbesimi për pronarin e ligjshëm. Një skemë e tillë e qirasë ishte propozuar gjatë viteve të funksionimit të HPD-së dhe ishin paraqitur propozimet e dizajnit të një skeme të tillë. Megjithatë, për shkak të natyrës së ndjeshme politike të kësaj çështjeje, skema morri aprovimin e nevojshëm politik tek në gusht të vitit 2006 dhe u bë e zbatueshme në tetor të vitit 2006.

Skema shërben për të ofruar mbrojtje ligjore dhe fizike për pronën e banimit që është braktisur duke siguruar burim minimal të të ardhurave për bartësit e zhvendosur të së drejtës pronësore, të cilët përndryshe mund të vendosin të shesin shtëpitë e tyre.

6.2.1 Natyra dhe numri i pronave nën Skemën e Qiradhënies

Në fund të periudhës së raportimit, rreth 3,848 prona banesore janë përfshi në Skemën e Qiradhënies.

Deri në fund të dhjetorit 2007, janë mbledhë gjithsej 431,500 €, prej të cilave 240,000 € i janë bartur pronarëve dhe 131,000 € janë mbajtur si kapar në mirëbesim. Shuma prej 12,000 € është mbajtur për shpenzime administrative të zbatimit të skemës (e barabartë me 5% të qirasë së mbledhur/jo të kaparit).¹²³

Qiraja më e lartë e llogaritur ishte 469 € për prona me sipërfaqe prej 240m² në Ferizaj dhe qiraja më e ulët ishte 10.06 € për një pronë me sipërfaqe prej 30m² në Viti' duke sjellë mesataren e qirasë në 45.85 € për njësi për muaj.

6.2.2 Procedura për vendosjen e pronave nën Skemën e Qiradhënies

Me qëllim të zbatimit të Skemës, KPA-ja hyn në marrëveshje të qirasë me qiramarrësin, dhe mbledh qiranë në baza mujore.¹²⁴ Aty ku nuk paguhet qiraja KPA-ja mund të dëbojë banuesin. KPA-ja merr kaparën nga qiramarrësi vetëm një herë pas nënshkrimit të

¹²³ Pasi që në datën e publikimit në shkurt 2008, shumën e përgjithshme prej €515,000 ishte mbledhur në të cilën €313,000 ishte bartur tek pronarët, €141,000 ishte lënë mënjanë si dopozitë e sigurisë dhe rreth €15,000 për shpenzime administrative.

¹²⁴ Banuesi, i cili pajtohet të bëhet qiramarrës duhet të bëjë pagesat duhet të bëjë pagesën e faturave ndaj muajit të parë të qirasë dhe përveç kësaj edhe një deponim që barazon një muaj qira (deponimi kthehet duke u bazuar në të gjitha kriteret e paraqitur në kontratën mbi qiranë për të u përmbushur) brenda 5 ditëve të nënshkrimit të kontratës mbi qiranë duke paguar shumën në llogari bankare dhe duke marrë dëftesë nga banka si dëshmi e pagesës.

marrëveshjes mbi qiranë. Kapari mbulon qiranë e papaguar apo dëmet në pronë nëse qiramarrësi është përgjegjës për një dëm të tillë. Pjesa e mbetur e kaparit i kthehet qiramarrësit pas përfundimi të marrëveshjes dhe pas inspektimit të pronës.

Gjithsej 19 kontrata për qiranë janë anuluar vullnetarisht gjatë periudhës së raportimit dhe rreth 398 qiramarrës që kanë marrë pronat me qira sipas skemës së qirasë janë dëbuar për shkak të mospagesës së qirasë.¹²⁵ Kjo ka rezultuar në 250 prona të zbrazëta në fund të periudhës së raportimit duke shtuar 97 prona që janë të banueshme, por jo të përshtatshme për t'u dhënë me qira për shkak të gjendjes së tyre dhe vendndodhjes. Ky grup i pronave i është ofruar komunave për t'u shfrytëzuar si ndihmë sociale.

Para se prona të vendosej nën administrim, duhej të merret pëlqimi me shkrim i Bartësit të së Drejtës Pronësore (BDP) dhe prona duhej të inspektohej.¹²⁶

Qiraja e pagueshme për pronë llogaritet duke përdorur një formulë të qirasë bazuar në vlerësimin e këtyre pesë faktorëve vijues:

A: Vlera e Pronës e caktuar nga Komuna: bazuar në vlerën e pronës, sikurse është vlerësuar nga Departamenti Komunal për Tatim:

B: Zhvleftësimi fizik i vlerës kapitale të pronës: kjo është shuma mujore e humbjes së vlerës së pronës dhe ajo llogaritet në bazë të jetës mesatare të pronës, e cila është përafërsisht 80 vjet;

C: Kthimi vjetor i investimeve: kjo llogaritet çdo vit, dhe është mesatarja e kamatës mujore që e paguajnë bankat në Kosovë për kapar që është baras me vlerën e pronës. Shkalla vjetore e interesit në kohën e publikimit të raportit është 3.72% (e ulët= 2% BPK, e lartë =4.20 KASABANKA).

D: 10% zbritje për shkak të mungesës së shërbimeve të qiradhënësit: pronat nën administrim në përgjithësi nuk përfitojnë nga shërbimet e zakonshme të qiradhënësit siç janë mirëmbajtja. Prandaj, një zbritje prej 10% në qira është e aplikueshme për të marrë këtë faktor parasysh përpos nëse ky shërbim kryhet nga bartësi i të drejtës pronësore, në të cilin rast zbritja nuk është e aplikueshme.

¹²⁵ Përveç kësaj rreth 40 rasteve të dëbimit në pritje janë të lidhura me banuesit, të cilët janë duke punuar me Trupat e Mbrojtjes së Kosovës. Banuesi, i cili nuk pajtohet të paguaj qira, apo i cili ndalon së paguari pagesat e qirasë, ka afat 30 ditë të lirojë pronën. KPA ekzekuton dëbimin në afatin e skadimit prej 30 ditëve nëse banuesi s'ka mundur të lirojë pronën vullnetarisht. Pas lirimit të pronës i jepet banuesit tjetër. Nëse nuk ka dëm të pronës, qiramarrësi i dëbuar gjithashtu merr deponimin e tij/saj prapa.

¹²⁶ Zyrtaari i KPA-së e inspekton fizikisht pronën me qëllim të vlerësimit të kushteve dhe përshtatshmërisë për përfshirje në Skemë të Qirasë. Një vlerësim komunal duke vlerësuar vlerën e tatueshme të pronës merret gjithashtu përmes shënimeve nga departamenti i Taksave Komunale. Në instancat ku vlera e saktë nuk mund të konstatohet nga të dhënat komunale, prona duhet të vlerësohet në bazë të standardeve komunale për një anketë pronësore të krahasueshme të dimensioneve dhe lokacionit të saktë të lokacionit, sipas koordinatave të zonave të përcaktuara nga autoritetet komunale dhe të përdorura për qëllime të taksave (Zona, Koordinata dhe Kategoria).

E: 25% Përshtatje ndaj gjendjes fizike: Nëse prona shihet të jetë në gjendje jo të mirë gjatë inspektimit të pronës siç është dëshmuar nga fotografitë dhe përshkrimi, 25% zbritje në çmimin e qirasë është i aplikueshëm. Aty ku prona konstatohet të jetë në gjendje shumë të mirë, dhe kjo nuk është për shkak të përmirësimit nga banuesi aktual, qiraja rritet për 25%. Qiraja bëhet vetëm për pjesën e banueshme të pronës. Nëse inspektimi i pronës zbulon që një pjesë e pronës është e pabanueshme, siç është evidentuar nga fotografitë dhe përshkrimi, nuk do të paguhet qira lidhur me pjesën e pabanueshme. Meqenëse taksa komunale vlerësohet mbi pronë, pa marrë parasysh nëse është e banueshme apo jo, kjo zbritje është e nevojshme me qëllim të shmangies së ngarkesës së qirasë për pjesët të cilat nuk janë të banueshme dhe kështu të padobishme për qiramarrësit.

F: 5% Taksë administrative.

Formula e përdorur për llogaritjen e qirasë e ngarkuar për prone është si në vijim:

$$(A:B) + (A:C) - D (+/-E) + F$$

6.3 Veprimtaritë tjera zbatuese të rëndësishme për mandatin e HPD/HPCC-së

Gjatë periudhës së raportimit KPA ka përgatitur rreth 937 kërkesa për dorëzim në gjykata në rastet ku HPCC-ja ka refuzuar kërkesat, por ka konstatuar se kanë ngritur çështjet, të cilat ishin nën jurisdiksionin e gjykatës. HPCC-ja ka referuar këtë aspekt të kërkesës në gjykatën kompetente në pajtim me kompetencat e saj sipas nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 22.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.¹²⁷ Këto kërkesa do të dorëzohen në fillim të vitit 2008.

Puna gjithashtu po vazhdon në përgatitjen e rreth 80 rasteve, ku kishte një falsifikim të qartë të dokumenteve dhe HPCC-ja në vendosjen e kërkesave udhëzoi që çështja të referohet në zyrën e Prokurorit Publik për hetime shtesë. Sekretaria Ekzekutive ka marrë iniciativë, gjatë periudhës së raportimit, për paraqitjen e padive penale duke kërkuar hetime dhe ndjekje penale të këtyre aktiviteteve.

¹²⁷ Çështjet zakonisht të ngritura në kërkesa të cilat ishin jashtë jurisdiksionit të HPCC-së përfshijnë rastet ku paraqitësi i kërkesës ka deklaruar shkelje të kushteve të kontratës dhe ka kërkuar anulimin e kontratës apo rishikimin e marëveshjes së shitblerjes.

KAPITULLI 7

STRUKTURA INSTITUCIONALE DHE PERSONELI

7.1 Struktura institucionale e KPA-së

Zyra qendrore e KPA-së gjendet në Rr. Nazim Gafurri (ish-Milladin Popoviq) në Prishtinë. KPA ka themeluar një rrjet të zyrave regjionale dhe përkrahëse me qëllim të njoftimit të paraqitësve të kërkesave, lehtësimit të regjistrimit të kërkesave dhe ofrimit të informimit palëve në kërkesë.¹²⁸

Në Kosovë, janë Zyrat Rajonale, në të gjitha pesë regjionet si; në Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Nga këto zyra, në zonat e banuara nga anëtarët e komunitetit minoritar, dërgohen ekipet lëvizëse. Poashtu, ngajshëm në zonat e mëdha minoritare janë hapur zyra të terrenit, të cilat shërbejnë si qendra për pranim të kërkesave, ndihmojnë në ofrimin e informacioneve mbi statusin e kërkesave dhe zgjidhjen e procedurave të kërkesave në përgjithësi.¹²⁹

Për shkak të faktit që shumica e paraqitësve të kërkesave edhe gjatë vitit 2007 kanë të zhvendosur jashtë Kosovës në Serbi, IRJM dhe Mal të Zi, zyrat përfaqësuese në Shkup (IRJM) dhe Beograd (Serbi) me degën në Podgoricë (Mal të Zi), vazhdojnë të funksionojnë me qëllim të lehtësimit të pranimit të kërkesave. Përpos kësaj, zyrat përkrahëse dhe njësitet mobile shërbyen në zonat e largëta dhe qendrat kolektive në Serbi dhe Mal të Zi

7.2 Menaxhmenti dhe personeli

Sekretaria Ekzekutive e KPA-së udhëhiqet nga Drejtori dhe Zëvendës Drejtori, ku të dy janë të emëruar nga PSSP-ja. Zëvendës Drejtori emërohet nga Kryeministri dhe për herë parë një gjë e tillë është bërë në korrik të vitit 2007.¹³¹

Drejtori planifikon strukturën organizative të KPA-së dhe është i autorizuar të emërojë stafin e vet vendor dhe ndërkombëtar dhe të caktojë personelin që do t'i shërbejë Komisionit.¹³² Ai është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të KPA-së dhe për formulimin e politikës, sigurimin e fondeve për institucionin dhe raportimin në Bordin

¹²⁸ Shih nenin 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e cila e autorizonte themelimin e zyrave për të lehtësuar regjistrimin e kërkesave në tërë Kosovën.

¹²⁹ Zyra e terrenit ishte funksionale gjatë tërë periudhës së raportimit në Graçanicë dhe në pjesën veriore të Mitrovicës.

¹³¹ Shih nenin 6.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

¹³² Shih nenet 10.3 dhe 10.4 të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 dhe shih Organogramin e KPA-së të bashkangjitur në Aneksin 1.

Mbikëqyrës. Ai është, gjithashtu përgjegjës për raportim në UNMIK, IPVQ dhe komunitetin e donatorëve si dhe grupeve kyçe të interesuara.¹³³

Gjatë periudhës së raportimit, institucioni punësoi një numër prej 255 punëtorëve profesionalë dhe punëtorë tjerë, përfshirë juristë, ndihmës ligjorë, përkthyes, kontabilistë, ekspertë të kompjuterëve dhe të TI-së dhe staf ndihmës administrativ.¹³⁴ Personeli vendor është punësuar sipas dy lloj kontratash, me atë të KB-së dhe të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK). Personeli ndërkombëtar është punësuar sipas kontratave të KB-së dhe një numër i stafit është caktuar në këtë institucion nga UNMIK-u dhe nga Qeveria e Norvegjisë, të cilëve u janë dhënë postet e caktuara nga Drejtori.

Përpos zyrës së Drejtorit, njësitë kryesore organizative të Sekretarisë janë Menaxhmenti i Programit, Administrimi i Pronave, Njësi i Implementimit, Krye-sekretaria, Informimi dhe Koordinimi, TI-ja, Njësi për Përpunim të Kërkesave (NJPK) dhe Njësi për Mbështetje Komisionit dhe Zyrat Përfaqësuese/Rajonale.

Në fund të periudhës së raportimit, vetëm nëntë (9) anëtarë të stafit ishin ndërkombëtar. Përbërja ndërkombëtare është prezente kryesisht në cilësinë e vijës së dytë për të ofruar menaxhim të programit, mbikëqyrje dhe udhëzime dhe, aty ku është e nevojshme, për të mbrojtur stafin duke formuar një mburojë ndaj presionit të jashtëm politik.

Kjo gjendje është arritur përmes përpjekjeve të vazhdueshme për ndërtim të kapaciteteve gjatë gjithë viteve të funksionimit, të cilat ishin disenjuar të ndërtojnë dhe të përmirësojnë kapacitetin e stafit vendor. Gjithë stafit i është dhënë qasje e barabartë për trajnim dhe mundësi për zhvillim personal, prej atyre të përfshirë në administratë dhe menaxhment deri tek juristët e caktuar në përpunim të rasteve.

Me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve, personelit i është besuar përgjegjësia dhe është mbështetur në rolet e tij përmes monitorimit, vlerësimit të rregullt mbi performancën dhe këshillimeve.

Kapacitetet, poashtu janë ndërtuar përmes aktiviteteve trajnuese të jashtme dhe të brendshme. KPA-ja ka organizuar ligjërata të brendshme për personelin e saj për një numër çështjesh, përfshirë menaxhimin e projekteve, administrimin, financat, planifikimin, menaxhim të zyrës dhe aftësi udhëheqjeje. KPA-ja gjithashtu ka organizuar trajnim në Menaxhim të Avancuar për stafin vendor që mbajnë pozita udhëheqëse dhe ligjëratat janë ofruar nga një universitet vendor gjatë një periudhe dymujore, gjatë pasditeve.

¹³³ Shih më tutje, kapitullin III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5.

¹³⁴ Në fillim të periudhës së raportimit, ka pasur 157 staf vendor, dhe 11 ndërkombëtarë (8 me kontrata të KB dhe 3 të dërguar nga qeveria e Norvegjisë). Një staf shtesë prej 72 të stafit vendor janë punësuar në të ashtuquajturën me kontrata me Buxhet të Konsoliduar të Kosovës (BKK). Në fund të periudhës së raportimit ka pasur 174 staf vendor, 9 ndërkombëtarë (6 me kontrata të KB dhe 3 të dërguar nga qeveria e Norvegjisë) dhe 72 me kontrata të BKK.

Pushimi aktiv vjetor (annual retreat) që ishte organizuar për anëtarët kyç të personelit me përqëndrim kah nacionalizimi i funksioneve mbikqyrëse të KPA-së është dashur të anulohet për shkak të mungesës së fondeve.

Gjatë periudhës së raportimit, KPA-ja gjithashtu ka filluar një skemë të bursave për nëpunësit e saj duke u mundësuar atyre të ndjekin arsimim të lartë. Rreth njëzetë (20) bursa janë aprovuar gjatë periudhës së raportimit, duke i lejuar nëpunësit të ndjekin studimet në fusha të ndryshme.¹³⁵ KPA-ja financon 80 për qind të shumës për studim dhe regjistrim dhe 20% paguhet nga vet anëtari i personelit.¹³⁶ Bursa duhet të kthehet pas përfundimit të suksesshëm të programit të studimit.

Suksesi në ndërtimin e kapaciteteve i ka mundësuar KPA-së nacionalizimin e funksioneve kyçe, dhe në dhjetor 2007 rreth 10, nga gjashtëmbëdhjetë (16) njësitet (63%), udhëhiqeshin nga stafi vendor dhe tre (3) nga menaxherët vendor ishin femra (30%).

Në vitin 2007, ishin shpenzuar gjithsej 3,092,639 milion euro për paga.

7.3 Shpenzimet e personelit për vitin 2007

<i>Stafi me kontrata të BKK</i>	EUR	143,764
<i>Stafi vendor me kontrata të KB</i>	EUR	1,291,487
<i>Stafi ndërkombëtar me kontrata të KB</i>	EUR	847,388
Të caktuar nga UNMIK-u	EUR	480,000
Të caktuar nga Norvegjia	EUR	330,000
Shpenzimet e përgjithshme për personelin:EUR		3,092,639

¹³⁵ Ligji, Gjuhë angleze, Biznes/Ekonomi, Teknologji Informative dhe Menaxhment.

¹³⁶ Skema është kryesisht për studime të diplomuarve. Të gjithë nëpunësit vendor të KPA-së të punësuar në të dyja në atë të BKK dhe me kontrata të rregullta të KB kanë të drejtë në përfitime nga skema e bursave.

KAPITULLI 8

FINANCIMI DHE BUXHETI

8.1 Financimi

Financimi gjatë tërë periudhës së raportimit ka qenë sfida më e madhe dhe më e vështirë, me të cilën është ballafaquar KPA-ja pasi që mungesa e fondeve vazhdimisht e ka pllakosur këtë institucion. Edhe pse KPA-ja ka mandat të përmbush një nga funksionet kryesore për sundim të ligjit të misionit paqeruajtës në Kosovë, megjithatë nga institucioni kërkohet të sigurojë pothuajse 70% të nevojave materiale nga kontributet vullnetare të donatorëve, për ndryshim nga veprimtaritë dhe subjektet tjera që marrin financim qendror.

Gjatë vitit 2007, fondet kryesore të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës (BKK) dhe burimet thelbësore të UNMIK-ut kontribuonin për vetëm 32% të nevojave të përgjithshme materiale të KPA-së. Për shkak të financimit të kufizuar të donatorëve, KPA-ja është ballafaquar me vështirësi serioze financiare me ç'rast nuk kishte fonde të mjaftueshme për të paguar rrogat e stafit për çerekun e fundit të vitit 2007 dhe për të financuar implementimin e aktiviteteve relevante në lëshimin dhe dorëzimin e vendimeve të Komisionit tek paraqitësit e kërkesës. Me qëllim të adresimit të mungesës financiare është kërkuar ndihma e UNMIK-ut me ç'rast ndau 516,276.00 € hua nga fondi emergjent për të zgjidhur sfidën urgjente dhe për t'i mundësuar KPA-së të bëjë pagesën e rrogave për çerekun e fundit të vitit 2007.

Megjithatë, vështirësitë financiare vazhdojnë pasi nuk ka zotime financiare të mjaftueshme nga komuniteti i donatorëve për vitin 2008. Me qëllim të adresimit të kësaj çështjeje, UNMIK-u ka organizuar një takim të donatorëve më 21 nëntor 2007. ZPSSP-ja kryesoi takimin dhe u apeloj kryesuesve të të gjitha Zyrave Diplomatieke të vendosura në Kosovë të japin fonde për KPA-në në mënyrë që ajo të mund të vazhdojë me operacionet e saja me efikasitet dhe pa ndërprerje. Pjesëmarrësve në takim iu ofruan pakot informative duke u dhënë planet e hollësishme të veprimit për implementimin e mandatit të KPA-së; rëndësinë e saj në sundimin e ligjit, kthimin e popullatës së zhvendosur dhe rilindjen ekonomike në Kosovë, së bashku me vlerësimin e kostos për tërë operacionin. Informacionet relevante përkitazi me caqet janë ofruar gjithashtu së bashku me zotimin për rezultate të rëndësishme. Takimi i donatorëve ishte i suksesshëm sa i përket pjesëmarrjes aktive të drejtuesve të Zyrave Diplomatieke në Prishtinë. Pastaj, disa nga donatorët u bashkangjitën duke deklaruar donacione financiare për procesin. Qeveria e Shteteve të Bashkuara deklaroi një donacion prej 700,000 \$; qeveria e Zvicrës premttoi një kontribut prej 450,000 frangave zvicerane dhe Qeveria e Norvegjisë paraqiti premtimin e saj për përkrahje në shumë prej 1 milion € për vitin 2008.

Drejtuesi i Zyrës Ndërlidhëse Britanike gjithashtu ishte në favor të mbështetjes financiare të vazhdueshme varësisht nga rezultatet e vlerësimit të KPA-së që e kishte autorizuar. Vlerësimi i KPA-së ishte përfunduar nga vlerësuesi i pavarur në dhjetor të vitit 2007.

8.2 Buxheti 2008-2010

KPA-ja ka bërë propozime të detajuara të buxhetit për vitet 2008-2010 që përballon implementim të mandatit të saj të vazhdueshëm dhe efektiv. Në bazë të zotimeve financiare deri më tani, ka një mungesë prej €7.7 milion për këtë periudhë. Veprimet pasuese me komunitetin ndërkombëtar janë momentalisht duke vazhduar me thirrjen për mbështetje financiare.

Si rezultat i zotimeve për vitin 2008 kontratat e të gjithë anëtarëve të stafit vendor janë siguruar për 4 muaj shtesë deri në prill të vitit 2008, derisa një numër i pozitive ndërkombëtare janë shuar për shkak të mungesës së fondeve, duke lënë vetëm (9) anëtarë të stafit ndërkombëtar të siguruar për këtë periudhë.¹³⁷

Shpenzimet mesatare të projekteve të aktiviteteve të KPA-së në periudhën e ardhshme tri vjeçare (2008-2010) janë si në vijim (shumat në €):

Shpenzimet e personelit:	9,300,000
Shpenzimet e operacioneve:	3,600,000
Investimet kapitale (2008 – 2009):	600,000
Aktivitetet e Informimit Publik (2008 – 2009):	500,000
Totali:	14,000,000

Në fund të vitit 2007 KPA parasheh mbështetjen financiare si në vijim për periudhën e njëjtë (shumat në €):

Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (tri vite)	3,000,000
UNMIK-u/Misioni ndërkombëtar (tri vite)	1,440,000
Norvegjia (vetëm në vitin 2008)	1,065,000
SHBA (vetëm në vitin 2008)	480,000
Zvicra (vetëm në vitin 2008)	300,000
Belgjika	10,000
Totali:	6,295,000
Mungesa e përgjithshme e fondit	7,705,000

¹³⁷ Personelit ndërkombëtarë iu është ndarë njësi për përpunim të rasteve (2) Njësi i Administrimit të Pronës (1); Programi (2) zbatimi (2); TI (1); Njësi i Koordinimit dhe Informimit (1). Vetëm një anëtar i stafit ndërkombëtarë është vendosur në regjion. Për shkak se Peja është bërë pikë e nxehtë politike lidhur me kthimin e pronës, ishte e nevojshme të vendosnim një anëtar të stafit ndërkombëtarë atje.

KAPITULLI 9

AKTIVITETET PËR INFORMIM & SHPËRNDARJA E INFORMACIONEVE PUBLIKE

9.1 Transparenca dhe informimi i publikut

Gjatë gjithë periudhës së raportimit KPA gjithnjë është kritikuar për mungesë të shpërndarjes së informacioneve adekuate të shkaktuar drejtpërdrejtë si rezultat i mungesës së fondeve. Sidoqoftë, një numër i iniciativave janë ndërmarrë gjatë vitit 2007 për të bërë agjencinë dhe mandatin e saj më të pranishëm tek publiku i saj d.m.th. palët në kërkesë, OJQ-të, organizatat vendore dhe ndërkombëtare dhe publikun në tërësi.

Përpos aktiviteteve të përmendura në paragrafin 9.3 më poshtë, në tetor të vitit 2007, KPA ka filluar një fushatë për media e cila fokusohet në informimin e qytetarëve të Kosovës rreth mandatit të KPA-së dhe në veçanti rreth të drejtave të tyre, nëse prona në të cilën ata banojnë apo kanë ndonjë interes në të, bëhet lëndë e kërkesës. Kjo fushatë ishte zbatuar kah fundi i vitit në mënyrë shumë të dukshme dhe të re përmes shfrytëzimit të autobusit të KPA-së të dizajnuar në mënyrë që të bjerë në sy. Autobusi ka vizituar 84 fshatra gjatë tërë periudhës së raportimit¹³⁸. Zyrtarët nga KPA kanë udhëtuar me autobus dhe ishin në dispozicion t'u përgjigjen pyetjeve lidhur me punën e këtij institucioni, kornizën e aplikueshme ligjore dhe procedurat që qeverisin zgjidhjen e kërkesave dhe të drejtat ligjore të palëve përgjegjëse në kërkesa. Fshatrat e vizituara me autobus të KPA-së janë zgjedhur në bazë të numrit të kërkesave pronësore të paraqitura në atë zonë.

KPA-ja gjithashtu ka vazhduar me shërbimet e veta të Qendrës për Informacione Telefonike dhe linjat e dedikuara telefonike (038/249936) dhe e-mailin (mailbox@kpaonline.org) ashtu që palët mund të informohen me shpejtësi për statusin momental të kërkesës së tyre, dhe të marrin informacione për procesin dhe procedurat që zhvillohen në KPA-së.

Agjencia gjithashtu ka vazhduar me dy ueb faqe (www.hpdkosovo.org) për kërkesat e HPD-së dhe (www.kpaonline.org) për kërkesat e KPA-së në mënyrë që të ofrojë një numri të gjërë të informacioneve dhe statistikave në lidhje me aktivitetet e veta, gjegjësisht për pranimin e kërkesave, vendosjen mbi kërkesat nga ana e Komisionit, implementimin e vendimeve të paimlementura të HPCC-së, menaxhimin e dosjeve të pronave nën administrim dhe skemën e qirasë.

¹³⁸ Gjatë periudhës së raportimit Fushata me autobus ka takuar 400 anëtarë të publikut. Sikurse në datën e publikimit, autobusi ka vizituar 200 fshatra.

9.2 Bashkëpunimi ndërmjet agjencive

KPA-ja ka lobuar aktivisht dhe ka avokuar fuqishëm gjatë gjithë vitit 2007 për mbështetje nga autoritetet vendore për implementimin e mandatit të saj. Është theksuar se parakusht i domosdoshëm për përfundimin e shpejtë të implementimit të mandatit të saj është mbështetja publike për procesin nga liderët dhe institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Në përpjekje që institucionet dhe autoritetet vendore dhe ndërkombëtare të pajisen me informacione, KPA-ja është takuar rregullisht me akterët tjerë në fushën e të drejtave pronësore me qëllim të ngritjes së vetëdijes për punën e saj dhe rëndësinë e saj në kthimin e popullatës së zhvendosur, zhvillimit ekonomik dhe sundimit të ligjit. Gjithashtu, KPA rregullisht është takuar me zyrtarët nga IPVQ (autoritet lokale dhe qendrore).

Raportet me autoritetet relevante të zbatimit të ligjit (Policinë e UNMIK-ut, Shërbimin Policor të Kosovës dhe KFOR-in) kanë qenë të mira gjatë tërë periudhës së raportimit. Në rastet kur dëbimet ishin të domosdoshme ato janë kryer nga zyrtarët e KPA-së me mbështetjen e autoriteteve të zbatimit të ligjit. Sidoqoftë, së fundi, KPA-ja nuk e ka gëzuar një përkrahje të tillë për operacionet e saja në pjesën veriore të Mitrovicës. Në fund të periudhës së raportimit, ka pasur njëmbëdhjetë (11) raste në pritje të zbatimit në këtë hapësirë dhe këto raste kanë ngritur shqetësime. Së pari, autoritetet përgjegjëse me personel ndërkombëtar në pjesën veriore të qytetit nuk janë angazhuar në mënyrë aktive për të zgjidhur nevojën e strehimit alternativ për uzurpuesit ilegal në këto prona, duke lejuar në këtë mënyrë riposedimin në favor të bartësve të së drejtës pronësore të zhvendosur në pjesën jugore. Së dyti, mbështetja e kërkuar nga Policia e UNMIK-ut për të vazhduar me dëbimin e banuesve ilegal nuk vinte. Si pasojë, KPA-ja nuk ishte në gjendje të përfundojë numrin e rasteve të planifikuara të HPD-së.

Me qëllim të vendosjes së kontaktit me komunitetin minoritar, KPA-ja është takuar me Ministrinë e Komunitetit dhe Kthimit të IPVQ-së dhe shumë subjekte në Beograd, siç janë përfaqësuesit e institucioneve të Qeverisë, OJQ-të, donatorët dhe organizatat ndërkombëtare. Më tutje, zyrtarët e KPA-së rregullisht kanë ndjekur dhe kanë marrë pjesë në takimet dhe trajnimet në Kosovë dhe Serbi, të cilat ishin organizuar nga organizatat e përfshira në çështjet e rëndësishme në lidhje me të drejtat pronësore dhe në procesin e kthimit.

KPA-ja përfaqësohet dhe i raporton Grupit Punues mbi Standardet e të Drejtave Pronësore, i bashkë-kryesuar nga IPVQ dhe OSBE-ja i cili ka mandatin të monitorojë implementimin e standardeve mbi të drejtat pronësore në Kosovë.

Me qëllim të informimit përkitazi me natyrën e punës së saj një numër i buletineve informative janë shtypur dhe janë shpërndarë në tërë Kosovën, Serbi, Mal të Zi dhe IRJM. Në mesin e pranuesve janë përfshirë edhe organizatat vendore dhe ndërkombëtare,

entitetet qeveritare, zyret ndërlidhëse diplomatike, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, gjykatësit, avokatët, prokurorët, mediat vendore dhe ndërkombëtare, institucionet arsimore dhe organet tjera të interesuara.

Zëvendës Drejtori KPA-së dhe stafi tjetër i KPA-së vazhdojnë të marrin pjesë rregullisht në takime dhe ceremoni të ndryshme ndërmjet agjencive. KPA-ja vazhdon të gëzojë bashkëpunim të frytshëm me entitetet qeveritare dhe jo-qeveritare të vendosura në Beograd. Raportet e punës janë të mira me UNMIK-un si dhe me institucionet e IPVQ-së. Raportet profesionale me Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) janë paksa kundërshtuese pasi që kjo Agjeneci insiston në kushtëzimin e bashkëpunimit të saj me pagesën e taksave sipas tarifave komerciale. Kjo, jo vetëm që është shkelje e nenit 4.2 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative Nr. 2007/5, por ka ndikim negativ në notifikimin e kërkesave dhe prandaj, e ngadalëson efikasitetin dhe zgjatë periudhën kohore të nevojshme për të përfunduar procesin e notifikimit.¹³⁹

Me qëllim të lehtësimit të procesit të ankesës, Drejtori dhe Zëvendës- Drejtori janë takuar me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatësin Kryesor Ndërkombëtar të Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme dhe përfaqësues të tjerë nga gjyqësori dhe Departamenti i Drejtësisë me qëllim të diskutimit të procedurës për shqyrtimin e ankesave potenciale kundër vendimeve të Komisionit.

9.3 Mediat dhe fushatat për informim të publikut

Gjatë gjithë vitit, KPA-ja ka shfrytëzuar fuqishëm praninë e mediave. Përfaqësuesit e KPA-së kanë dhënë intervista për gazeta, radio dhe stacione televizive dhe konferenca për shtyp për çështjet që kanë të bëjnë me pronat. KPA-ja gjithashtu u ka ofruar mediave informacione dhe statistika të rregullta dhe të përditësuara mbi aktivitetet dhe linjën e veprimit të vet përmes Njesisë për Informim.

Fushata gjithë-përfshirëse publike informative që ka nisur fillimisht në vjeshtë të vitit 2006 vazhdoi gjatë muajve të parë të vitit 2007 për të informuar publikun mbi procesin e KPA-së dhe mundësisë për të paraqitur kërkesat. Fushata ishte organizuar përmes publikimit në media, informacioneve online (www.kpaonline.org),¹⁴⁰ shpalljeve në gazeta ditore, afishe, TV dhe radio reklamave dhe debateve. Gjithashtu përfshinte intervista në media dhe subjektet kyçe në fushën e së drejtës pronësore, takime me bashkësi, komunikimi me shoqata dhe OJQ që punojnë me personat e zhvendosur dhe refugjatë, të cilat të gjitha janë caktuar për të promovuar informimin e publikut për Agjencinë dhe mandatin e saj.

Para mbylljes së pranimi të kërkesave më 3 dhjetor 2007, KPA-ja ka zbatuar një fushatë të informimit publik për të informuar të gjithë paraqitësit e kërkesave të mundshëm rreth

¹³⁹ Të shqyrtuara më pas në paragrafin 3.2 kapitulli 3 i këtij Raporti.

¹⁴⁰ ueb faqja e KPA-së në www.kpaonline.org i fron statistikat e përditësuara mbi pranimin e kërkesës, procesin e KPA-së dhe skemën e qirasë.

datës së mbylljes për paraqitje të kërkesës. Përfaqësuesit e KPA-së kanë marrë pjesë në intervista në TV dhe Radio në Kosovë dhe Serbi duke bërë mbulesë mediale në lidhje me numrin e kërkesave të paraqitura dhe afatin përfundimtar të pranimi të kërkesave. Rreth 35,000 kopje të broshurave informative mbi afatin për pranim të kërkesave dhe rreth 32,000 kopje të broshurave informative mbi procedurën e notifikimit janë shtypur dhe shpërndarë gjatë periudhës së raportimit.

NGJARJET KYÇE GJATË VITIT 2007

- Në maj, janë emëruar nga PSSP-ja. tre anëtarët e Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës
- Në qershor, anëtarët e Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore kanë paraqitur Raportin e tyre te PSSP-ja.
- Në qershor, PSSP-ja ka nxjerrë Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e cila përcakton rregullat për evidencë dhe procedurë të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës dhe përfshinte dispozitat kyçe në procedurat të cilat rregullojnë funksionet e Sekretarisë Ekzekutive dhe Bordit Mbikëqyrës.
- Në qershor, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës ka mbajtur një seancë inauguruese në të cilën vendosi 498 kërkesa për tokë bujqësore.
- Në tetor, KPA-ja ka filluar fushatën e informimit publik e cila është fokusuar në informimin e qytetarëve të Kosovës rreth punës dhe mandatit të KPA-së dhe në veçanti rreth të drejtave të tyre, nëse prona ku ata kanë uzurpuar bëhet lëndë e kërkesës. Kjo fushatë ishte zbatuar në mënyrë shumë të dukshme dhe novatore përmes shfrytëzimit të autobusit të KPA-së i cili vizitoi fshatrat në tërë Kosovën.
- Në tetor, KPA-ja filloi fushatën informative me qëllim të informimit të publikut rreth afatit përfundimtar për pranim të kërkesave më 3 dhjetor.
- Në nëntor, UNMIK-u mbajti një takim të donatorëve në të cilin ishte kërkuar mbështetje shumë e nevojshme financiare për procesin e KPA-së; qeveria zvicerane premtoi 450,000.00 franga zvicerane, Shtetet e Bashkuara deklaruan një donacion prej 700,000.00 \$dhe qeveria e Norvegjisë premtoi para të gatshme dhe kontribut në lloj në shumë prej 1,000,000 € për vitin 2008.
- Në dhjetor, Zyra Ndërlidhëse Gjermane zotoi 250,000 € për të mbështetur aktivitetet e KPA-së në vitin 2007.

- Më 3 dhjetor pranimi i kërkesave u mbyll.
- Më 12 dhjetor Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës përfundoi seancën e tij të 4-të ku numri i përgjithshëm i kërkesave të vendosura arriti në 3,346.¹⁴¹


| ¹⁴¹ Vëni re se në datën e publikimit të këtij raporti, rreth 5,749 kërkesa janë vendosur nga Komisioni.

ANEKSET

1. Organogrami i KPA-së
2. Lista e pronave nën administrim të KPA-së sipas regjioneve dhe komunave
3. Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50
4. Urdhëresa Administrative e UNMIK-ut 2007/5

Kosovo Property Agency

(285/23/262)



Pronat nën administrim - 31 Dhjetor 2007

Rajoni	Inicuar nga KPA	Bazuar në kërkesën e paraqitur	Gjithsej
Në tërë Kosovën	1072	3475	4547
MITROVICË	205	1034	1239
Lepsaviq	0	0	0
Mitrovicë	73	872	945
Skenderaj	2	36	38
Vushtrri	130	98	228
Zubin Potok	0	10	10
Zveçan	0	17	17
GJILAN	258	309	567
Gjilan	99	28	127
Kamenicë	44	10	54
Kaçanik	0	16	16
Novobërdë	0	10	10
Shtërpce	1	2	3
Ferizaj	15	190	205
Viti	99	53	152
PEJË	238	1359	1597
Gjakovë	19	345	364
Deçan	42	300	342
Klinë	23	72	95
Istog	25	155	180
Pejë	129	487	616
PRISHTINË	313	442	755
Glllogovc	0	1	1
F.Kosovë	75	32	107
Lipjan	20	31	51
Obiliq	53	111	164
Podujevë	0	32	32
Prishtinë	149	224	373
Shtime	16	10	26
PRIZREN	58	331	389
Dragash	0	6	6
Malishevë	0	0	0
Rahovec	0	47	47
Prizren	56	217	273
Suharekë	2	60	62

UNMIK/REG/2006/50
16 tetor 2006

RREGULLORE NR. 2006/50

**MBI ZGJIDHJEN E KËRKESAVE LIDHUR ME PRONËN E
PALUAJTSHME PRIVATE, DUKE PËRFSHIRË PRONËN BUJQËSORE
DHE ATË KOMERCIALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik të vitit 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Me qëllim të pezullimit të përkohshëm të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10 dhe sigurimit të përkohshëm të zgjidhjes së kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, pa i referuar kërkesat e tilla në gjykatat me kompetencë territoriale dhe lëndore për ta,

Me anë të kësaj shpall si në vijim:

Kapitulli I
Statusi i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10

Neni 1
Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/10

1.1 Pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, fuqia ligjore e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10 pezullohet pjesërisht përkohësisht pa cenuar nenet 16, 17

dhe 18 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10, të cilat do të vazhdojnë të kenë fuqi ligjore.

1.2 Vendimi apo veprimi i marrë në mënyrë valide në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/10 para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje vazhdon të ketë fuqi ligjore.

Kapitulli II **Agjencia Kosovare e Pronës**

Neni 2 Agjencia Kosovare e Pronës

Agjencia Kosovare e Pronës e themeluar në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/10 do të funksionojë si organ i pavarur, në pajtim me kapitullin 11.2 të Kornizës Kushtetuese.

Neni 3 Përgjegjësitë e Agjencisë Kosovare të Pronës

3.1 Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive ka kompetenca për të pranuar dhe për të regjistruar dhe, përmes Komisionit për kërkesa pronësore ka kompetenca për t'i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:

- (a) Kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe
- (b) Kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore.

3.2 Asgjë në këtë nen nuk i cenon të drejtat e paditësve që të ndjekin pranë gjykatave kompetente kërkesat që nuk përfshihen në kërkesat e paraqitura në nenin 3.1.

Kapitulli III

Organizimi i Agjencisë Kosovare të Pronës

Neni 4

Organizimi i Agjencisë Kosovare të Pronës

Agjencia Kosovare e Pronës përbëhet nga Bordi mbikëqyrës, nga Sekretaria ekzekutive dhe nga Komisioni për Kërkesa Pronësore (Komisioni).

Neni 5

Bordi mbikëqyrës i Agjencisë Kosovare të Pronës

5.1 Bordi mbikëqyrës do të mbikëqyrë punën e Agjencisë Kosovare të Pronës dhe do të ofrojë mbikëqyrje administrative e udhëzime për politikat dhe orientimin e përgjithshëm. Nuk do të marrë pjesë në procesin përmes të cilit Komisioni i miraton konstatimet dhe konkludimet për kërkesat individuale.

5.2 Bordi mbikëqyrës përbëhet prej pesë (5) anëtarëve. Pas një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i emëron pesë anëtarët e Bordit mbikëqyrës, dy prej të cilëve do të emërohen nga Kryeministri. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të caktojë për kryesues njërin prej tre (3) anëtarëve të Bordit mbikëqyrës i cili nuk është emëruar nga Kryeministri.

5.3 Nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm konstaton se është e duhur, gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ai cakton edhe dy (2) anëtarë të tjerë në Bordin mbikëqyrës me emërimin e Kryeministrit, të cilët i zëvendësojnë dy anëtarët tjerë, përveç kryesuesit i cili nuk është emëruar nga Kryeministri.

5.4 Anëtarët e Bordit mbikëqyrës shërbejnë për një mandat njëvjeçar, por që mund të ripërtëriten.

5.5 Asnjë person nuk mund të bëhet apo të mbetet anëtar i Bordit mbikëqyrës nëse:

(a) Është dënuar me burgim prej një apo më shumë vitesh pas një procesi të duhur dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare;

(b) Është përjashtuar apo larguar për keqsjellje profesionale nga ushtrimi i profesionit të tij ose

(c) Ka interesa që janë në konflikt me përgjegjësitë e tij sipas kësaj Rregulloreje.

5.6 Anëtari i Bordit mbikëqyrës mund të largohet prej kësaj detyre nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nëse:

(a) E humb të drejtën për të shërbyer si anëtar i Bordit mbikëqyrës sipas nenit 5.5;

(b) E përdor postin e tij në mënyrën e cila nuk është në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e tij zyrtare të përcaktuara me këtë Rregullore ose

(c) Shpërfill jashtë mase detyrat e tij sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 6 Sekretaria ekzekutive

6.1 Sekretaria ekzekutive ka drejtorin dhe zëvendësdrejtorin, të cilët caktohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Zëvendësdrejtori emërohet nga Kryeministri.

6.2 Përgjegjësitë e Sekretarisë ekzekutive përfshijnë regjistrimin e kërkesave dhe përgjigjet në kërkesat e tilla, njoftimin e palëve dhe përgatitjen e kërkesave e përgjegjeve në kërkesa për t'u shqyrtuar nga Komisioni. Sekretaria ekzekutive ka kompetenca të refuzojë kërkesat që arsyeshëm janë të papranueshme dhe që nuk janë në kuadër të kompetencave të Agjencisë Kosovare të Pronës.

6.3 Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretarisë ekzekutive mund të paraqiten në detaje në një urdhëresë administrative të nxjerrë nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 7 Komisioni për kërkesa pronësore

7.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i emëron anëtarët e Komisionit dhe një anëtar e cakton për kryesues. Anëtarët e Komisionit janë ekspertë në lëmin e të drejtës pronësore-banesore dhe janë të aftë për të ushtruar kompetenca gjyqësore në postin e tyre.

7.2 Komisioni përbëhet nga dy (2) anëtarë ndërkombëtarë dhe një vendor. Anëtari vendor emërohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm me caktimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

7.3 Nëse Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e konsideron të duhur, gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ai mund të emërojë edhe një anëtar tjetër vendor të Komisionit i cili e zëvendëson anëtarin ndërkombëtar që nuk është kryesues.

7.4 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të krijojë edhe panele shtesë të Komisionit në konsultim me Komisionin.

Neni 8

Emërimi dhe shkarkimi nga detyra i anëtarëve të Komisionit të kërkesave pronësore

8.1 Anëtarët e Komisionit emërohen nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm për një mandat fillestar njëvjeçar dhe mund të riemërohen për një apo më tepër afate.

8.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund ta largojë anëtarin e Komisionit nga detyra me rekomandim të shumicës së anëtarëve të Komisionit për shkak të mungesës së kualifikimit përkatës për atë post ose për shkak të mospërbushjes së vazhdueshme dhe të paarsyetuar të detyrave të postit.

8.3 Anëtari i Komisionit përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurë kur ekzistojnë kushtet për përjashtim të parapara në nenin 29 të Ligjit mbi procedurën administrative.

8.4 Personat me interes ligjor në procedurë mund të kërkojnë përjashtimin e anëtarit të Komisionit me kërkesë me shkrim drejtuar kryesuesit të Komisionit.

8.5 Komisioni vendos për përjashtimin e anëtarëve të Komisionit.

Neni 9

Parashtrimi i kërkesave

9.1 Kërkesa e përcaktuar në nenin 3.1 të kësaj Rregulloreje mund të parqitet në Sekretarinë ekzekutive nga çdo person fizik apo juridik .

9.2 Sekretaria ekzekutive i pranon kërkesat në zyrat e themeluara për këtë qëllim në Kosovë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

9.3 Sekretaria ekzekutive do të vendosë një procedurë për të lehtësuar pranimin e kërkesave nga personat e zhvendosur brenda vendit që aktualisht banojnë jashtë Kosovës.

Neni 10

Procedura për përpunimin e kërkesave

10.1 Pas pranimin të kërkesës, Sekretaria ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë. Në rastet e duhura, përpjekjet e tilla të arsyeshme do të jenë në formë të një lajmërimi në një botim zyrtar të Sekretarisë ekzekutive.

10.2 Çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë është palë në këtë kërkesë dhe në procedurat e përafërta, me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1.

10.3 Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.

10.4 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e kopjes së kërkesës, pala pranuese mund t'i dërgojë Sekretarisë ekzekutive përgjigje në kërkesë.

Neni 11

Procedura dhe vendimet e Komisionit për kërkesa pronësore

11.1 Përveç nëse parashihet ndryshe me këtë Rregullore apo me ndonjë urdhëresë administrative me të cilën zbatohet kjo Rregullore, dispozitat e Ligjit mbi procedurën administrative zbatohen përshtatshmërisht për procedurat e Komisionit.

11.2 Komisioni i merr vendimet në bazë të kërkesës dhe përgjigjes apo përgjigjeve.

11.3 Komisioni mund të:

(a) bashkojë ose shkrijë kërkesat me qëllim të shqyrtimit të tyre dhe marrjes së vendimeve lidhur me to kur ka çështje të përbashkëta dhe të qarta ligjore që duhet shqyrtuar;

(b) ngarkojë stafin e Sekretarisë ekzekutive të caktuar nga drejtori i Sekretarisë ekzekutive për t'i shërbyer Komisionit, që të kryejnë funksionin e shqyrtimit të kërkesave dhe dëshmime të caktuara nën mbikëqyrjen dhe miratimin përfundimtar të Komisionit;

(c) përdorë bazën e të dhënave, programet dhe mjetet tjera elektronike për të përshpejtuar vendimmarrjen dhe

(d) ndërmerr masa të tjera procedurale që i konsideron të duhura për të përshpejtuar vendimmarrjen.

11.4 Komisioni e refuzon kërkesën në tërësi apo pjesërisht kur:

(a) Parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur kërkesë complete në pajtim me procedurat e parapara në këtë Rregullore;

(b) Kërkesa nuk është në kompetencë të Agjencisë Kosovare të Pronës;

(c) Kërkesa është shqyrtuar më parë dhe për të është vendosur me vendim administrativ apo gjyqësor të formës së prerë.

11.5 Me kërkesë të parashtruesit të kërkesës dhe me rekomandim të Sekretarisë ekzekutive, Komisioni mund të lejojë ndërmarrjen e masave të përkohshme mbrojtëse, duke përfshirë edhe urdhrin e përkohshëm, kur parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë të pranueshme dhe nëse masat e përkohshme nuk lejohen do të pësojë dëme të pariparueshme.

11.6 Kur është në interes të drejtësisë, Komisioni mund të kërkojë dhe të shqyrtojë parashtresa të tjera me shkrim nga palët apo të mbajë seancë dëgjimore me të gjitha palët e përfshira, duke përfshirë dëshmitarët dhe ekspertët. Në rastet e tilla Komisioni vepron pa vonesa.

11.7 Për të gjitha seancat dëgjimore të mbajtura pranë Komisionit mbahet dhe ruhet procesverabali. Në procesverbal përfshihen dëshmitë e dëgjimit.

11.8 Vendimi i Komisionit mbi ankesën është ligjërisht detyrues pa cenuar të drejtën në ankesë sipas nenit 12 dhe Agjencia Kosovare e Pronës i njofton palët për këtë. Agjencia Kosovare e Pronës u dërgon palëve kopje të vendimit.

Kapitulli IV **E drejta në ankesë**

12.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.2 Përveç nëse me këtë Rregullore apo me ndonjë urdhëresë administrative me të cilën zbatohet kjo Rregullore parashihet ndryshe, dispozitat e Ligjit mbi procedurën civile zbatohen përshtatshmërisht në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme.

12.3 Ankesa mund të paraqitet nëse:

(a) Vendimi përmban ndonjë gabim të rëndë apo moszbatim serioz të së drejtës lëndore a procedurale ose

(b) Vendimi bazohet në fakte jo të plota apo në vlerësimin e gabuar të fakteve.

12.4 Pas marrjes së ankesës, Agjencia Kosovare e Pronës përmes Sekretarisë ekzekutive i dërgon kopje palës ose palëve të tjera dhe ankesën me dosjen e Komisionit lidhur me të ia dërgon Gjykatës Supreme të Kosovës.

12.5 Pasi të paraqitet ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës nga pala, vendimi i Komisionit pezullohet dhe nuk mund të ekzekutohet derisa rasti të jetë në pritje për t'u zgjidhur në Gjykatën Supreme të Kosovës.

12.6 Sekretaria ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës, nëse kërkohet I ofron palës së pakënaqur informacione dhe udhëzime lidhur me procedurën që duhet ndjekur në përgatitjen e ankesës drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës. Sekretaria ekzekutive gjithashtu mund të vendosë procedura për të lehtësuar pranimin e ankesave nga refugjatët dhe personat e zhvendosur brenda vendit, që aktualisht banojnë jashtë Kosovës dhe transferimin e tyre në Gjykatën Supreme të Kosovës.

12.7 Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e kopjes së ankesës, pala apo palët tjera dorëzojnë përgjigje me shkrim në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë së Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.8 Gjykata Supreme e Kosovës vendos lidhur me ankesat në trupin gjykues prej tre (3) gjyqtarëve të autorizuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, prej të cilëve dy janë gjykatës ndërkombëtarë dhe njëri gjykatës është banor i Kosovës.

12.9 Kur është në interes të drejtësisë, Gjykata Supreme e Kosovës mund të kërkojë rivlerësim ose sqarim të mëtutjeshëm të vendimit ndaj të cilit është parashtruar ankesë nga Komisioni. Në këto raste Gjykata Supreme e Kosovës vepron pa vonesë.

12.10 Kur është në interes të drejtësisë, pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga pala përpos parashtruesit të ankesës të dorëzuar në pajtim me nenin 12.7 të kësaj Rregulloreje, Gjykata Supreme e Kosovës mund të kërkojë dhe shqyrtojë parashtrësia të tjera me shkrim të dorëzuara nga palët apo të mbajë seancë dëgjimore. Në rastet e tilla Gjykata Supreme e Kosovës vepron pa vonesë.

12.11 Faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Nëse faktet dhe dëshmitë e tilla materiale pranohen, Gjykata Supreme mund të kërkojë vlerësimin dhe vërejtjet e Komisionit për këtë. Në rastet e tilla Komisioni vepron pa vonesë për këto kërkesa.

12.12 Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se i ka marrë të gjitha dëshmitë që kërkohen për të vendosur mbi ankesën, ajo merr vendim për këtë ankesë dhe atë ia dërgon Agjencisë Kosovare të Pronës. Vendimin e marrë nga Gjykata Supreme lidhur me ankesën Agjencia Kosovare e Pronës ua dërgon palëve përmes Sekretarisë ekzekutive.

Neni 13 Vendimi mbi ankesën

13.1 Gjykata Supreme e Kosovës, sipas rregullit, vendos mbi ankesën bazuar në faktet e paraqitura në këtë gjykatë dhe të shqyrtuara nga Komisioni.

13.2 Kur është e justifikueshme Gjykata Supreme, në bazë të dëshmive të paraqitura si duhet, vetë mund të vendosë mbi faktet e vlerësuara nga Komisioni.

13.3 Gjykata Supreme:

- (a) e pranon ankesën dhe merr vendim të ri me ndryshimet që mund të kërkohen në vendimin e Komisionit;
- (b) e refuzon ankesën si të papranueshme për arsye procedurale ose
- (c) e refuzon ankesën si të pabazuar dhe e konfirmon vendimin e Komisionit.

13.4 Gjykata Supreme e Kosovës mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara kur për bashkimin apo shkrirjen e tillë është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje.

13.5 Gjatë interpretimit të kësaj Rregulloreje apo të cilësdo urdhërese administrative me të cilën zbatohet kjo Rregullore, Gjykata Supreme e Kosovës mund t'i merr parasysh dispozitat e ligjit në fuqi lidhur me kompetencat e Gjykatës Supreme për procedurat civile, me ndryshimet apo kualifikimet e tilla që i konsideron të nevojshme apo të duhura në rrethanat përkatëse.

13.6 Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës janë të formës së prerë e të plotfuqishme dhe nuk mund të kundërshtohen përmes mjeteve juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme

Kapitulli V

Ekzekutimi i vendimeve dhe i mjeteve juridike

Neni 14

Ekzekutimi i vendimeve

14.1 Vendimi i Komisionit ekzekutohet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas datës së njoftimit të palëve për vendimin nëse në Gjykatën Supreme të Kosovës nuk parashtrohet ankesë.

14.2 Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës ekzekutohet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas njoftimit të palëve mbi vendimin.

Neni 15

Mjetet juridike

Mjetet juridike për ekzekutimin e vendimit mund të përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në dëbimin, vendosjen e pasurisë nën administrim, marrëveshjen për qiradhënie, konfiskimin dhe shkatërrimin e strukturave të paligjshme dhe ankandin .

Neni 16 Dëbimi

16.1 Në rast se vendimi ka të bëjë me dëbimin e personave, Agjencia Kosovare e Pronës ia dërgon vendimin poseduesit aktual të pronës kontestuese me të cilin vërtetohet urdhri për dëbim.

16.2 Vendimi me të cilin vërtetohet urdhri për dëbim zbatohet pas dorëzimit të tij. Urdhri për dëbim mund të zbatohet kundër çdo personi që ndodhet në atë pronë në kohën e dëbimit.

16.3 Dëbimi zbatohet nga nëpunësi përgjegjës i Agjencisë Kosovare të Pronës me ndihmën e organeve për zbatimin e rendit dhe ligjit. Ky nëpunës dhe organet duhet ta kenë fleturdhëresën e nënshkruar nga drejtori i Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

16.4 Gjatë zbatimit të urdhrit për dëbim, çdo person që nuk u përmbahet udhëzimeve të nëpunësit përgjegjës për t'u larguar nga prona mund të largohet nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit. Në rast se gjatë ekzekutimit të urdhrit për dëbim largohet pasuria e luajtshme, Agjencia Kosovare e Pronës duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të zvogëluar rrezikun e dëmtimit apo të humbjes së kësaj pasurie.

16.5 Agjencia Kosovare e Pronës e njofton kërkuesin dhe personin i cili e posedon pronën lidhur me datën e caktuar për dëbim. Pas zbatimit të urdhrit për dëbim, nëse kërkuesi nuk është i pranishëm për ta marrë pronën në posedim të menjëhershëm, nëpunësi përgjegjës e plumbon pronën dhe e njofton kërkuesin. Çdo person i cili pa arsye ligjore hyn në pronën e plumbosur duke e thyer atë i nënshtrohet largimit nga prona nga organet për zbatimin e rendit dhe ligjit.

Kapitulli VI **Dispozitat kalimtare**

Neni 17

Kërkesat e parashtruara pranë Drejtorisë për Çështje Banesore e Pronësore

Agjencia Kosovare e Pronës i ushtron kompetencat e ekzekutimit lidhur me çdo vendim apo urdhër për dëbim të Komisionit të Kërkesave për Çështje Banesore e Pronësore që mund të ekzekutohen në ditën e hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10, por që nuk janë ekzekutuar nga Drejtoria për Çështje Banesore e Pronësore. Në ushtrimin e kompetencave të tilla ekzekutive, Agjencia Kosovare e Pronës ka të drejtat, detyrimet, përgjegjësitë dhe kompetencat që i ka pasur Drejtoria për Çështje Banesore Pronësore para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/10.

Neni 18

Kërkesat e parashtruara pranë gjykatave

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 19

Kthimi i të drejtave të banimit për banesat shoqërore të humbura si rezultat i diskriminimit

Agjencia Kosovare e Pronës merr përsipër përgjegjësitë e Drejtorisë për Çështje Banesore Pronësore sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60 mbi kthimin e të drejtave të banimit për banesat shoqërore të humbura si rezultat i diskriminimit. Dispozitat e saj do t'i zbatojë në pajtim me kriteret dhe procedurat e miratuara nga Agjencia Kosovare e Pronës për llogaritjen e shumave nga neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/60.

Kapitulli VII

Dispozitat përfundimtare

Neni 20

Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që nuk është në përëputhje me të.

Neni 21
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 22
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 16 tetor 2006 pa e cenuar pushtetin e vazhdueshëm të Komisionit për Kërkesa të Çështjeve Banesore e Pronësore për të vendosur lidhur me kërkesat të cilat tashmë janë parashtruar në Drejtorinë për Çështje Banesore e Pronësore për rishqyrtimin e vendimeve në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/60. Kjo Rregullore mbetet në fuqi deri më 31 dhjetor 2008. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm apo organi pasues kompetent mund ta vazhdojë vlefshmërinë e kësaj Rregulloreje edhe për një periudhë tjetër.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

UNITED NATIONS

United Nations Interim
Administration Mission in
Kosovo

**UNMIK****NATIONS UNIES**

Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

UNMIK/DIR/2007/5

1 qershor 2007

URDHËRESË ADMINISTRATIVE NR. 2007/05

**PËR ZBATIMIN E RREGULLORES NR. 2006/50 MBI ZGJIDHJEN E
KËRKESAVE LIDHUR ME PRONËN E PATUNDSHME PRIVATE, DUKE
PËRFSHIRË PRONËN BUJQËSORE DHE KOMERCIALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas neneve 6.3 dhe 21 të Rregullores së Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nr. 2006/50, të datës 16 tetor 2006 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, si dhe

Me qëllim të arritjes së zgjidhjes efikase dhe të efektshme të kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale dhe të lehtësimit të zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50,

Nxjerrë Urdhëresën administrative si në vijim:

Neni 1

Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj Urdhërese administrative, përveç nëse në kontekst parashihet ndryshe:

“Pronë e braktisur” do të thotë pronë, të cilën pronari apo poseduesi i ligjshëm dhe anëtarët e familjes së tij përgjithmonë apo përkohësisht, përveç mospranisë së rastit, nuk e përdorin më dhe e cila është e zbrazët apo e uzurpuar.

“Pronë bujqësore” do të thotë tokë bujqësore, kullosë apo mal në pronësi private.

“Ndërtues” do të thotë çdo person që e ndërton një strukturë ndërtimore apo ndikon që kjo strukturë të ndërtohet.

“Paditës” do të thotë çdo person fizik apo juridik, i cili ia ka parashtruar kërkesën pronësore të cekur në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

“Pronë komerciale” do të thotë çdo objekt në pronë private që përdoret zyrtarisht apo jozyrtarisht për qëllime komerciale.

“Komision” do të thotë Komisioni për kërkesa pronësore i Agjencisë Kosovare të Pronës, i cili është themeluar në bazë të nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, dhe interpretohet në lidhje me nenin 7 të kësaj Rregulloreje.

“Diskriminim” do të thotë çdo diferencim i bërë në bazë të gjuhës, fesë, mendimit politik a të mendimit tjetër, të prejardhjes kombëtare apo etnike ose të asociimit me bashkësinë ndërkombëtare, i cili ka qëllimin apo efektin e anulimit apo të pengimit të njohjes, të gëzimit apo të ushtrimit në mënyrë të barabartë të së drejtës në pronë.

“Sekretaria ekzekutive” do të thotë sekretaria ekzekutive e Agjencisë Kosovare të Pronës, që është themeluar sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 dhe interpretohet në lidhje me nenin 6 të kësaj Rregulloreje.

“Vlera e drejtë e tregut” do të thotë vlera e tregut e pronës në datën e bartjes së të drejtës në pronë.

“Ndërtim i paligjshëm” do të thotë çfarëdo ndërtimi i strukturës apo aneksit në strukturën ekzistuese në pronë private të paluajtshme, i cili nuk është në përputhje me ligjin në fuqi, apo i cili është bërë pa pëlqimin me shkrim të pronarit.

“Anëtar i familjes” do të thotë bashkëshorti apo bashkëshortja, fëmijët (e lindur në martesë apo të birësuar) dhe personat e tjerë, të cilët është i obliguar t’i përkrahë poseduesi i të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, apo personat që janë të obliguar ta përkrahin poseduesin e të drejtës në pronë në përputhje me ligjin në fuqi, pavarësisht nëse ai person ka banuar në atë pronë së bashku me poseduesin e së drejtës në pronë apo jo.

“Pronë” do të thotë çdo pronë e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore apo komerciale.

“E drejta pronësore” do të thotë çdo e drejtë në pronë, në posedim të ligjshëm, në të drejtën për shfrytëzim apo në të drejtën për banim në pronë.

“I paditur” do të thotë çdo person, i cili pas pranimit të njoftimit mbi parashtrimin e kërkesës në sekretarinë ekzekutive, i përgjigjet asaj kërkesë në pajtim me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50.

“Strukturë” do të thotë çdo ndërtim artificial, me bazë në tokë apo në një strukturë ekzistuese, i natyrës së përhershme dhe i madhësisë së tillë që nuk mund të hiqet me kosto të ulët dhe me dëmtime të papërfillshme ndaj tokës apo ndaj strukturës ekzistuese.

“Këshilli mbikëqyrës” do të thotë këshilli i Agjencisë Kosovare të Pronës, i cili është themeluar sipas nenit 4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 dhe interpretohet në lidhje me nenin 5 të Rregullores.

“Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/50 e datës 16 tetor 2006 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale.

“Bartje vullnetare” do të thotë çdo bartje e të drejtave pronësore që nuk është bërë nën presion.

KAPITULLI I

Dispozitat e përgjithshme

Neni 2

Parimet e përgjithshme

2.1 Çdo person që ka pasur të drejtën pronësore, posedimin e ligjshëm apo çfarëdo të drejte të ligjshme në pronë të paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën e tij pronësore për shkak të rrethanave drejtpërdrejt të lidhura me konfliktin e armatosur apo që kanë rezultuar nga ai, i cili ndodhi prej 27 shkurtit 1998 deri më 20 qershor 1999, siç është përkufizuar në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, ka të drejtë në rikthimin e së drejtës së tij në pronë, në cilësinë e poseduesit të së drejtës në pronë. Ky rikthim mund të marrë formën e rimarrjes në pronësi të pronës apo të ndihmesës, mjeteve juridike apo urdhrave pasues që konsiderohen të nevojshme nga Komisioni për t’ia mundësuar poseduesit të së drejtës në pronë ushtrimin në mënyrë të duhur të së drejta ve pronësore, ashtu siç është paraparë në nenin 15 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50.

2.2 Në rastet kur Komisioni vërteton se kërkuesi ka të drejtë në rikthimin e së drejtës si posedues i së drejtës në pronë, Komisioni autorizon rikthimin në natyrë, përveç nëse posedimi mbi pronën është marrë nga personi juridik përmes kontratës së vlefshme të bërë vullnetarisht për një vlerë të caktuar, para datës së hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50.

Neni 3

Gjuhët

3.1 Gjuhët që mund të fliten në Agjencinë Kosovare të Pronës në të gjitha procedurat e parashtruara sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 janë gjuha shqipe, serbe dhe angleze.

3.2 Çdo person që merr pjesë në procedurë para Komisionit dhe në procedurë ankimore para Gjykatës Supreme, i cili nuk e flet gjuhën e procedurës ka të drejtë të flet gjuhën e vet dhe të drejtën që të informohet përmes përkthimit pa pagesë lidhur me dëshminë, me faktet dhe me procedurën.

3.3 Në rastet kur ndodh kundërtënia apo mospërputhja lidhur me ndonjë fjalë, frazë apo interpretim mes versionit anglez të dokumentit apo të vendimit dhe të versionit në shqip apo serbisht, fjala, fraza apo interpretimi në versionin e gjuhës angleze do të mbizotërojë dhe do të zbatohet.

Neni 4 Presioni

4.1 Çfarëdo kontrate që ka për qëllim dhënien e të drejtave pronësore në pronën e paluajtshme private, e cila arrihet nën presion, mund të shpallet e pavlefshme nga Komisioni, së bashku me çfarëdo shitjeje apo shitjesh pasuese të pronës.

4.2 Presioni është i pranishëm në rastet kur shitësi në kohën e nënshkrimit të kontratës:

(a) Ka qenë apo është i nënshtruar ndaj dhunës, frikësimit ose kërcënimit për lëndim fizik apo

(b) Në bazë të fjalëve apo të sjelljeve të drejtuara personalisht kah ai nga cildo person, ka bazë të arsyeshme të frikës për dhunë ose lëndim fizik të pashmangshëm ndaj tij apo ndaj anëtarëve të familjes së tij.

4.3 Presioni supozohet, derisa të dëshmohet vlefshmëria e kontratës, ku vlera e tregut e pronës në kohën e shitjes nuk ka marrëdhënie të arsyeshme me çmimin e paguar aktual të shitjes.

4.4 Vendimi në bazë të nenit 2.1, që e shpall kontratën e pavlefshme skadon në mënyrë të përhershme, nëse shitësi nuk e paguan çmimin e blerjes në tërësi brenda 30 ditësh nga pranimi i njoftimit për vendim, së bashku me kamatën e duhur sipas shkallës së paraparë për Sekretarinë ekzekutive, në cilësinë e agjentit për blerësin.

Neni 5 Përfaqësimi para Komisionit për kërkesa pronësore dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës

5.1 Në procedurat para Komisionit dhe para Gjykatës Supreme të Kosovës, paditësit dhe të paditurit përfaqësohen nga anëtari i një shoqate të avokatëve në Kosovë, në Republikën e Serbisë apo në Republikën e Malit të Zi, përveç në rastin e personave juridikë që mund ta përfaqësojnë vetveten.

5.2 Në procedurat para Komisionit, kur personi juridik nuk mund të bëjë kërkesën, e njëjta mund të bëhet nga anëtari i familjes së atij personi. Paditësi mund të përfaqësohet nga personi i autorizuar juridik me autorizim të vlefshëm dhe të zbatuar në mënyrë të duhur. Në rastet e veçanta, ku dhënia e autorizimit është problematike, Sekretaria ekzekutive mund të certifikojë një dokument tjetër, përmes të cilit autorizohet përfaqësimi i paditësit.

5.3 Avokati që vepron në emër të palës duhet t'ia dorëzoj Sekretarisë ekzekutive apo Zyrës së regjistrimit të Gjykatës Supreme një kopje të autorizimit, e cila ia jep autorizimin për përfaqësim të asaj pale në procedurën para Komisionit apo para Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme mund të kërkojë që ai autorizim të certifikohet.

5.4 Lidhur me ankesat e dërguara në Gjykatën Supreme të Kosovës, sipas diskrecionit të kryetarit të trupit gjykues, pala po ashtu mund të përfaqësohet nga shoqata e huaj e avokatëve, e cila ka kompetenca dhe përvojë të nevojshme.

Neni 6 Shërbimet rreth dokumenteve

6.1 Adresa për dorëzimin e dokumenteve për palën është adresa e shtëpisë apo, nëse pala përfaqësohet nga avokati, atëherë adresa për dërgimin e dokumenteve është adresa e avokatit. Paditësi e cakton adresën për dërgimin e dokumentacionit lidhur me kërkesën, ndërsa i padituri cek adresën për dërgimin e dokumentacionit të mbrojtjes.

6.2 Pala mund të pajtohet që dërgimi i dokumenteve avokatit të saj të bëhet me telefaks apo me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit. Në atë rast, pala ia dorëzon Gjykatës Supreme të gjitha informatat e nevojshme për kryerjen e shërbimit përmes telefaksit apo ndonjë mjeti tjetër të komunikimit.

6.3 Në rastet kur sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 kërkohet që Gjykata Supreme t'ia dërgoj dokumentin palës, Gjykata Supreme ia dërgon dokumentin Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Prorës. Sekretaria ekzekutive sigurohet që dërgesa të bëhet në adresën për kryerjen e dërgesave të asaj pale, qoftë duke e dërguar kopjen e dokumentit përmes postës zyrtare, e cila jep vërtetimin, apo përmes dorëzimit personal të kopjes, për të cilin po ashtu merret vërtetimi për dorëzimin e dokumentit.

6.4 Në rastet kur pala është pajtuar, në përputhje me nenin 6.2, që dërgesa mund të bëhet me telefaks apo me ndonjë mjet tjetër elektronik të komunikimit, çdo dokument procedural, përveç aktgjykimit të Gjykatës Supreme, do të dërgohet përmes dërgimit të kopjes së dokumentit me mjete të tilla. Në rastet kur për arsye teknike ose për shkak të natyrës a gjatësisë së dokumentit, dërgesa e tillë është e pamundshme apo jopraktike, dokumenti i dërgohet palës në përputhje me procedurën e paraparë në nenin 6.3. Pala njoftohet për këtë përmes telefaksit apo përmes ndonjë mjeti tjetër të komunikimit.

6.5 Shërbimi konsiderohet se është kryer:

(a) Në rastin e dërgimit të kopjes së dokumentit nga shërbimi postar i regjistruar, në datën kur pala pranuese e vërteton pranimin apo, nëse pala pranuese ka refuzuar pranimin e dokumentit ose nënshkrimin e vërtetimit për pranim, në ditën e pestë pas dërgimit të letrës së regjistruar në postë që gjendet në vendin e Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Prorës.

(b) Në rast të dërgimit personal të dokumentit në pajtim me nenin 6.3, në ditën kur pala pranuese ka vërtetuar pranimin ose, nëse pala pranuese ka refuzuar pranimin e dokumentit apo nënshkrimin e vërtetimit për pranim, në ditën kur shërbimi është tentuar të kryhet. Personi që e dorëzon dokumentin e shënon se dokumenti nuk është pranuar dhe kthehet në Sekretarinë ekzekutive.

(c) Në rast të dërgimit të dokumentit përmes telefaksit apo ndonjë mjeti tjetër elektronik të komunikimit në pajtim me nenin 6.2, në ditën kur dërgesa është kryer dhe dokumentuar me sukses ose, nëse pamundësia për kryerjen e suksesshme të dërgesës në fjalë ka rezultuar si pasojë e gabimit të qëllimshëm të pranuesit, në ditën kur është tentuar kryerja e dërgesës.

Neni 7

Llogaritja e periudhave

7.1 Periudha kohore e paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50 apo në këtë Urdhëresë administrative llogaritet si në vijim:

(a) Në rastet kur periudha e shprehur në ditë, javë apo në muaj duhet të llogaritet nga momenti i ndodhjes së ngjarjes, dita kur ndodh ajo ngjarje ose veprim nuk llogaritet brenda periudhës në fjalë;

(b) Periudhat e shprehura në ditë, javë apo në muaj do të thonë periudha të shprehura në ditë javë apo në muaj kalendarikë;

(c) Në rastet kur periudha është e shprehur në ditë, javë apo në muaj, së pari llogaritet në muaj të tërë e pastaj në ditë;

(d) Periudhat përfshijnë të shtunat, të dielat dhe festat zyrtare.

7.2 Nëse fundi i periudhës bie të shtunën, të dielën apo në ditën zyrtare të festës, periudha në fjalë zgjatet deri në fund të ditës së parë pasuese të punës.

7.3 Nëse është në interes të drejtësisë, Komisioni i Agjencisë Kosovare të Prokurorisë apo Gjykata Supreme mund të zgjasin çfarëdo periudhe kohore, duke marrë parasysh përgjegjësinë për trajtimin e çështjes në mënyrë të shpejtë dhe me kusht që nuk ka qenë arsyeshmërisht praktike për palën ose Komisionin apo për Gjykatën Supreme që zgjidhja e çështjes në fjalë të bëhet brenda periudhës kohore të paraparë me ligj.

7.4 Nëse pala nuk e plotëson cilëndo kërkesë për ndërmarrjen e veprimit brenda periudhës së paraparë në pajtim me nenin 12 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 apo me këtë Urdhëresë administrative, kryesuesi i Komisionit apo kryetari i trupit gjykues për rastin e ankesës mund t'ia lejojnë palës që të plotësojë atë kërkesë jashtë periudhës së paraparë kohore, nëse ai konsideron se ekzistojnë arsye të justifikueshme për atë mosplotësim të kërkesës, dhe nëse konsideron se asnjë palë tjetër nuk do të përjetojë paragjykim serioz dhe të pariparueshëm nëse pala që nuk e ka plotësuar kërkesën lejohet që të njëjtën ta plotësojë jashtë periudhës së lejuar kohore.

7.5 Parashtrimi i kërkesës për lejim të zgjatjes së periudhës kohore sipas nenit 7.3 bëhet sa më shpejt që praktikisht të jetë e mundshme, por gjithsesi para kalimit të afatit të paraparë kohor. Gjatë përpunimit të kërkesës, përmes Sekretarisë së Agjencisë Kosovare të Pronës, pala:

- (a) E njofton palën ose palët e tjera për kërkesën dhe
- (b) Zbaton çfarëdo aktiviteti të nevojshëm për plotësimin e kërkesave të parashtruara në fillim.

Neni 8

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave

Kërkesa e cekur në nenin 3.1(a) apo (b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 duhet t'i dorëzohet Sekretarisë ekzekutive para kalimit të gjashtë muajve nga data e shpalljes së kësaj Urdhërese administrative. Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave mund të zgjatet përmes njoftimit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, i cili mund të:

- (a) Refuzojë zgjatjen e afatit për një kategori të kërkesave dhe
- (b) Jepë afate të ndryshme për kategori të ndryshme të kërkesave.

KAPITULLI II

Përgjegjësitë e Këshillit mbikëqyrës

Neni 9

Përgjegjësia e mbikëqyrjes dhe rregullat procedurale

Këshilli mbikëqyrës ka përgjegjësi mbikëqyrëse për të gjitha çështjet lidhur me funksionimin e Agjencisë Kosovare të Pronës, duke përfshirë buxhetin e saj vjetor, zbatimin e mandatit të saj, hartimin e nismave dhe përcaktimeve të politikave, si dhe kërkesat dhe organizimet administrative, operacionale dhe të financimit. Rregullorja e punës që vlen për Këshillin mbikëqyrës është paraqitur në shtojcën I të kësaj Urdhërese administrative.

KAPITULLI III

Drejtori dhe punonjësit e Sekretarisë ekzekutive

Neni 10

Rregullat dhe përgjegjësitë e përgjithshme

10.1 Drejtori është shef i administratës i Sekretarisë ekzekutive.

10.2 Drejtori vepron në mënyrë të pavarur në ushtrimin e kompetencave të parapara sipas postit siç parashihet përmes Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, përmes kësaj Urdhërese administrative dhe përmes vendimeve të Këshillit mbikëqyrës.

10.3 Drejtori i raporton Këshillit mbikëqyrës dhe vepron nën autorizimet, si dhe udhëzimet e përgjithshme të tij lidhur me të gjitha çështjet e Agjencisë Kosovare të Pronës. Drejtori i raporton dhe i jep llogari vetëm Komisionit përkitazi me çështjet që hyjnë në kuadër të kompetencave të Komisionit.

10.4 Drejtori emëron dhe shkarkon punonjësit e Sekretarisë ekzekutive në përputhje me ligjin në fuqi në Kosovë. Punonjësit e Sekretarisë ekzekutive vijnë nga komunitetet e ndryshme në Kosovë.

10.5 Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet anëtar i Sekretarisë ekzekutive nëse ai ka zënë pronën pa marrëveshje me shkrim apo pa pëlqimin e pronarit të ligjshëm të së drejtës në pronë. Në rastet kur anëtari e ka zënë pronën, për të cilën është parashtruar kërkesa sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ai person ia deklaron këtë fakt me shkrim drejtorit të Sekretarisë ekzekutive.

10.6 Gjatë kryerjes së përgjegjësiave të tyre, të gjithë punonjësit i përgjigjen vetëm Komisionit të Sekretarisë ekzekutive sipas nevojës, dhe nuk i japin përgjegjësi asnjë pale ose entiteti tjetër. Ata nuk marrin udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të tyre nga asnjë autoritet përveç Komisionit apo Sekretarisë ekzekutive.

10.7 Të gjithë punonjësit e ruajnë konfidencialitetin e informatës së marrë gjatë kryerjes së detyrave për Sekretarinë ekzekutive si gjatë periudhës, ashtu edhe pas periudhës së punësimit, dhe ata e bëjnë deklaratën vijuese me shkrim:

“Deklaroj solemnisht se do t’i kryej detyrat e mia besnikërisht, në mënyrë të paanshme dhe me ndërgjegje, si dhe me respekt të plotë ndaj obligimit të konfidencialitetit”

10.8 Asnjë punonjës i Sekretarisë ekzekutive, këshilltar apo ekspert i angazhuar për kryerjen e shërbimeve për Sekretarinë ekzekutive nuk do të merr pjesë në përpunimin e kërkesë, ose në çfarëdo procedure lidhur me kërkesën ku ai ka interes personal apo kur ai është konsultuar nga pala në proce, ose kur ai është i lidhur në çfarëdo procedure tjetër gjyqësore për atë kërkesë përveç procedurës që zhvillohet para Sekretarisë ekzekutive dhe Komisionit, apo nëse ekzistojnë çfarëdo rrethanash të tjera që mund të ndikojnë në paanësinë e tij. Në rast të çfarëdo dyshimi lidhur me këtë rregull, punonjësi ia deklaron këtë fakt me shkrim drejtorit të Sekretarisë ekzekutive përmes mbikëqyrësit të tij hierarkik në Sekretarinë ekzekutive, dhe drejtori përcakton nëse paanësia e tij do të mund të ndikohej, si dhe vendos mbi çështjen ashtu si ai e sheh të nevojshme.

10.9 Të gjithë punonjësve u ndalohet marrja e përfitimeve nga cilado palë ose entitet përveç Sekretarisë ekzekutive lidhur me çfarëdo veprimi apo lëshimi të Agjencisë Kosovare të Pronave pa paragjykim ndaj nenit 10.10.

10.10 Pas miratimit të drejtorit ekzekutiv, punonjësit nga institucionet ose entitetet e tjera mund të emërohen që përkohësisht të punojnë në Sekretarinë ekzekutive. Në

raste të tilla, paga dhe kushtet e tjera të punës varen nga kontrata e tyre me entitetin ku janë të emëruar që përkohësisht të punojnë.

KAPITULLI IV

Detyrat, përgjegjësitë dhe rregullat e

Sekretarisë ekzekutive lidhur me kërkesat pronësore

Neni 11

Pranimi dhe regjistrimi i kërkesave pronësore

Sekretaria ekzekutive pranon dhe regjistron kërkesat pronësore të cekura në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 në përputhje me nenin 9 dhe 10 të Rregullores. Detyrat, përgjegjësitë dhe rregullat e Sekretarisë ekzekutive lidhur me kërkesat pronësore janë të përcaktuara në shtojcën II të kësaj Urdhërese administrative.

KAPITULLI V

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për kërkesa pronësore

Neni 12

Detyrat, përgjegjësitë dhe rregullat në fuqi

Detyrat, përgjegjësitë dhe rregullorja e punës e Komisionit për kërkesa pronësore lidhur me marrjen e vendimit mbi kërkesat pronësore janë të parapara në shtojcën III të kësaj Urdhërese administrative.

KAPITULLI VI

Ankesat drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës

Neni 13

Ligjet në fuqi

Gjatë interpretimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 dhe të kësaj Urdhërese administrative, Gjykata Supreme e Kosovës mund t'i merr parasysh, me modifikime ose kualifikime të tilla që i konsideron të nevojshme apo të duhura në rrethanat e caktuara, dispozitat e ligjeve në fuqi mbi kompetencat e Gjykatës Supreme lidhur me procedurat civile, duke përfshirë përshtatshmërisht dispozitat e Urdhëresës

administrative nr. 2003/13 të datës 11 qershor 2003 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/13 mbi themelimin e Odës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit.

Neni 14

Zyra e regjistrimit

14.1 Gjykata Supreme ka Zyrën e vet të regjistrimit për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (Zyra e regjistrimit) që regjistron ankesat e parashtruara në pajtim me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50.

14.2 Të gjitha ankesat, përgjigjet dhe dokumentet përcjellëse do të shënohen sipas renditjes kur janë parashtruar. Çdo informatë e re shënohet në regjistër që mbahet për këtë qëllim dhe që ruhet në Zyrën e regjistrimit.

14.3 Çdo person që mund të demonstrojë interes legjitim në çështjen e caktuar mund të shikojë regjistrin në Zyrën e regjistrimit dhe mund të merr kopje apo ekstrakte të regjistrit, përveç kur kemi të bëjmë me informata që i nënshtrohen urdhrit për konfidencialitet të dhënë nga Gjykata Supreme, pas pagesës së një takse sipas shkallës së caktuar nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës.

Neni 15

Kryetari i trupit gjykues

Me rastin e parashtrimit të një ankese në Gjykatën Supreme dhe të themelimit të trupit gjykues në pajtim me nenin 12.9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, Kryetari i Gjykatës Supreme menjëherë e cakton njërin prej gjykatësve ndërkombëtar që të jetë si kryetar i trupit gjykues në kolegjin për ankese.

Neni 16

Procedura

Procedura pranë Gjykatës Supreme për fshin procedurën me shkrim dhe, kur parashihet në bazë të interesave të drejtësisë, mund të mbahet edhe seancë gjyqësore me gojë.

Neni 17

Parashtresat e tjera me shkrim

17.1 Në përputhje me nenin 12.10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 pas marrjes së përgjigjes ndaj një ankese, Gjykata Supreme mund të kërkojë që palët të bëjnë parashtresa të tjera me shkrim.

17.2 Gjykata Supreme mund t'i udhëzojë palët për karakterin e parashtresave të tjera me shkrim që kërkohen dhe mund të saktësojë datën për dorëzimin e parashtresave të tjera me shkrim.

17.3 Gjykata Supreme ia dorëzon kërkesën e saj për parashtrës të tjera me shkrim Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës, e cila do t'ia dorëzojë kërkesën palëve.

17.4 Palët i dorëzojnë parashtrësat e tjera me shkrim përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

Neni 18

Rivlerësimi i qartësimit të mëtejme nga Komisioni

Në përputhje me nenin 12.9 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, Gjykata Supreme mund të kërkojë rivlerësimin apo qartësimin e vendimit ndaj të cilit është parashtruar ankesa nga Komisioni. Gjykata Supreme mund të kërkojë që Komisioni:

- (a) Të merr dëshmi të tjera të dokumentuara;
- (b) Të mbajë një seancë dëgjimore me gojë;
- (c) Të merr dëshmi prej palëve apo dëshmitarëve, duke përfshirë dëshmitarët në cilësi të ekspertit ose
- (d) Të bëjë çfarëdo rivlerësimi ose qartësimi tjetër që është i nevojshëm për t'i ndihmuar Gjykatës Supreme për marrjen e vendimit rreth ankesës.

Neni 19

Seancat dëgjimore me gojë

19.1 Në bazë të nenit 12.10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, Gjykata Supreme mund të mbajë një seancë dëgjimore me gojë.

19.2 Gjykata Supreme mund të mbajë seancë dëgjimore me gojë për ndonjë çështje specifike të kontestuar lidhur me faktet dhe dëshmitë e dhëna para Komisionit me rastin e shqyrtimit të kërkesës pronësore.

Neni 20

Dëshmitë

20.1 Me qëllim të përcaktimit të duhur të fakteve, Gjykata Supreme mund që me vetiniciativë t'i administrojë dëshmitë nga dokumenti apo nga seanca dëgjimore e palës ose e dëshmitarit, duke përfshirë dëshmitarin në cilësi të ekspertit.

20.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, Gjykata Supreme mund të administrojë çdo dëshmi tjetër, e cila është e nevojshme për përfundimin e shpejtë të procedurës, duke përfshirë, mes të tjerash, inspektimin e vendit apo të objektit.

Neni 21
Aktgjykimi

21.1 Vendimi i Gjykatës Supreme lidhur me vendimin për ankesë paraqitet në aktgjykim. Gjykata Supreme e bazon aktgjykimin në bazë të analizës së fakteve të paraqitura gjatë procedurës dhe në bazë të ligjit në fuqi.

21.2 Çdo lehtësim i dhënë nga Gjykata Supreme nuk mund të jetë më i madh se lehtësimi i kërkuar nga ankuesi.

21.3 Nëse i padituri e pranon ankesën në formë të shkruar, Gjykata Supreme e bën aktgjykimin në dobi të palës ankuese.

21.4 Origjinali i aktgjykimit i nënshkruar nga kryetari i trupit gjykues dhe nga Zyra e regjistrimit, vulozet dhe arkivohet në Zyrën e regjistrimit. Secilës palë i jepet kopja e aktgjykimit brenda 30 ditësh nga arritja e tij.

21.5 Aktgjykimi i dorëzohet palëve në anglisht, shqip dhe serbisht dhe, ku parashihet, edhe në gjuhën apo gjuhët e tjera që fliten nga palët.

21.6 Aktgjykimi është obligues nga dita e dorëzimit të tij palëve, dhe është i zbatueshëm si aktgjykim i formës së prerë i Gjykatës Supreme të Kosovës në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi.

KAPITULLI VII

Mjetet ligjore

Neni 22
Përmbartimi i urdhrave të dëbimit

22.1 Urdhri i dëbimit i lëshuar nga Komisioni nuk përmbartohet nga Sekretaria ekzekutive deri në skadimin e periudhës kohore të specifikuar në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 për parashtrimin e ankesës ndaj vendimit të Komisionit.

22.2 Urdhri i dëbimit i lëshuar në pajtim me nenin 23.3 nënshkruhet nga drejtori i Sekretarisë ekzekutive.

22.3 Sekretaria ekzekutive, në bashkërendim me kryesuesin e Komisionit apo me kryetarin e trupit gjykues të Gjykatës Supreme, mund të shtyjë përmbartimin e urdhrit të dëbimit për një periudhë të arsyeshme kohore, kur mendon se rrethanat e parashohin këtë. Sekretaria ekzekutive i informon palët e përfshira në rastin e kërkesës pronësore për arsyet e vonës.

22.4 Sekretaria ekzekutive nuk mban përgjegjësi për çfarëdo dëmtimi apo humbje të pronës së luajtshme të lëvizur gjatë dëbimit dhe për çfarëdo humbje materiale ose financiare a humbjeje tjetër.

Neni 23

Prona nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës

23.1 Sekretaria ekzekutive është e autorizuar që të administrojë pronën nën autoritetin e Agjencisë Kosovare të Pronës në cilëndo prej rrethanave vijuese:

- (a) Përmes marrëveshjes së palëve të përfshira në procesin e zgjidhjes së kërkesës pronësore të parashtruar në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50;
- (b) Me kërkesë të paditësit, pas arritjes së vendimit të formës së prerë që vërteton të drejtën pronësore të paditësit ;
- (c) Në rastet kur nuk është parashtruar kërkesa për administrimin e pronës, pas zbatimit të vendimit të Komisionit dhe pas dëbimit të banorit aktual, nëse bartësi i së drejtës në pronë nuk e rimerr pronën pas njoftimit të tij për përmbarrimin e dëbimit.

23.2 Sekretaria ekzekutive mund ta lëshojë me qira pronën nën administrimin e saj, varësisht prej atyre kushteve dhe afateve që i konsideron si të përshtatshme.

23.3 Bartësi i së drejtës në pronë për pronën nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës, në çdo moment mund t'a njoftojë Sekretarinë ekzekutive lidhur me qëllimin e tij për marrjen në posedim të pronës. Pas asaj kërkesë, Sekretaria ekzekutive do të dorëzojë urdhrin për dëbim, ku kërkon nga banori aktual që ta lirojë pronën brenda 90 ditësh nga dorëzimi i urdhrit, dhe në rast të pronës së dhënë me qira, dërgon njoftimin për përfundimin e qiradhënies, duke e udhëzuar qiramarrësin që të lirojë pronën pas përfundimit të marrëveshjes për qiradhënie. Nëse banori apo qiramarrësi aktual nuk e lirojnë pronën vullnetarisht, Sekretaria ekzekutive do ta lëshojë urdhrin, përmes të cilit autorizon përmbarrimin e urdhrit të dëbimit dhe, në raste të tilla, dispozitat e nenit 16 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50 zbatohen përshtatshmërisht. Administrimi i pronës nga Agjencia kadastrale e pronës mbaron pas rimarrjes ligjore të pronës nga ana e bartësit të së drejtës në pronë.

23.4 Sekretaria ekzekutive bën përpjekje të arsyeshme për të minimizuar rrezikun e dëmtimit të çfarëdo prone nën administrimin e saj. Sekretaria ekzekutive nuk mban përgjegjësi për çfarëdo dëmtimi të pronës nën administrimin e saj ose për humbjen a dëmtimin e saj, qoftë ajo materiale apo financiare ose humbje tjetër.

KAPITULLI VIII

Dispozitat përfundimtare

Neni 24

Përgjegjësia

Punonjësit e Sekretarisë ekzekutive, punonjësit dhe anëtarët e Komisionit dhe anëtarët e Këshillit mbikëqyrës nuk janë përgjegjës ndaj asnjë pale, përveç ndaj Agjencisë Kosovare të Pronës, lidhur me çfarëdo veprimi apo lëshimi në emër të Agjencisë Kosovare të Pronës brenda fushëveprimit të Rregullores nr. 2006/50 apo të kësaj Urdhërese administrative. Punonjësit e Sekretarisë ekzekutive, punonjësit dhe anëtarët e Komisionit dhe Këshilli mbikëqyrës janë përgjegjës ndaj Agjencisë Kosovare të Pronës për çfarëdo neglizhence në detyrë në përputhje me kontratat e tyre me Agjencinë.

Neni 25 Ligji në fuqi

Në rastet e parashtrimit të disa kërkesave pronësore, ku disa prej tyre hyjnë brenda kompetencave të Agjencisë Kosovare të Pronës, ndërsa të tjerat brenda kompetencave të gjykatave apo organeve të tjera administrative a tribunaleve, kërkesa ve pronësore brenda kompetencave të Agjencisë Kosovare të Pronave do t'u jepet prioritet dhe do të trajtohen të parat.

Neni 26 Hyrja në fuqi

Kjo Urdhëresë administrative hyn në fuqi më 1 qershor 2007.

Joachim Rüecker

Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

ANEKSI I

Rregullat e procedurës dhe parimet e përgjithshme të Bordit mbikëqyrës

Neni 1

Rregullat e zbatueshme dhe parimet e përgjithshme

- 1.1 Drejtori i Sekretariatit ekzekutiv përfaqëson Sekretariatin ekzekutiv përpara Bordit mbikëqyrës.
- 1.2 Kryetari në konsultim me anëtarët e tjerë të Bordit mbikëqyrës cakton një ose më shumë persona për të marrë pjesë *ad hoc* në punën e Bordit.
- 1.3 Secili anëtar i Bordit mbikëqyrës cakton nga një person që të shërbejë në Bord në mungesë të tij. Në mungesë të kryetarit, takimin e Bordit e kryeson personi i caktuar nga kryetari i Bordit.
- 1.4 Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me dispozitat e nenit 5 të Rregullores së UNMIK -ut Nr. 2006/50. Anëtarët nuk do të marrin asnjë udhëzim lidhur me ushtrimin e detyrave të tyre, përveç udhëzimeve që parashihen sipas ligjit në fuqi.
- 1.5 Asnjë person nuk mund të bëhet ose të qëndrojë si anëtar i Bordit nëse ai në mënyrë të vazhdueshme ka okupuar një pronë pa patur një marrëveshje me shkrim ose një pëlqim nga mbajtësi i ligjshëm i të drejtës mbi pronën ose që nuk është në përputhje me ligjin në fuqi. Në rastet kur një anëtar i Bordit ka okupuar një pronë, e cila është objekt i një kërkesë pronësore sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, ai duhet t’ia paraqes këtë fakt me shkrim Bordit mbikëqyrës përmes kryetarit të Bordit.
- 1.6 Asnjë anëtar nuk do të merr kompensim nga Agjencia Kosovare e Pronës.

Neni 2

Roli i Sekretariatit ekzekutiv

Sekretariati ekzekutiv siguron shërbime përkrahëse për Bordin mbikëqyrës. Përgjegjësitë e Sekretariatit ekzekutiv përfshijnë organizimin e takimeve të Bordit, përgatitjen e agjendave dhe procesverbaleve të këtyre takimeve, shpërndarjen e materialeve dhe informatave relevante, si dhe monitorimin e veprimeve pasuese lidhur me vendimet të cilat janë marrë ose këshillat që janë dhënë nga Bordi mbikëqyrës.

Neni 3 Takimet

3.1 Takimet e Bordit mbikëqyrës caktohen çdo tre muaj. Kryetari në konsultim me anëtarët e tjerë të Bordit mbikëqyrës mund të caktojë takime më të shpeshta të këtij Bordi.

3.2 Kryetari miraton draftin e agjendës për secilin takim të Bordit mbikëqyrës.

3.3 Lajmërimi për takim të Bordit mbikëqyrës u dërgohet anëtarëve të Bordit jo më vonë se dy javë para çdo takimi, përveç rasteve kur rrethanat kërkojnë që lajmërimi të bëhet në një afat më të shkurtër kohor. Agjenda dhe çfarëdo dokumenti dhe informacioni përkatës i bashkëngjiten lajmërimit.

3.4 Procesverbalet nga secili takim përgatiten dhe shpërndahen para mbajtjes së takimit, me qëllim të shqyrtimit nga ana e anëtarëve të Bordit mbikëqyrës.

3.5 Anëtarët e Bordit mbikëqyrës mund të shoqërohen nga asistentët ose ndihmësit e tyre, të zgjedhur nga vetë anëtarët.

Neni 4 Vendimet dhe votimi

4.1 Bordi mbikëqyrës ka kuorum nëse së paku tre anëtarë me të drejtë vote janë të pranishëm në takim.

4.2 Vendimet e Bordit mbikëqyrës merren me konsensus. Në rast të mosarritjes së konsensusit, vendimi merret me anë të votimit. Nëse nuk është caktuar ndryshe në këtë Udhëzim administrativ, vendimet merren me shumicë të thjeshtë nga anëtarët e pranishëm. Në rast të marrjes së vendimit me shumicë të kualifikuar, nevojiten së paku tri vota pohuese.

4.3 Secili nga anëtarët e Bordit mbikëqyrës ka nga një votë. Në rast të barazimit të votave, votën vendimtare e ka kryetari i Bordit.

SHTOJCA II

Detyrat, përgjegjësitë dhe rregullat e Sekretariatit ekzekutiv në lidhje me kërkesat

Neni 1

Grumbullimi dhe regjistrimi i kërkesave

1.1 Në kryerjen e funksioneve të tij në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 dhe kësaj Urdhërese administrative, drejtori i Sekretariatit ekzekutiv mund të:

(a) Bëj marrëveshje dhe të bashkëpunojë me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Beograd dhe me Zyrën ndërlidhëse të UNMIK-ut në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (me tej në tekst “IRJM”) për të siguruar dhe mundësuar grumbullimin e kërkesave në IRJM, Mal të Zi dhe Serbi dhe

(b) Bëj marrëveshje *ad hoc* dhe të bashkëpunojë me organizatat qeveritare, ndërqeveritare dhe joqeveritare për të siguruar dhe mundësuar grumbullimin e kërkesave nga territori jashtë Kosovës.

1.2 Në rastet e personave fizikë, kur ai nuk është në gjendje që të paraqesë kërkesën, kërkesa mund të bëhet nga një anëtar i familjes së atij personi.

Neni 2

Përmbajtja e kërkesës

2.1 Kërkesa bëhet në një formular të veçantë i cili përcaktohet nga Sekretariati ekzekutiv, të nënshkruar nga parashtruesi i kërkesës ose ndonjë person i autorizuar në prani të një zyrtari përgjegjës të Sekretariatit ekzekutiv (me tej në tekst “formulari i kërkesës”). Formulari i kërkesës duhet të përfshijë:

- (a) Emrin e parashtruesit të kërkesës;
- (b) Një adresë për dërgimin e dokumenteve;
- (c) Faktet mbi të cilat bazohet parashtruesi i kërkesës dhe natyra, përmasa dhe baza për kërkesën dhe
- (d) Ndihma që kërkohet.

2.2 Parashtruesi i kërkesës bashkë me formularin e kërkesës iparaqet edhe origjinalin ose kopjet e vërtetuara të çdo dokumenti të rëndësishëm për

kërkesën ose mbi të cilët ai synon të përgjigjet në mbështetje të kërkesës dhe të cilat janë në posedimin e tij, ose ka mundësi të arsyeshme t'i sigurojë. Sekretariati ekzekutiv nuk i mban dokumentet origjinale. Me rastin e pranimit të dokumenteve origjinale, ai e bën nga një kopje të tyre, i vërteton ato dhe ia kthen origjinalet parashtruesit të kërkesës bashkë me një kopje të vërtetuar të formularit të kërkesës. Sekretariati ekzekutiv është i autorizuar të vërtetojë kopjet.

Neni 3

Të drejtat e palëve për kërkesë

3.1 Çdo person tjetër përveç parashtruesit të kërkesës, i cili është duke e ushtruar ose synon të ketë të drejta mbi pronën e cila është objekt i kërkesës dhe /ose ndonjë person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronën e kërkuar do të jetë palë e paditur në seanca dhe mund të përgjigjet në një kërkesë dhe të bëjë parashtrime të tilla me shkrim dhe të paraqes dëshmi në lidhje me kërkesën, në përputhje me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 dhe dispozitave të këtij Udhëzimi administrativ.

3.2 Njoftimi me qëllimin për të marrë pjesë në seancat e përmendura në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, bëhet me shkrim dhe përfshin:

- (a) Emrin e palës së paditur dhe
- (b) Një adresë për dërgimin e dokumenteve.

3.3 Përgjigjja në kërkesën e përmendur në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 bëhet me shkrim në formën e përcaktuar nga sekretariati ekzekutiv të nënshkruar nga pala e akuzuar ose një person fizik i autorizuar në prani të zyrtarit përgjegjës të Sekretariatit ekzekutiv (më tej në tekst "përgjigjja në kërkesë") dhe përfshin:

- (a) Faktet dhe bazat mbi të cilat i akuzuari e bazon kundërshtimin ose kontestimin e kërkesës dhe
- (b) Natyrën e çdo të drejte mbi pronën të cilën i akuzuari pretendon se e ka mbi pronën e kërkuar.

3.4 I akuzuari parashtron origjinalet ose kopjet e çdo dokumenti të rëndësishëm për kërkesën mbi të cilin ai synon të mbështesë kërkesën dhe të cilat janë në posedimin e tij, ose ka mundësi të arsyeshme t'i sigurojë. Sekretariati ekzekutiv nuk i mban dokumentet origjinale. Me rastin e pranimit të dokumenteve origjinale, ai e bën nga një kopje të tyre, i vërteton ato dhe ia kthen origjinalet parashtruesit të kërkesës bashkë me një kopje të vërtetuar të

formularit të kërkesës. Sekretariati ekzekutiv është i autorizuar të vërtetojë kopjet.

3.5 Sekretariati ekzekutiv ua jep një kopje të përgjigjes në kërkesë palëve të tjera në procedurë.

3.6 Kopja e kërkesës dhe një kopje e përgjigjes në kërkesë e përmendur në nenet 10.1 respektivisht 10.4 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50 nuk do të zbulojnë detajet përkatëse të kontaktit të parashtruesit të kërkesës ose të akuzuarit, dhe Sekretariati ekzekutiv mund të refuzojë zbulimin e ndonjë informacioni që i është parashtruar atij nga i akuzuari ose ndonjë palë tjetër e interesuar, përfshirë edhe identitetin e ndonjë pale ose dëshmitari, kur ai e konsideron këtë të nevojshme për sigurinë e ndonjë personi. .

3.7 Formulari i kërkesës dhe përgjigjja në kërkesë mund të parashtrohet në gjuhën shqipe, angleze ose serbe.

3.8 Në interes të zgjidhjes efikase dhe të drejtë të kërkesave, Komisioni, në raste të veçanta, mund të vazhdojë afatin kohor ose heq ndonjë rregull procedurale në Rregulloren e UNMIK -ut nr. 2006/50 ose në këtë Udhëzim administrativ, kur ekzistojnë arsye të forta për ta bërë një gjë të tillë dhe kjo nuk do të paragjykojë në mënyrë substanciale të drejtën e ndonjë palë. Sekretariati ekzekutiv i njofton me kohë palët për një vendim të tillë. Megjithatë, nëse ndonjëra nga palët pa ndonjë arsyetim të fortë nuk merr pjesë në seanca ose nuk respekton ndonjë rregull, atëherë kjo do të vonojë zgjidhjen e kërkesës.

3.9 Parashtruesi i kërkesës ose i akuzuari mund t'i parashtrojë shkresa të tjera plotësuese ose dëshmi të rëndësishme për kërkesën Sekretariatit ekzekutiv në çdo moment gjatë seancës, me kusht që Komisioni të mos ketë bërë gjykimin përfundimtar për kërkesën.

Neni 4 Zgjidhja e kërkesave

4.1 Sekretariati ekzekutiv do të informojë palët për të drejtat dhe obligimet e tyre sipas Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50 dhe këtij Udhëzimi administrativ, dhe mund të marrë çfarëdo hapash që i konsideron të nevojshëm për të mundësuar zgjidhjen ose për të ndihmuar palët të zgjidhin kërkesat.

4.2 Sekretariati ekzekutiv mund të hetojë ndonjë kërkesë dhe të marrë dëshmi të tjera të rëndësishme për kërkesën nga çdo shënim që mbahet nga ndonjë organ publik, korporatë ose person fizik. Sekretariati ekzekutiv do të ketë të drejtën të ketë qasje të pakufizuar dhe të lirë pa pagesë në të gjitha

shënimet në Kosovë të cilat janë të rëndësishme për zgjidhjen e kërkesës ose për ndonjë qëllim tjetër të verifikimit.

4.3 Në bazë të autoritetit të tij sipas nenit 6.2 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50, Sekretariati ekzekutiv, përmes një vendimi me shkrim, mund të hedhë poshtë një kërkesë e cila qartazi nuk mund të paguhet dhe qartazi nuk është nën fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronës. Kërkesa mund të hidhet poshtë në çdo fazë të procedurës deri kur ajo t'i dërgohet Komisionit për gjykim.

4.4 Sekretariati ekzekutiv do t'i dërgojë Komisionit çdo kërkesë në bazë të të cilës parashtruesi i kërkesës e konteston hedhjen poshtë nga Sekretariati ekzekutiv në bazë të kushteve të nenit 4.3 të kësaj Shtojce II.

4.5 Sekretariati ekzekutiv përgatit kërkesat përfshirë edhe parashtruesat dhe dëshmitë, përkthimet e dëshmimeve dhe rekomandimet në lidhje me të gjitha kërkesat, përveç atyre të refuzuara në bazë të nenit 4.3 të kësaj Shtojce II, kur parashtruesi i kërkesës nuk e konteston refuzimin për shqyrtim nga Komisioni.

Neni 5 Bashkëpunimi

Në ushtrimin e funksioneve të tij sipas Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50, Sekretariati ekzekutiv mund të bashkëpunojë dhe të marrë informacione nga çdo organ ndërqeveritar, qeveritar dhe joqeveritar.

Neni 6 Rregullat shtesë

Sekretariati ekzekutiv mund të miratojë rregulla shtesë për ushtrimin e funksioneve të tij, me kusht që ato të jenë në përputhje me Rregulloren e UNMIK -ut nr. 2006/50, me këtë Udhëzim administrativ dhe me vendimet e Bordit mbikëqyrës.

SHTOJCA III

Detyrat, përgjegjësitë dhe Rregullorja e punës e Komisionit të kërkesave pronësore

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1.1 Komisioni do të mbajë seanca apo do të punojë në panele të krijuar sipas nenit 7 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50. Nëse krijohen dy ose më tepër panele të Komisionit sipas nenit 7.4 të Rregullores së UNMIK -ut 2006/50, shprehjet ‘Komision’ dhe ‘Kryesues’ kanë kuptimin ‘Komision’ dhe ‘Kryesues i Komisionit’ kur kemi të bëjmë me seancat, dhe ‘Panel’ dhe ‘Kryesues i Panelit’ kur kemi të bëjmë me kërkesat e shqyrtuara nga panelet.

1.2 Kryesuesi i Komisionit drejton punën e Komisionit.

1.3 Komisioni mund të zgjedhë zëvendëskryesues i cili do të kryej funksionet e kryesuesit të Komisionit plenar në mungesë të tij.

1.4 Kryesuesi i Komisionit mund të caktojë një zëvendëskryesues lidhur me çdo panel të Komisionit i cili do të kryej funksionet e kryesuesit të panelit në mungesë të tij.

1.5 Anëtarët e Komisionit shërbejnë vetëm në cilësinë e tyre personale. Përveç dispozitave të nenit 8.3 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50, anëtarët e Komisionit nuk do të marrin pjesë në asnjë procedurë të kërkesës në të cilën ata kanë interes personal, ose nëse ata janë konsultuar me palën që ka paraqitur ankesën apo janë të lidhur me të, o se nëse ata janë përfshirë në ndonjë procedurë ligjore lidhur me këtë kërkesë përveç procedurës pranë Sekretariatit ekzekutiv dhe Komisionit, ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera që mund të ndikojnë në paanshmërinë e tyre. Nëse ka ndonjë dyshim lidhur me këtë paragraf ose ka ndonjë rrethanë tjetër që mund të ndikojë në paanshmërinë e anëtarëve në vendosjen e një kërkesë, vendos kryesuesi ose, nëse mund të ndikohet paanshmëria e kryesuesit, vendos zëvendëskryesuesi i panelit.

1.6 Pa cenuar ndonjë ligj tjetër apo rregullore që ka të bëjë me imunitetin, anëtarët e Komisionit kanë imunitet nga çdo procedurë penale apo civile për cilatdo akte që i kanë kryer në kuadër të veprimtarisë së detyrave të tyre zyrtare.

1.7 Selia e Komisionit do të jetë në Prishtinë. Komisioni mund të vendosë që seancat t’i mbajë diku tjetër nëse këtë e konsideron të përshtatshme. Në rastet e përshtatshme, shqyrtimet e Komisionit mund të bëhen edhe përmes mjeteve elektronike.

1.8 Sekretariati ekzekutiv i siguron Komisionit mbështetje administrative, teknike dhe ligjore.

1.9 Kryesuesi i Komisionit, në konsultim me anëtarët tjerë të Komisionit dhe duke marrë parasysh informacionet mbi numrin e rasteve të siguruara nga drejtori i Sekretariatit ekzekutiv, do të caktojë rendin sipas të cilit do të shqyrtohen rastet nga Komisioni, dhe do të bëjë ndarjen e rasteve nëpër panele, me qëllim të zhvillimit të një praktike konsistente.

1.10 Komisioni mund të miratojë rregulla shtesë për kryerjen e funksioneve të tij, me kusht që ata të jenë konsistente me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50 dhe me këtë Urdhëresë administrative.

Neni 2 Deklarata solemne

Para marrjes së detyrës, anëtarët e Komisionit japin me shkrim deklaratën solemne vijuese:

“Solemnisht deklaroj se si anëtar i Komisionit të kërkesave pronësore do t’i kryej detyrat dhe do t’i ushtroj kompetencat e mija në mënyrë të ndershme, të besueshme, të paanshme dhe të ndërgjegjshme.”

Deklarata do të ruhet në arkivin e Komisionit.

Neni 3 Dorëheqja ose shkarkimi nga detyra në Komision

3.1 Nëse kryesuesi i Komisionit jep dorëheqje, shkarkohet apo nuk rrimërohet, ushtrues i detyrës së kryesuesit të Komisionit është kryesuesi që ka shërbyer më gjatë në panel derisa të caktohet kryesuesi nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm. Për panelet që janë themeluar pas panelit të parë, kryesuesi caktohet nga kryesuesi i Komisionit, pas konsultimit me anëtarët e panelit relevant.

3.2 Anëtari i Komisionit i cili dëshiron të japë dorëheqje:

- (a) I ofron njoftim me shkrim kryesuesit të Komisionit së paku një muaj përpara përmes drejtorit të Sekretariatit ekzekutiv;
- (b) Vazhdon të kryejë të gjitha funksionet e tij deri në fund të periudhës së njoftimit dhe, për aq sa të jetë e mundur, pas kësaj periudhe vazhdon të punojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme

vetëm për të përfunduar ndonjë kërkesë apo grup të kërkesave të cilat presin të zgjidhen nga paneli i atij anëtar.

Neni 4

Seancat dhe mbledhjet e Komisionit

4.1 Në konsultim me anëtarët tjerë të Komisionit, kryesuesi i Komisionit e cakton numrin dhe datën e seancave të Komisionit.

4.2 Anëtarët e Komisionit të cilët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në një seancë i paraqesin njoftim me shkrim kryesuesit të Komisionit përmes drejtorit të Sekretariatit ekzekutiv së paku dy javë para seancës. Në njoftim duhet të tregohen arsyet për pamundësinë e tyre për të marrë pjesë në seancë.

Neni 5

Procedurat pranë Komisionit

5.1 Procedurat pranë Komisionit bazohen në parashtrësat me shkrim dhe, kur është në interesin e drejtësisë, në seanca dëgjimore. Në kontekstin e nenit 11.2 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50, kërkesat do të zgjidhen në bazë të parashtrësive të dorëzuara nga palët, duke përfshirë edhe dëshmitë dokumentare.

5.2 Secila palë mund të kërkojë që të japë dëshmi gojore apo të paraqesë argumente pranë Komisionit përveç nëse Komisioni konstaton se kjo nuk është në interes të drejtësisë. Seanca dëgjimore mbahet publikisht, duke i njoftuar palët me kohë, përveç nëse kryesuesi vendos ndryshe për arsye të sigurisë së palëve apo rrethanave të tjera të veçanta. Procedura gjyqësore në seancë dëgjimore do të mbahet nën drejtimin e kryesuesit.

5.3 Komisioni mund të shqyrtojë parashtrësat e shkruara apo gojore nga cilido subjekt ndërqeveritar, qeveritar apo joqeveritar ose nga eksperti në cilësi të dëshmitarit për cilëndo çështje që ka të bëjë me kërkesën.

5.4 Komisioni mund të caktojë cilindo nga anëtarët e tij për të kryer ndonjërin nga funksionet e tij procedurale, duke përfshirë edhe marrjen pjesë në seancat dëgjimore të dëshmimeve gojore në ndonjë vend dhe raportimin për këtë te Komisioni.

5.5 Komisioni mund të marrë parasysh kërkesat që bashkërisht ngrenë çështje ligjore apo dëshmuuese, dhe mund të miratojë teknika të tjera ligjore dhe dëshmuuese të cilat janë konsistente me dispozitat e nenit 11.3 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50.

5.6 Në raste të veçanta, Komisioni mund të veprojë pavarësisht nga mospërputhshmëria me ndonjë rregull procedurale nga ndonjë palë apo Sekretariati ekzekutiv kur është në interes të administrimit efikas të drejtësisë, kur ka arsye të shëndoshë për ta bërë këtë dhe kjo nuk do të cenonte materialisht të drejtat e ndonjë pale.

5.7 Të gjitha procedurat pranë Sekretariatit ekzekutiv dhe Komisionit, duke përfshirë plotësimin dhe dorëzimin e formularit të kërkesës dhe përgjigjes në kërkesë apo dokumentacion tjetër që i dorëzohet Sekretariatit ekzekutiv, konsiderohen të jenë procedura administrative për qëllimet e nenit 176 të Ligjit të ndryshuar Penal të Kosovës (Gazeta Zyrtare e KSAK nr. 20/77, 25/84 dhe 44/84) që ka të bëjë me dëshminë e rrejshme.

5.8 Komisioni ka të drejtë në qasje të pakufizuar dhe të lirë pa pagesë në të gjitha shënimet në Kosovë, të cilat janë relevante për zgjidhjen e një kërkesë që është dorëzuar në këtë Komision ose për qëllime të tjera të verifikimit.

Neni 6

Dëshmia

6.1 Komisioni mund të udhëzohet por nuk detyrohet që t'u përmbahet rregullave mbi evidencën të zbatuara në gjykatat vendore në Kosovë.

6.2 Komisioni mund të marrë parasysh çfarëdo dëshmie të besueshme, të cilën ai e konsideron relevante për kërkesën, duke përfshirë edhe dëshmitë e paraqitura nga Sekretariati ekzekutiv lidhur me besueshmërinë e shënimeve publike.

6.2 Gjatë ushtrimit të kompetencave të tij në pajtim me nenin 11.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati ekzekutiv që të marrë informacione shtesë nga pala apo që të kryej hetime shtesë lidhur me ndonjë kërkesë.

Neni 7

Panelet

7.1 Sipas neneve 1.4, 4.2 dhe 7.2 të kësaj Shtojce III, për kërkesat merret vendim nga panelet e Komisionit.

7.2 Kuorumi i mbledhjeve të një paneli të Komisionit është dy anëtarë.

7.3 Vendimet e panelit të Komisionit zakonisht merren me unanimitet. Nëse të gjithë anëtarët e panelit janë të pranishëm dhe unanimiteti nuk mund të

arrihet, vendimi merret me shumicën e votave. Nëse të pranishëm janë dy anëtarë të panelit dhe nuk mund të arrihet konsensus, kërkesa shtyhet për t'u shqyrtuar për në seancën e parë të ardhshme të panelit të Komisionit.

7.4 Paneli i Komisionit ose kryesuesi i një paneli mund t'i referojë çështjet e veçanta që kanë të bëjnë me kërkesën në seancën e Komisionit për udhëzime. Vendimet e panelit të Komisionit për t'i referuar çështjet e veçanta në seancën e Komisionit merren në pajtim me nenin 7.2 të kësaj Shtojce III.

7.5 Gjatë vendosjes mbi një kërkesë apo nëse duhet referuar çështjet specifike që kanë të bëjnë me kërkesën në seancën e Komisionit, anëtarët e panelit të Komisionit nuk mund të abstenojnë.

7.6 Kryesuesi i Komisionit mund të caktojë një anëtar të panelit që përkohësisht të shërbejë në një panel tjetër kur ai këtë e konsideron të nevojshme për funksionimin e duhur të Komisionit.

Neni 8

Vendimet e Komisionit

8.1 Çështjet e ngritura lidhur me një kërkesë, të cilat nuk janë në kompetencë të Komisionit ose vetëm disa pjesë të kërkesës nuk janë në kompetencë të tij, Komisioni mund t'ia referojë gjykatës kompetente vendore ose bordit administrativ apo tribunalit, nëse vendimi mbi ato pjesë të veçanta të kërkesës nuk ngrit çështjet e shënuara në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50.

8.2 Komisioni ka detyrim që tu përmbahet parimeve të vendosura në vendimet e tij, përveç nëse ekzistojnë arsye detyruese për t'iu shmangur këtyre parimeve.

8.3 Komisioni do të jep kompensime në pajtim me ato të parapara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/50.

8.4 Komisioni nuk mbulon shpenzimet që dalin lidhur me procedurat pranë Sekretariatit ekzekutiv ose Komisionit, në favor apo kundër ndonjë pale në procedurë.

8.5 Kur kërkesa bëhet nga një anëtar i familjes i bartësit të së drejtës pronësore në pajtim me nenin 1.2 të Shtojcës II, Komisioni mund të caktojë çfarëdo të drejte pronësore në emër të bartësit të së drejtës pronësore dhe të bëjë urdhër për posedim në favor të parashtruesit të kërkesës. Vendimi i tillë nuk do të përcaktojë apo ndikojë në ndonjë çështje ligjore në mes të parashtruesit të kërkesës dhe bartësit të së drejtës pronësore apo ndonjë personi tjetër që nuk është palë në këtë kërkesë.

8.6 Në vendimin e tij, Komisioni mund të:

- (a) Vendosë mbi të drejtat e pretenduara pronësore të nevojshme për të zgjidhur kërkesën;
- (b) Bëjë urdhër për posedim të pronës në favor të cilësdo pale;
- (c) Refuzojë apo hedhë poshtë kërkesën mbi cilëndo arsye, duke përfshirë edhe ato të paraqitura në nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50;
- (d) Anulojë çdo kontratë të qiradhënies lidhur me pronën që i nënshtrohet urdhrit në kuptim të Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50 dhe të bëjë urdhra ndihmës që të plotfuqizojë anulimin.
- (e) Marrë vendime të tjera ose urdhra të nevojshme për të plotfuqizuar dispozitat e Rregullores së UNMIK -ut nr. 2006/50 ose kësaj Urdhërese administrative.

8.7 Vendimi përfshin:

- (a) Datën e miratimit;
- (a) Emrat e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre;
- (c) Kompensimin e kërkuar;
- (d) Arsyet për vendimin, duke përfshirë edhe faktet materiale dhe të drejtat pronësore të konstatuara nga Komisioni dhe
- (e) Urdhrat e Komisionit.

8.8 Vendimet nënshkruhen nga kryesuesi, me kusht që nëse numri i kërkesave të zgjidhura në një seancë është i lartë, kryesuesi mund të nënshkruajë një vendim ombrellë me të cilin miraton të gjitha vendimet individuale të cilat janë identifikuar në vendimin ombrellë. Vendimet individuale do të certifikohen nga një zyrtar i lartë i caktuar nga Komisioni ose nga drejtori i Sekretariatit ekzekutiv. Një kopje e dokumentit origjinal e nënshkruar nga kryesuesi që i është dërguar drejtorit të Sekretariatit ekzekutiv ose personit të caktuar nga ai me anë të faksimilet të origjinalit (ose mjeteve të ngjashme) është burim i mjaftueshëm për çfarëdo aktesh të ndërmarra në pajtim me këtë dokument.

8.9 Çfarëdo gabimesh tekstuale në vendim të Komisionit, të cilët nuk ndikojnë materialisht në të drejtat e cilësdo pale, mund të korrigjohen nga zyrtari i lartë i caktuar nga Komisioni ose nga drejtori i Sekretariatit ekzekutiv, pas marrjes së pëlqimit të qartë me shkrim të kryesuesit të Komisionit.

Neni 9 Procedura e thjeshtuar

9.1 Çdo kërkesë sipas nenit 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50, e cila është e pakontestuar, mund të shqyrtohet nga Komisioni me procedurë të thjeshtuar si kërkesë e veçantë apo bashkërisht me kërkesa të tjera të ngjashme.

9.2 Në procedurë të thjeshtuar, Komisioni mund të bëjë urdhër për kthim të posedimit të pronës nëse siguron dëshmi se pretenduesi në mënyrë të pakontestueshme ka poseduar pronën e cila është humbur për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti kanë të bëjnë me konfliktin e armatosur që ndodhi ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999 apo janë pasojë e tij.

9.3 Vendimi i thjeshtuar përfshin:

- (a) Datën e miratimit;
- (b) Emrat e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre dhe
- (c) Dispozitat vepruese të vendimit.

Zyrat e KPA-së

Zyrat Qendrore të KPA-së

mailbox@kpaonline.org
Nazim Gafurri 1, Prishtinë
Telefoni: +381 (0)38 249918
Telefaksi: 038 249 919

KPA Beograd

Kosovës 49/8
Telefoni: 011 334 5513/5314
Telefaksi: 011 334 4452

KPA Gjilan

Uashington / Rade Popovic
Telefoni: 0280 320 289
Telefaksi: 0280 324 067

KPA Kragujevcs

Rr.9, "Lole Ribara"
Telefoni: 034 330 234; 330 784
kati 4-të

KPA Mitrovicë

Zyra qendrore:
Shtabi Rajonal i UNMIK-ut (Jugoban-
ka)
Telefoni: 028 530 136/7
Telefaksi: 028 530 139
Zyrat e vizitorëve:
Pjesa Jugore: Rr. Mbretëresha Teuta
(përballë Jugobankës)

KPA Nish

Rr."Dusanov Bazar" (Dusanova)
Telefoni: 018 515-727; 515-728
kati 3-të, Zyra br. 308

KPA Pejë

Zyra qendrore: Rr. "Mbreteresha
Teuta", 153
Telefoni: 039 431 668
Telefaksi: 039 432 970

KPA Podgoricë

Crnogorskih Serdara
Telefoni: 081 624 216 / 081 623-744

KPA Prishtinë

Rexhep Luci 28/(ish Goleshi 2)
Telefoni: 038 225 473
Telefaksi: 038 244 854

KPA Prizren

Zyra e vizitorëve:
Jeronim De Rada"/ "Zef Llush Marku"/
"Metohijska" nr. 63
Tel: (029) 231-429

HPD Shkup

Vinichka Street No. 10 (CDRIM-build-
ing), kati i parë
Telefoni: +389 71 886 564



www.kpaonline.org